



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 22 QERSHOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
22 JUNA 2012. GODINE**

**Qershor - Juni
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektkodit të procedurës penale,
6. Shqyrtimi i vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës për rishqyrtim,
7. Shqyrtimi i raportit të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2011.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni zakona koji se odnose na završetak međunarodnog nadgledanja nezavisnosti Kosova,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o krivičnom postupku,
6. Razmatranje Odluke predsednice Republike Kosova o vraćanju Krivičnog zakonika Republike Kosova za ponovno razmatranje,
7. Razmatranje Izveštaja o radu Saveta Kosova za Kulturno Nasleđe za 2011. godinu.

Seancën e drejton nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit të Qeverisë,
Hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Falemnderit nënkryetar!

Këtyre ditëve më kanë prekur shumë zhvillime dhe më kanë inspiruar shumë ndodhi, për të ngrehur shqetësime të qytetarëve këtu në këtë Parlament dhe po të mos ishte koha e kufizuar, sigurisht që do të ndalesha në tri shqetësime, të cilat janë aktuale në gjithë Kosovën, jo vetëm në këtë temë që dua ta trajtoj, por besoj se do të gjendet në ndonjë pikë sot, ose në ndonjë pikë tjetër të mbledhjes së radhës dhe dy të tjerat do t'i trajtoj.

Ndërsa, do të ndalem në një shqetësim, që është shqetësim i qytetarëve të Malishevës, të Rahovecit, të Therandës, të Prizrenit, një pjese të Drenasit dhe një pjese të Klinës. Janë ethet hemorragjike, janë pickimi i rriqrave që po merr jetën e njerëzve dhe një shqetësim, të cilin e kam ngrehur sa herë dhe në këtë vend, në këtë Parlament, kam marrë edhe premtimin e ministrit të Shëndetësisë për t'i ndarë 20 000 euro për këtë aksion.

Dhe, unë e lus Qeverinë, e lus ministrin e Drejtësisë, që ta japin kontributin e tyre tani në këtë sezon kur kanë shpërthyer shqetësimet e qytetarëve dhe po pësojnë jetët e njerëzve.

Unë besoj se edhe me kaq kam arritur të bëj një apel, të cilin do ta dëgjojë Qeveria dhe do t'i mobilizojë të gjitha strukturat e saj dhe do t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë, që këto shqetësime të qytetarëve, në qoftë se njëherë e mirë dhe përfundimisht të përfundojnë, të paktën Qeveria dhe institucionet e Kosovës të jenë pranë qytetarëve, të cilët janë mjaft të shqetësuar. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka zoti Morina.

SALIH MORINA: Falemnderit, kryesues!

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po ashtu, e kam shqetësimin e njëjtë, të cilin e pati edhe kolegu, deputeti Halit Krasniqi. Situata në komunën e Malishevës është shumë alarmante. Kjo vazhdon të jetë që nga viti 2000 dhe deri më tani, kur kemi realisht 13 viktima dhe viktima e 14-të ka ndodhur para

një javë ditësh, do të thotë e pësoi vajza 16-vjeçare Albana Gashi nga Plloçica e Malishevës, që e shfrytëzoj rastin t'i shpreh ngushëllimet më të sinqerta.

Dhe, po ashtu, në Klinikën Infektive është numri diku rreth 7 pacientë, të cilët janë të infektuar dhe unë e përshëndes vendimin që ka nxjerrë Qeveria me shumën në vlerë prej 20 000 eurosh, por mendoj që një shumë e tillë është e pamjaftueshme.

Kapacitetet njerëzore në komunën e Malishevës janë të vogla dhe njëkohësisht kërkesa edhe nga Komuna, edhe nga Drejtoria e Shëndetësisë për shumën në vlerë prej 20 000 eurosh është e pamjaftueshme për ta kapërcyer ose në njëfarë forme për të parandaluar këto ethe hemorragjike, të cilat po u kanosen për çdo ditë qytetarëve të komunës së Malishevës.

Unë e ftoj Komisionin për Shëndetësi, në këtë rast, në kuadër të Parlamentit të Kosovës dhe bashkërisht me ministrin e Shëndetësisë që t'i bëjnë një vizitë komunës së Malishevës, t'u bëjnë një vizitë familjeve të cilat tashmë i kanë humbur më të dashurit e tyre dhe njëkohësisht të bëjnë një vizitë në Kuvendin Komunal të Malishevës për të bërë një zgjidhje ose për t'i parandaluar këto ethe, të cilat po u kanosen për çdo ditë qytetarëve të komunës së Malishevës.

Prandaj, pse jo, edhe nga qeveritarët do të ishte mirë që ta vizitojnë këtë komunë dhe njëkohësisht ta bëjnë të pamundurën, sepse u bë më tepër se sa një dekadë që qytetarët e komunës së Malishevës vuajnë dhe njëkohësisht u kanoset rreziku i përditshëm. Falemnderit shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Falemnderit, kryesues! Në emër të Grupit.

Të nderuar deputetë,

Kur para një viti Lëvizja "Vetëvendosje" pati organizuar një interpelancë parlamentare me Qeverinë në Kuvendin e Kosovës lidhur me kontratën e nënshkruar me Kompaninë "Behtel&Enka" për realizimin e projektit të autostradës Vërmicë-Merdar dhe anomalitë që e shoqërojnë këtë projekt, atëbotë si deputet i kësaj lëvizjeje pata adresuar për diskutim publik pikërisht çështjen e të drejtave të punëtorëve, nivelin e realizimit të këtyre të drejtave, si dhe zbatimin apo më mirë të themi moszbatimin e Ligjit të punës nga kjo kompani për punëtorët vendorë.

Përgjithësisht, faktet nga terreni që e pasqyrojnë këtë problem ishin nga më tronditëset për çdo ndërgjegje njerëzore dhe morale, si dhe ngjallnin një neveri të pamasë në këtë rast. Prandaj, vetvetiu shtrohej pyetja se si ishte e mundur që në këtë kënd të Evropës të tolerohej një abuzim i tillë ekstrem i të drejtave njerëzore e punëtoresh, apo më mirë të themi se si lejohej një eksploatim i tillë i pakufishëm ndaj atyre që punonin në këtë kompani.

Paradoksalisht, për t'iu përgjigjur kësaj katrohure, që kishte filluar të rezultonte dita-ditës edhe me shkatërrim fizik, shpirtëror, moral dhe psikologjik, Qeveria zgjodhi metodat më

bizare të mundshme që kishte në dispozicion. Kështu, në vend të intervenimit institucional për ta sanuar këtë nivel skllavëror të punëtorëve, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale atëbotë bënte sehir dhe përgjigjej në mënyrë absurde, se arsyet pse nuk zbatohej Ligji i punës nga “Behtel&Enka” lidheshin me faktin se kjo kompani ishte instaluar në Kosovë para se të miratohej Ligji i punës.

E kulmi i kësaj marrëzie e arriti majën, kur një javë pas kësaj interpelance, Qeveria e shoqëruar së bashku edhe me udhëheqësin e manipuluar të sindikatave, e inskenoi një spektakël medial, duke intervistuar para RTK-së disa punëtorë, sipas të cilëve gjendja dhe niveli i të drejtave të tyre ishin tejet të kënaqshme.

Pra, ofiçina ideologjike e kësaj Qeverie, së bashku me amplifikatorët e saj, për t’iu kundërvënë një kritike substanciale, teorike dhe juridike, e zgjodhi zhurmën propagandistike, mediale, si kundërpeshë për t’i relativizuar faktet e kësaj gjendjeje poshtëruese dhe të mjerueshme.

Mirëpo, ja që faktet janë më kokëforta se sa propaganda qeveritare dhe ato gjithnjë e më shumë po e shkërmoqin këtë manipulim ideologjik politik.

Fatkeqësisht, gjërat në këtë kompani që nga ajo kohë kanë ardhur duke u përkeqësuar edhe më shumë. Kështu, ky përkeqësim ekstrem tashmë ka filluar të rezultojë edhe me humbje të jetës njerëzore, viktima të njëpasnjëshme dhe lëndime serioze të shëndetit të punëtorëve, për shkak të kushteve të punës, që dominojnë në këtë kompani, ashtu sikur ndodhi ditë më parë, ku edhe një punëtor tjetër e humbi jetën në fshatin Zllapuzhan të Therandës. Kurse, ky qëndrim indolent e arriti kulmin, kur sipas dëshmitarëve të rastit trupi i pajetë i viktimës kishte qëndruar për orë të tëra në vendin e ngjarjes, pa u hetuar fare ngjarja në fjalë.

Raste të tilla kishin ndodhur edhe më herët, kur një punëtor tjetër - Valon Guri, e kishte humbur jetën në fshatin Bellanicë, apo rasti kur Mentor Sylja kishte marrë lëndime të rënda trupore gjatë punimeve në autostradë.

Të gjitha këto aksidente, të cilat tashmë kanë filluar të jenë edhe me pasoja tragjike për këtë shoqëri, kërkojnë një intervenim institucional urgjent, e jo manipulim spektakular, medial dhe propangadistik, sepse në fund të fundit shtrohet edhe një herë pyetja: Edhe sa vuajtje njerëzore dhe qytetare duhet t’i përjetojë kjo shoqëri, vetëm e vetëm që të plotësohen ambiciet e pushtetarëve? Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Kelmendi e ka fjalën.

RAMIZ KELMENDI: Përshëndetje, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Sot desha të shpreh shqetësimin në lidhje me akcizën që është vendosur në qeset për hedhjen e mbeturinave, e qëllimi i tyre është mirëmbajtja e pastërtisë së ambientit dhe atë

duke shtuar akcizën 3 euro plus TVSH-në për 50 centë, del që një qese e mbeturinave të kushtojë baras me një kilogram bukë.

Pra, shumica e qytetarëve të cilët kanë qese të mbeturinave, do t'i hedhin mbeturinat dhe do ta kthejnë qesen, ta mbushin përsëri.

Ka pasur mundësi që ky ligj t'i aplikojë edhe qeset, të cilat mund të transformohen brenda 12 muajve dhe mund në këtë formë, me teknologjinë që ekziston te prodhuesit kosovarë dhe njëkohësisht që të mos zvogëlojë numrin e të punësuarve në këtë veprimtari. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Trajković e ka fjalën.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani predsjedavajući,

Poštovane kolege poslanici,

Koliko pre dva dana, potpredsjednik vlade Kosova, gospodin Kući je javno pozvao na povratak sve stanovnike Kosova i Metohije, koji su proterani sa ovog područja, zbog čega sam bila vrlo zadovoljna. Ali, u gotovo istovremeno profesoru doktoru Tomislavu Đokiću, čoveku koji je živeo i radio u Prištini, koji je bio dekan u četiri mandata, jedna stara ugledna prištinska porodica, pre tri, četiri dana podmednut je eksploziv na njegovu porodičnu kuću, u centru Prištine, u ulici "Mete Barjaktara", broj 7, znači gotovo kod prostorija jedne institucije, a to je Skupština Opštine Priština, a svakako blizu ovoga zdanja.

Poštujući profesora Đokića kao vrsnog naučnika sa velikim međunarodnim priznanjem i sa najvećim naučnim priznanjem, koje je dobio od Sjedinjenih Američkih Država i koje mu je gospodin ambasador Polt, u ime Američke Države predao u Beogradu, želela bih da gospodin Kući, kao potpredsjednik i kao čovek koji ima ozbiljne namere za povratak srba, učini napore da napravimo kontakt, da razgovara sa profesorom, da Ministarstvo Unutrašnjih Poslova utvrdi ko je to uradio, i da Ministarstvo za Povratak učini napore da mu se kuća vrati u prvobitnom stanju.

Zaista, to je poslednja srpska kuća u Prištini koja je srušena pre tri dana.

Drugo, jako cenim svaki poziv koji dolazi od institucija čiji sam deo i ja, ali bih zamolila ministra za Diasporu da ubuduće ne šalje mi pozivnicu samo na albanskom jeziku, jer je doživljavam kao da me nije pozvao, nego da poštuje sopstveni ustav na kome, koji je prihvatio, da po njemu radi, i da nam ubuduće pošalje pozivnice gde ću nas po zakonu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Falemnderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshiroj ta shpreh shqetësimin para jush për gjendjen e pyjeve të Kosovës në këto ditë kur ne jemi në proces të miratimit të tri projektligjeve që kanë të bëjnë me këtë sektor.

Në fakt, ne kemi qenë në vizita nëpër pjesë të ndryshme të Kosovës dhe e kemi parë që pyjet janë jashtëzakonisht shumë të degraduara. Për më keq, në Rugovë, ku e kemi një pjerrtësi të madhe të terrenit, ka filluar edhe procesi i erozionit të tokës, që është një e keqe jashtëzakonisht e madhe.

Më duhet të them se përkushtimi edhe i donatorëve, që nga viti '99 ka qenë i mirë dhe ata kanë punuar jashtëzakonisht shumë në këtë sektor, e po ashtu edhe përkushtimi i institucioneve tona prej vitit 2008 ka qenë përkushtim i mirë, është ndarë një buxhet i mirë dhe është punuar në këtë drejtim, por nevojat e popullsisë për dru zjarri dhe për dru teknik janë jashtëzakonisht të mëdha dhe mundësia e prerjeve të planifikuara tash për tash është jashtëzakonisht e kufizuar.

Edhe me delegimin e kompetencave me reformën institucionale, që po bëhet për dërgimin e kompetencave në nivel lokal, dhe me këtë veprim nuk po mund të zgjidhet ky problem.

Unë i ftoj institucionet përgjegjëse, që merren me sektorin e pylltarisë, që ta thellojnë më me guxim reformën dhe t'i çojnë pyjet atje, ku ato realisht e kanë vendin, ku janë në mesin e njerëzve, që ato i shfrytëzojnë dhe të cilët jetojnë nga ato. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Sot do ta shpreh një shqetësim të qytetarëve të Mitrovicës, por para se ta bëj këtë, unë vërtet i bëj thirrje kryesuesit të kësaj seance, që deputetëve që janë anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe u thuhet apo i thirren Kosovës si "Kosovo i Metohija", t'ua tërheqë vërejtjen, sepse nuk besoj që ka shkelje më të madhe të Rregullores së Punës së Kuvendit se kjo, e po ashtu edhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe jo të "Kosovës dhe Metohisë", së cilës zonja më herët iu referua.

Unë nuk besoj që thirrjet e institucioneve për kthim të komuniteteve mund të kenë sukses, përderisa përfaqësuesit e atyre komuniteteve në këtë Kuvend i referohen Kosovës si "Kosovo i Metohija".

T'i kthehem çështjes, të cilën desha ta ngre. Para pak kohësh, qytetarët e Mitrovicës janë shqetësuar me lajmin e plasuar në opinion se Komuna e Mitrovicës ka marrë vendim, që në zbatim të një projekti të financuar nga BE-ja për rirregullimin e sheshit qendror të Mitrovicës, do t'i presë drunjtë ekzistues në shesh.

Siç dihet, qyteti i Mitrovicës është një prej qyteteve më të ndotura në Evropë dhe tani për tani ka nevojë urgjente për hapësira të gjelbra dhe prerja e drurëve ekzistues nuk do të mund të zëvendësohej asesi me mbjelljen e fidanëve të rinj.

Unë besoj që edhe Ministria e Ambientit është e njoftuar me termin e biodiversitetit. Si një shembull, në Australi edhe drunjtë më të shëmtuar, që e shëmtojnë qytetin, i mbajnë dhe nuk i presin ata për hir të bukurisë apo për diçka tjetër, për shkak të biodiversitetit.

Në anën tjetër, llogaritini lisat që janë rritur aty për më shumë se 100 vjet, tani zëvendësohen me fidanë të rinj, e dihet se sa vite duhen deri sa të rriten.

Është e paimagjinueshme, që me paratë e taksapaguesve evropianë të shkatërrohet ambienti në të cilin jetojmë.

Dua ta përmend që para disa vjetësh në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, një numër i qytetarëve të Prizrenit, në rastin Fadil Hoxha dhe 39 të tjerë kundër Komunës së Prizrenit, e kanë ngrehur po të njëjtën çështje, kur Komuna e kishte shkatërruar një pjesë të gjelbër të qytetit për ndërtimin e një ndërtese kolektive.

Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese u dha të drejtë qytetarëve, sepse, sipas Kushtetutës, kapitulli 2, Komuna nuk mund të vendosë asesi ta prishë hapësirën e gjelbër të qytetit, pa marrë pëlqimin e qytetarëve, do të thotë është standard në Kushtetutën tonë, jo diçka e shpikur.

Prandaj, i bëj thirrje Qeverisë, në mënyrë që të mos ballafaqohet me mospajtime të mëdha apo me padi të qytetarëve të Mitrovicës në gjykata, që ta rishqyrtojë këtë, sepse unë besoj që mund të gjenden zgjidhje që të mos priten ata drunj, mirëpo që ndërtimi i këtij projekti, që natyrisht është shumë i mirëseardhur për të gjithë qytetarët e Mitrovicës, të bëhet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Falemnderit, kryesues!

Sigurisht, edhe Lëvizja “Vetëvendosje” do ta ngrejë në Kuvend çështjen e etheve hemorragjike, por nga një këndvështrim tjetër nga ata të cilët shprehën shqetësim, madje e lavdëruan edhe Qeverinë, mirëpo të njëjtën gjë nuk e mendojnë dhe qytetarët e Malishevës.

Ethet hemorragjike janë një sëmundje virale shumë e rrezikshme, që hyn në grupin e sëmundjeve me rëndësi të veçantë për shtetin, pasi kjo sëmundje cilësohet edhe si sëmundje bioterroriste.

Në Kosovë ka disa vende endemike me këtë sëmundje, ku hyjnë: Malisheva, Rahoveci, Klina, një pjesë e Drenasit, fshatrat e Gjakovës e Prizrenit. Çdo vit, kjo sëmundje shkakton viktima dhe shumica janë e një moshe shumë të re.

Vetëm në komunën e Malishevës ka mijëra raste të pickimit nga rriqrat, ndërsa prej tyre 13 kanë vdekur. Këtë vit janë paraqitur mbi 900 qytetarë me pickime nga rriqrat, 4 prej tyre kanë rezultuar të infektuar me ethet hemorragjike.

Rasti më i fundit ishte vdekja e 16-vjeçares Albana Gashi, nga fshati Plloçicë e Malishevës. Fatkeqësisht, në shumicën e rasteve në Kosovë, sa i përket kësaj problematike, masat janë ndërmarrë pas pasojave të shkaktuara, e jo me parandalimin.

Shteti në këtë rast më shumë ka qenë spektator, se sa që ka provuar të ndërmarrë diçka, gjë e cila vazhdon për vite të tëra.

Duke qenë sëmundje shumë e rrezikshme dhe me një gamë të gjerë të shkaqeve, si rrjedhojë, nuk mjafton vetëm angazhimi i qytetarëve, apo vetëm i një ministrie. Në këtë rast, shteti duhet ta tregojë forcën e vet në drejtim edhe të obligimit të qytetarëve për parandalimin e saj, duke u ofruar sigurimin e kushteve teknike dhe udhëzimeve profesionale.

Pasi këtu nuk bëhet fjalë vetëm për oborrin apo ambientin e vetëm të individit, por kjo ka impakt të gjerë shoqëror, aty duhet ndërthurur i gjithë aparati shtetëror, me theks të veçantë në Ministrinë e Ambientit, duke bërë studimin gjeografik dhe mundësinë e kontaminimit të tokës nga rriqrat, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë e Veterinës. Në kuadër të asaj çfarë duhet bërë shteti, që në shumicën e rasteve nuk e ka bërë, për këtë problematikë janë disa pika:

- Dezinsektimi në shumicën e vendeve endemike, me përjashtim të disa pjesëve në rrethinat e Malishevës dhe atë vetëm në kohën e fundit, dezinfektimi kryesisht është bërë nga kompani private, jo të specializuara.

Gjithashtu, materialet e përdorura për dezinfektim nuk janë kontrolluar fare nga institucionet shtetërore dhe gjithashtu kjo procedurë, në shumicën e rasteve, është bërë pa praninë e ekspertëve.

Në Kosovë këto shërbime për këtë problematikë janë jashtëzakonisht shqetësuese dhe i kryejnë kompanitë private, pa përvojë të mirëfilltë në këtë drejtim dhe pa mbikëqyrje shtetërore.

Fushata për informim, akoma nuk ekziston...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot do të ngre shqetësimin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për rritjen e çmimit të rrymës, e cila do t'i varfërojë edhe me shumë qytetarët e Kosovës, të cilët edhe kështu janë në vendin e 9-të në listën e varfërisë në botë.

Mendoj që derisa pa debat publik, pa raportim në Kuvend, pa asnjë grimë transparencë, Qeveria e Kosovës ka filluar apo ka marrë vendim t'i privatizojë dy sektorët kyç, për një çmim qesharak, prej 26 milionë eurove dhe mendoj që duhet të na japë një përgjigje, se pse këta sektorë, ndërtesat e të cilëve vlejnë shumë më shumë, e lëre më tjerat, po shiten për një çmim kaq të lirë dhe po i jepet monopoli një individi privat mbi energjinë elektrike në Kosovë, ndërkohë Rregullatori po vendos ta rrisë çmimin e rrymës.

Mendoj, që në vend të kësaj rritjeje, Qeveria është dashur të fillojë ta luftojë korrupsionin, në mënyrë që ta ketë një mjedis më të mirë për investime, se edhe më tutje nuk po shohim as investime, as investitorë.

Me theks të veçantë, këtu nuk po e shoh ministrin e ngecjes ekonomike, se nuk i kisha thënë të zhvillimit ekonomik, sepse në Kosovë ka pasur gjithçka, përveç zhvillimit ekonomik.

Ta fillojë punën edhe ministrja, që tani erdhi, e Tregtisë dhe Industrisë, t'i ndalë këto politika të power point-it, se na keni lodhur, po për ta filluar punën dhe për ta bërë një mjedis më të mirë, që Kosova të paktën të fillojë të ketë zhvillim ekonomik, e jo t'i rrisë çmimet për ta mbushur buxhetin. Ju kisha lutur të mos flisni për "Planin e Banjskos" si të arritur, se pas "Planit të Banjskos" në Kosovë dhe qytetarëve të saj u janë shtrenjtuar: rryma, buka, derivatet, biletat, e tash së fundi edhe çimentoja.

Mendoj, që duke mos pritur që Qeveria do të ndërmarrë hapa konkretë për ta ndaluar këtë rritje të çmimit të rrymës, Kuvendi dhe ne të gjithë, që jemi përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, duhet ta thërrasim në përgjegjësi Rregullatorin dhe ta thërrasim ta rikthejë këtë vendim të mbrapshtë, i cili me të vërtetë do të na sjellë probleme edhe më të mëdha sociale, mund të na dërgojë edhe në trazira sociale, sepse në një vend të botës, ku në vazhdimësi janë rritur çmimet, do të thotë të mallit që është esencial për jetën e qytetarit, kanë shpërthyer trazirat sociale dhe këtë nuk ia kisha dashur Kosovës, nuk ia kisha dashur asnjë vendi, e më së paku vendit tim.

Prandaj, ju kisha ftuar, si kryesues, si Kryesi e Parlamentit, të fillojmë si deputetë, të reflektojmë në rend të parë me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe në rend të dytë - të kërkojmë që ky vendim të rikthehet dhe të mos zbatohet si i tillë.

Unë edhe një herë po them, nga Qeveria nuk pres se do të ketë përmirësim, sepse deri më tani nuk ka treguar gatishmëri, as vullnet e as dije ta bëjë një ndryshim për të mirë, por mendoj që ka ardhur koha që Kuvendi të reflektojë ndryshe. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Falemnderit!

Poštovani predsedavajući,

Poštovani predstavnici vlade,

Kolege poslanici,

U ime bošnjačke zajednice, koja živi na teritoriji regiona Prizren, duboko se zahvaljujem Specijalnom Civilnom Predstavniku na Kosovu, gospodinu Piteru Fejtu, koji je posetio našu zajednicu i dao svaki vid podrške u smeru decentralizacije i obrazovnog sistema na bosanskom jeziku.

Takodje, reči zahvale idu i zameniku premijera, odnosno ministru za Lokalnu Samoupravu, gospodinu Slobodanu Petroviću, ispred vladinih institucija, odnosno ispred svog resursa, koji je dao podršku bošnjačkoj zajednici kako bi se formirala nova opština u Župi, regionu koji broji od 13 do 15 hiljade stanovnika i koji zadovoljava sve formalno pravne okvire Ustava Republike Kosova i sve kriterijume Ministarstva za Lokalnu Samoupravu u procesu decentralizacije.

Poseta je bila od nacionalnog, političkog i istorijskog karaktera za bošnjačku zajednicu, koja će nastaviti rad u kontinuitetu sa vladinim institucijama, odnosno sa Ministarstvom za Lokalnu Samoupravu, kako bi se ovaj proces pozitivno završio u interesu građana Župe, podigao se socijalno ekonomski status i delimično zaustavio proces migracije ili iseljavanja bošnjačke populacije sa ovog prostora. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryesues, Haliti,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Momenti, në të cilin gjendet Kosova është shumë specifik dhe përplot me rreze të papritura. E kemi situatën në veri të vendit, ku nuk ka shenja të normalizimit, por as të pengimit të veprimit të strukturave paralele e kriminale. Madje, tash e kemi edhe vringëllimën e armëve, siç po ndodh në rastet kur KFOR-i po intervenon për heqjen e barrikadave apo gjatë mbylljes së rrugëve periferike e vendkalimeve kufitare ilegale.

Unë nuk dua të ndalem rreth këtij problemi, por po theksoj se ai ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në zhvillimet tjera në vend, si në ato politike, ekonomike apo sociale.

Shqetësim më i madh mbetet reflektimi i kësaj situatë në ekonomi, përkatësisht për thithjen e investimeve të huaja. Të dhënat në këtë fushë janë shqetësuese. Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës, investimet e huaja direkte kanë lëvizje të ndryshme gjatë viteve, por në përgjithësi ka tendencë të rënies. Totali i tyre vjet nuk ka arritur nivelin e vitit 2007, ku atëherë ishin 441 milionë euro, krahasuar me vendet e rajonit, kjo shumë është dukshëm më e vogël, pos në Bosnjë-Hercegovinë, pikërisht për shkak të problemeve politike, si dhe për shkak të fakteve se ai është shtet jofunksional.

Nëse themi se të gjitha ligjet i kemi në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, pastaj se po bëhen përpjekje për zbatimin e reformave substanciale me qëllim për përmirësimin e pozicionit të Kosovës, në listën e Bankës Botërore, atëherë Qeveria duhet ta pyesë veten, por edhe ta gjejë përgjigjen, se përse investitorët e huaj po e anashkalojnë Kosovën?

Janë shqetësuese zhvillimet në tregun e çimentos. Kjo nuk ndodh për shkak të një vendimi të ministres së Tregtisë dhe Industrisë, por për faktin se aplikimi i ngarkesës 35% në çimenton e importuar, pa marrë parasysh arsyetimet se një kompanie i krijohet pozitë favorizuese në treg, sado që vendimi mund të ketë mbështetje në ligj, por ai krijon favore për kompaninë, që mund të mbulojë maksimumin deri në 60% të nevojave të tregut kosovar. Normalisht se nevojat tjera do të plotësohen nga importi, i cili tash mund ta rrisë koston e ndërtimit, meqenëse çimentoja do të hyjë në vend me çmim 35% më të lartë. Për më keq, vendimi merret në pikën e sezonit të ndërtimit, përkatësisht kur kërkesa është në rritje.

Po ashtu, përpallja e investitorëve, përkatësisht bizneseve, reflekton pasiguri dhe jo stabilitet, meqenëse gjendja në treg, e cila duhet të krijohet në bazë të ofertës dhe kërkesës, ndryshon përnjëherë me ndërhyrje arbitrare nga nivelet qeveritare.

Sigurisht se investitorët do të hamenden se a duhet të hyjnë në tregun, ku Qeveria krijon favore dhe mbron një prodhues, apo ku nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta e rregullon pozitën e kompanive në treg.

Dhe, dje, Doganat e Kosovës ia kanë bllokuar Sharrcevit 12 maune, të cilat nga Maqedonia ishin drejtuar nga Kosova nën dyshimin se ka deklaruar rrejshëm, se është lëndë e parë si “klinker”, ndërsa ka ngarkuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Falemnderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qeveritarë,

Po e ngre një problem, që përsëritet që disa vjet me radhë në komunën e Gjilanit, e që ka të bëjë me menaxhimin e deponisë së hedhurinave apo më konkretisht, me mosmenaxhimin e saj nga Agjencia për Menaxhimin e Deponive Regjionale.

Po bëhet plot një javë nga shpërthimi i zjarrit në atë deponi, në fshatin Velekincë, me çka bëhet e pamundur edhe jeta aty në fshatrat përreth: Velekincë, Uglar, një pjesë e Malishevës. Tymi dhe gazi i liruar po e ndot me të madhe ambientin me materie toksike, që lirohen dhe për pasojë jeta e banorëve vështirësohet përditë e më shumë.

Po ashtu, është permanent rreziku për përhapjen e zjarreve duke pasur parasysh edhe temperaturat e larta, të cilat i kemi në këtë kohë.

Që nga viti 2010, për çdo vit, shërbimi i zjarrfikësve dhe shpëtimit harxhon rreth 300 mijë litra ujë të pijshëm për ta fikur zjarrin, ndërkohë që janë standardet me të cilat ka mundësi të mirëmbahet ajo dhe që njihen mirëfilli nga ata të cilët menaxhojnë me të.

E tërë kjo flet për seriozitetin e Qeverisë sonë në përkushtimin e saj në ruajtjen e ambientit. Ajo është shumë e zonja në vjeljen e taksave nga qytetarët, qoftë për mbeturinat, qoftë tani edhe me të renë, me taksën ekologjike, ndërkohë që kur është puna t'i kthejë shërbimet në ruajtjen e ambientit, aty puna ngec.

Ndoshta, rolin më të madh që është kah e luan Qeveria është roli i arkëtarit tash për tash, me kusht që edhe fati i arkës të mos përfundojë sikur Dhoma e Dëshmive në Pejë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e kanë kërkuar ministri Beqaj dhe zoti Rashiq.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Falemnderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni, meqenëse u parafrazova pak më herët, t'i bëj disa informime për Kuvendin dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, disa sqarime substanciale, lidhur me përgjegjësitë institucionale, të cilat ekzistojnë në Republikën e Kosovës.

Të ju them që ekonomia e tregut duhet të ndahet nga politika. Kosova në vazhdimësi, që nga viti 2007 ka rritje ekonomike mesatarisht 5%, ka rritje të investimeve të huaja në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kjo është paraqitur edhe në qëndrueshmërinë jashtëzakonisht të fuqishme financiare edhe në raportet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Pra, ekonomia e tregut nuk është politikë, vetëm rishikim apo shikim i titujve gazetaresk, por është një analizë e mirëfilltë ekonomike, e cila rrjedh me rezultate konkrete.

Lidhur me atë se sa është rritur çmimi i energjisë, dua të ju bëj me dije, deputetë të nderuar, qytetarë të Republikës së Kosovës, se çmimin e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës e cakton Zyra e Rregullatorit, e cila i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Zyra e Rregullatorit është ajo e cila merr dhe rregullon parametrat rregullativë në harmoni me një vendim të mëhershëm të Kuvendit edhe për rritjen e tantimës dhe parametra tjerë, të cilët janë përcaktuar, kanë ardhur deri te një konkludim, se kjo është forma dhe nevoja për një çmim të energjisë.

Prandaj, ju lutem, kur të flisni për furnizim me energji, kur të flisni për shtrenjtim, ju lutem, vetëm koncentrohuni në bazën institucionale të mirëfilltë, sepse do të ishte jokorrekte, në aspektin profesional të mos e dimë se kush është përgjegjës dhe kujt duhet t'i përgjigjet për atë.

Pra, Zyra e Rregullatorit të Energjisë është përgjegjësi e Kuvendit, është dokument... po edhe këtu është edhe një shprehje tjetër, zoti deputet, që as procedura për propozim nuk e dini nga kush vjen. Procedura vjen nga ndërmarrjet publike, të cilat gjithashtu i përgjigjen, nëpërmjet vendimeve të drejtpërdrejta edhe Kuvendit. Prandaj, ju lutem, kini parasysh që Zyra e Rregullatorit është ajo, e cila ju përgjigjet juve.

Dhe, për çdo informacion lidhur me parametrat rregullativë, lidhur me çmimin e energjisë, lidhur me funksionimin e tregut, dhe rregullimin e tregut të energjisë, thirrni ata, sepse ata janë përgjegjës para jush, ju i keni emëruar, ju i keni në përgjegjësi, dhe normalisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik është shumë e kujdesshme në zhvillim ekonomik dhe nuk ka asnjë ingerencë të veçantë në raport me Zyrën e Rregullatorit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Rashiq e ka fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Gospodine premijeru,

Zamenici premijera,

Poštovani kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Žao mi je što gospodin poslanik nije ostao tu da čuje moje činjenično stanje što se tiče “Behtel&Enka”.

Ja izražavam moje saučesće za porodicu poginulog radnika, ali što se tiče same kompanije “Behtel&Enka”, to je inače kompanija koja je u samo 2011. godinu imala 6.370 različitih vrsta inspekcija. Prema tome, povodom svog tog dela i inspekcije koje smo uradili, mogu odgovorno da vam kažem da je “Behtel&Enka” kompanija poslodavaca koja je najpreciznije, najbolje tehnički, najviše poštuje zakonske norme i pre svega najviše radi na tome na zaštitu na radu.

Prema tome, ono što se dešava ponekad, je stvarno na veliku žalost, desi se zbog drugih faktora, a taj faktor nije njeno zapostavljanje od strane “Behtel&Enka”. I ja opet pozivam i vas, kao što sam pozvao i pre dve nedelje i sve članove poslaničke grupe za socijalno staranje, da još jednom posetimo “Behtel&Enku” na terenu, da se uverite još jednom šta je sve preduzeto u merama zaštite radnika na terenu.

Prema tome, ponavljam još jednom, što se tiče same zaštite radnika, što se tiče pravnih procedura i poštovanja zakona, “Behtel&Enka” je sigurno kompanija koja to prati doslovno u svakom delu zakona, koji je na snazi. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Falemnderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra, deputetë të nderuar,

Ndihem tepër mirë kur dëgjoj që flitet për Mitrovicën, por është më mirë për të punuar për Mitrovicën se sa të flitet për Mitrovicën.

Pasi jam nga Mitrovica, në Mitrovicë janë duke ndodhur investime të fuqishme, kryesisht investime që vijnë nga Komisioni Evropian. Kjo si rezultat i një qeverisjeje të mirë në këtë komunë, i një bashkëpunimi dhe procedurave transparente dhe regjioni i Mitrovicës do të jetë regjioni i parë në Kosovë që do ta zgjidhë problemin e furnizimit me ujë.

Gjatë vitit 2012 dhe vitit 2013, vetëm në sektorin e ujërave, kapaciteteve për prodhimin e ujit, rrjeteve primare, do të investohen mbi 20 milionë euro. Gjithashtu, si projekt bashkëfinancimi i Komisionit Evropian dhe institucioneve të Kosovës është projekti tjetër, i cili ka të bëjë me sportin, me kulturën, me ambientin, me punësimin.

Ky projekt kap vlerën mbi 24 milionë euro. Për dy vjet, brenda Mitrovicës dhe regjionit të saj, konkretisht vetëm në qytetin e Mitrovicës pritet të investohen rreth 60 milionë euro.

Sigurisht se të gjitha këto projekte do të implementohen duke i respektuar të gjitha procedurat dhe ligjet në fuqi. Se a do të pritet një plep, një shelgje apo një bagrem, është çështje e ekspertëve, mirëpo këto janë fonde dhe investime, të cilat po ndikojnë në kualitetin e jetesës së qytetarëve në Mitrovicë.

Mitrovica asnjëherë në histori nuk ka pasur investime më të fuqishme se tani edhe në pjesën e veriut të saj, por edhe në pjesën jugore. Shifrat dhe faktet flasin për këtë.

Qytetarët janë duke e parë zhvillimin e këtyre projekteve, janë duke e ndjerë zhvillimin e këtyre projekteve, do të benefitojnë nga këto projekte dhe të gjitha projektet janë duke u bërë brenda rregullave dhe standardeve.

Ndërsa, sa i përket projektit konkret, është një projekt 24 milionësh. Është projekt për të cilin procedurat janë udhëhequr në bazë të rregullave, të cilat i ka përcaktuar Komisioni Evropian, duke marrë në konsideratë edhe çështjet ambientale. Dhe, këto projekte janë duke u zhvilluar për ta përmirësuar ambientin, e jo për ta degraduar atë.

Prandaj, kjo është e vërteta dhe sigurisht se këto investime të fuqishme do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Replikë, zonja Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ministër, po shihet që ligjërimin e ke deformim profesional.

Por, puna jote është për të punuar, për ta përmirësuar gjendjen ekonomike në vend, të paktën kështu e ka emrin sektori, të cilin e përfaqëson.

Se a mjafton rritja prej 5% në Kosovë, që është vendi i 9-të më i varfër në botë, e dinë edhe ata që janë laikë, që nuk mjafton, e para.

Dhe e dyta, a bën të na tregosh se ku janë ato investime, sa vende pune, prej... ju kam pyetur edhe një herë, “Planit të Banjskos” janë hapur në Kosovë, në cilat komuna, në cilët sektorë? Ta kemi pak më të qartë edhe ne, edhe qytetarët e Kosovës, sepse ajo çfarë ne po takojmë çdo ditë në terren, është papunësi tepër e madhe, është shqetësim shumë i madh.

Edhe një herë po them, për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, rritjen e çmimit të bukës, që ka ndodhur më herët, rritjen e çmimit të çimentos, që po ndodh tani. Dhe, nuk po shohim që kjo po sjell zhvillim, përkundrazi po sjell edhe varfërimin edhe më të madh të një vendi, i cili, po e përsëris është në vendin e 9-të në listën e vendeve më të varfra të botës.

Dhe, nëse ju jeni të kënaqur, kënaquni, por qytetarët e Kosovës janë duke hequr.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Falemnderit, zonja deputete!

Dua të them që rritja ekonomike në Kosovë është 5%. Kemi rritje të pagave prej 30 deri në 50%, kemi rritje të buxhetit në periudhën prej kur në vitin 2007 partia juaj ka qenë në pushtet, për mbi 100% rritje të buxhetit, kemi investime kapitale deri në 40% të GDP-së dhe të buxhetit, në përgjithësi.

Pra, flasim për fakte të rëndësishme, të cilat qytetarët po i ndiejnë. Dua të ju them që jo gati, por 5 muaj të tërë nuk ka asnjë lloj reduktimi të energjisë elektrike për ata të cilët e paguajnë atë.

Edhe një herë dua të jua bëj me dije, ju lutem, jeni deputete, duhet të flisni në mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme kur flisni para qytetarëve, sepse do të ishte jo e falshme që një deputet të mos e dijë se kush është përgjegjës për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, përderisa vetë atë institucion ju e monitoroni. Falemnderit!

KRYESUESI: Zoti Kasolli, replikë.

AFRIM KASOLLI: Falemnderit, kryesues!

Ministër, fillimisht falemnderit për ftesën, por ato që i thashë unë nuk janë konstatime spekulative, por janë fakte reale, të cilat i kam vizituar dhe vetë.

Sa i përket inspektimit, që e keni përmendur, unë nuk e përjashtoj mundësinë që keni bërë inspektime, por çka pas inspektimeve. Pra, do të thotë çështja nuk është që të inspektohet, por që të intervenohet, të korrigjohet dhe të sanohet ajo gjendje.

Dhe, ju vetë keni deklaruar në pyetjen time parlamentare, kur ju kam thënë se pse nuk zbatohet Ligji i punës, keni thënë nuk mund të zbatohet Ligji i punës për shkak se “Behtel&Enka” ka ardhur para se të implementohet Ligji i punës. Ajo ekziston në procesverbal, ekziston në dokumentet e Kuvendit dhe mund të hetohet. Falemnderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Rashiq.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine poslaniče!

Ponoviću još jednom. Prošle godine je bilo 6.370 inspekcija, koje su obavljene na različitim poljima u “Behtel&Enki”. A ukoliko vi budete našli mesto, na kome sam ja rekao da “Behtel&Enka” ne sprovodi ili ne poštuje Zakon o radu, ja sam tu pred vama. A iako je “Behtel&Enka” ušla pre Zakona o radu, mi smo i tad postavili norme, koje su bile vrlo precizne oko zapošljavanja radnika.

Pored toga, naglasiću još jednom, i vrlo je bitna stvar, sve mere za zaštitu radnika, žalosno je što moram da kažem i to, ali nijedna druga naša domaća kompanija ne ispunjava u onoj meri u kojoj to radi “Behtel&Enka”. I to možete, opet pozivam, na zajedničku posetu gde mogu, pre svega, da vas uputim sa 6.370 različitih kontrola, i posle toga zajedno da odemo na mesto događaja, gde god da pravi “Behtel&Enka”, na kojoj god relaciji, da odemo i da se sami uverite i u...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! Për replikë është paraqitur Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Falemnderit!

Është vërtet e çuditshme se si Qeveria merr qëndrim defansiv edhe për çështjet, që vërtet janë thjesht shqetësime të qytetarëve, e krejt çka ishte dashur të bënte është ta japë një sqarim.

Ajo që e shtrova unë, zoti ministër, nuk ka të bëjë me ujin, nuk ka të bëjë me atë se dikush po e konteston a ka pasur apo nuk ka pasur zhvillim ekonomik, përkundrazi është çështje e pastër e ambientit.

As nuk e kontestova nëse ka apo nuk ka projekte në Mitrovicë, prandaj nuk e kuptova pse përgjigjja juaj u koncentrua aty. Unë e thashë të kundërtën, që mirëpritet nga qytetarët një projekt i tillë, përfshirë edhe mua.

Ajo çka kërkova unë është që Komisioni Evropian, bashkë me ju, ta shqyrtojë shkatërrimin e një parku, sepse kryetari i Mitrovicës, për dallim nga ju e ka pranuar që po shkatërrohet një pjesë e tërë, po hiqen lisat e bagremët, që s’qenkan të rëndësishëm për ju dhe po mbillen fidanë të rinj nga Italia, gjë që, siç e thashë, është kundër biodiversitetit. Prandaj, koordinohuni me kryetarin e juaj!

Dhe e dyta, Komisioni Evropian asnjëherë nuk ka deklaruar se ekspertët e tyre e kanë bërë këtë vlerësim. Unë u bëj thirrje, në qoftë se e kanë bërë, le të dalin e ta thonë publikisht, që nuk po preket ambienti, në qoftë se po, ne do ta përkrahim publikisht, nga ai moment.

KRYESUESI: Falemnderit! Kundër-replikë, zoti Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Falemnderit, deputete e nderuar!

Dhe, më vjen mirë që pajtohem, që këto projekte po kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë ne që po jetojmë në Mitrovicë.

Mirëpo, s'ka logjikë që të mbetet një projekt prej 24 milionë eurove pa u implementuar, pa rregulluar shumë çështje, që s'po dua të hyj në specifikat e këtij projekti, për shkak se po u dashkan të largohen disa, pasi jemi nga Mitrovica, edhe e dimë atë park, të largohen disa plepa, që janë të kalbur, janë të tharë, pa shelgje dhe të rigjenerohet ai park, sepse edhe plepat e kanë kohëzgjatjen e vet, e kanë kohën e jetesës, ata janë tharë dhe plepat e tharë duhet hequr dhe të rigjenerohen me të rinj.

Prandaj, sigurisht se do ta kemi fatin që bashkërisht të shkojmë dhe t'i përjetojmë kënaqësitë e këtij projekti, kur të përfundohet. Falemnderit shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryesues!

Unë vërtet, meqenëse u krijua hapësira tash për të replikuar, nuk e kisha ndërmend të replikoj, por në emër të Grupit Parlamentar unë nuk e pranoj atë që e thotë zoti ministër, se dihet kush e kontrollon Zyrën e Rregullatorit, që i bie - ne jemi fajtorë si deputetë pse qenka rritur çmimi i energjisë elektrike.

Kjo nuk qëndron, kjo është e pavërtetë. Mos harroni se Zyra e Rregullatorit është mbushur me militantë të PDK-së, zoti Beqaj, të partisë tënde. Ne nuk e kemi votuar atë bord. Po ashtu, subvencionimi që i është bërë KEK-ut, dihet se çfarë shume është dhe është dhënë çdoherë, por me mundësi që të kthehen ato mjete, e nuk janë kthyer asnjëherë.

Prandaj, mos e fajësoni Kuvendin, se qytetarët nuk duhet të manipulohen, se Kuvendi nuk ka marrë vendim për t'u rritur çmimi i energjisë, por ka marrë një bord, të cilin e keni mbushur me militantë të partisë.

Prandaj, mos tentoni ta hidhni fajin ku nuk është. Prandaj, nuk qëndrojnë këto që i thoni ju. Mos flitni të pavërteta!

KRYESUESI: Falemnderit! Kundër-replikë, zoti Beqaj. Një minutë.

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuari deputet,

Është shumë me rëndësi që kur të flasim para qytetarëve, të flasim, prapë po e them, me përgjegjësi.

Bordi paraprak, në vitet paraprake, i cili është udhëhequr nga njerëz të fuqishëm, të cilët janë edhe pjesë e partisë suaj, vitin e kaluar ka bërë kërkesë për rritje të energjisë elektrike për 23% dhe të gjitha vendimet, të cilat merren në Zyrën e Rregullatorit dhe nga Bordi i Rregullatorit, mund t'i diskutojë vetëm dhe vetëm Parlamenti.

Kjo është baza rregullative ligjore, prandaj ju ftoj që për sqarime të kësaj natyre të komunikoni me Bordin. Dhe, dua të ju them që si asnjëherë deri më tash, Bordi është komplet i depolitizuar dhe është bord jashtëzakonisht profesional. Bordi ka qenë i politizuar dhe arsyet për mosvotime kanë qenë të politizuara, gjithashtu nga ana juaj.

Prandaj, dua ta sqaroj këtë çështje dhe një çështje tjetër, sepse i keni përzier dy komponente të rëndësishme lidhur me KEK-un...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Kadaaj-Bujupi, replikë me ministrin Beqaj.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ministër, dje në Pejë nuk ka pasur rrymë 24 orë. Është mirë të dilni nga pak edhe prej fakultetit ku ligjëroni, edhe prej zyrës, ku rrini, se nuk bën kurrëgjë, e të merrni vesh si është gjendja në terren. Dje, 24 orë, s'ka pasur rrymë në Pejë.

Uji, që është resurs nën përgjegjësinë nacionale, është resurs nën përgjegjësinë e Qeverisë dhe e keni bordin me plot militantë atje në ujësjellës, absolutisht nuk ka ujë të pijshëm, as në Prishtinë, e as në vendet e tjera, në temperaturën 35 gradë. Jo pse nuk ka Kosova resurse, por pse ju nuk dini ku duhet investuar. Nuk e keni me prioritet investimin në ujësjellës dhe në infrastrukturë, po i lini qytetarët të heqin çdo verë.

Sa për këtë 5%-shin e rritjeve që po e përmendni, projeksioni i rritjes së çmimeve prej vitit 2007 ka shkuar me mbi 50%, e ju po flitni për rritje 5%. Po më vjen shumë keq për gjendjen, në të cilën jeni edhe personalisht, po edhe në të cilën e keni sjellë Kosovën.

Kisha dashur t'u aplaudoj, se unë jam një ndër qytetarët e Kosovës, po nuk është ashtu. Siç e thashë në fillim, jeni ministër i ngecjes së ekonomisë së vendit, e jo ministër i zhvillimit.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Falemnderit, zori kryesues!

Kabinet qeveritar,

Unë me të vërtetë do të kisha dëshirë që të diskutojmë në nivel parlamentar dhe profesional.

Forma e trajtimit ad hoc të proceseve, siç po bëhet nga deputetja dhe informatat të cilat janë të selektuara, nuk i bëjnë nder asnjë personi me përgjegjësi publike.

Po ju them, që edhe rritja ekonomike, edhe rritja e pagave, edhe investimet në secilën komunë, në secilin qytet, në secilin fshat, te secili qytetar po ndihen. Sigurisht se kjo e juaja është pjesë e agjendës politike. Dhe, të ju them që ato borde, të cilave ju po u referoheni, nuk janë borde të cilat janë themeluar në mandatin e kësaj Qeverie, janë borde që janë themeluar në mandate tjera.

Dhe, normalisht, ka aty shumë e shumë njerëz të tjerë. Por, po e them se përmirësimi i jetës së qytetarit dhe përmirësimi i zhvillimit ekonomik është vepër, e cila shihet anekënd Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

(Ndërhyrje)

E ke shfrytëzuar të drejtën. Jo, nuk ke të drejtë. Me Rregullore, jo! Jo, në emër të Grupit, ka diskutuar. Është kryer çështja e diskutimit.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

(Ndërhyrje)

Nuk ke të drejtë, Ismet. Miqësisht, unë mund të bëj çka të dua, por me rregullore nuk e kemi të drejtën për kundër-replikë.

(Ndërhyrje: Unë po flas në emër të Grupit.)

Unë po e shfrytëzoj të drejtën si kryesues të ta jap fjalën, por të drejtë nuk ke. Regjia, zotit Beqiri fjalën, për një replikë të re.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryesues.

Ky Kuvend, i ka dhënë KEK-ut miliona euro me obligim që ato të kthehen më pas, por kjo nuk ka ndodhur. Dhe, nuk qëndron, kur flasim për bordet dhe profesionalizmin, ky Kuvend ka hequr një njeri profesional, që nuk ka qenë në parti kurrë, absolutisht nuk qëndron ajo dhe sot dihet kush e udhëheq dhe si udhëhiqet.

Por, ajo që ka qenë poentë dhe, po e përsëris, është, mos tentoni për t' ia lënë fajësinë këtij Kuvendi dhe deputetëve, se ata janë fajtorë për ngritjen e çmimit të energjisë elektrike? Kjo nuk është e vërtetë.

KRYESUESI: Zoti Beqaj, kundër-replikë, një minutë, dhe mbyllet kjo.

MINISTRI BESIM BEQAJ: E kisha lutur deputetin që vetëm një emër le të ma thotë, cili nga kandidatët është anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës, sepse bordi si i tillë është bord, po e them profesional, pa asnjë përzierje të kompetencave.

KRYESUESI: Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin e Drejtësisë - Hajredin Kuçi. Deputetja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Më 27.5.2011, në një takim të mbajtur me 12 përfaqësues të të gjitha pavijoneve në Burgun e Dubravës, ju zoti ministër patët premtuar që do të filloni së hartuari Ligjin për amnisti.

Pyetja është: Në çfarë faze keni arritur me hartimin e Projektligjit për amnisti?

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Falemnderit zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Falemnderit e nderuara deputete për pyetjen tuaj,

Më lejoni të theksoj që me marrjen e informatës se ka pasur një grevë në Burgun e Dubravës, kam takuar përfaqësuesit e tyre dhe u kam premtuar se do ta procedoj kërkesën për ndryshimin e Kushtetutës, për ta vënë institutin e amnistisë në Kushtetutën e Kosovës.

Në prill të vitit të kaluar, respektivisht në maj, kam dërguar letër te Presidentja e Republikës së Kosovës, te kryetari i Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës, profesor Bajrami, te kryetari i Kuvendit dhe te kryetarët e partive politike, që janë të përfaqësuara në Parlament, duke kërkuar që të mbështetet kërkesa ime për amendamentimin e Kushtetutës dhe vënien e institutit të amnistisë në Kushtetutë.

Me përjashtim të profesor Bajramit, nga i cili kam marrë një përgjigje, që dua ta falënderoj edhe publikisht, që ka kërkuar që Komisionit Kushtetues t'i jepet mandat shtesë për një çështje të tillë, përgjigje të tjera nuk kam marrë. Mu për këtë, në mbledhjen e radhës së Qeverisë, në qershor, kemi vendosur dhe kemi propozuar amendamentimin e Kushtetutës, duke e shfrytëzuar të drejtën e Kushtetutës, që Qeveria propozon amendamentimin e saj.

Unë dua të besoj që Komisioni Kushtetues, Gjykata Kushtetuese, Kuvendi do ta miratojnë këtë dhe Kuvendi i Kosovës do ta bëjë një ligj për amnisti, i cili do të jetë një ligj modern, transparent dhe do të ndikojë edhe në rehabilitimin e marrëdhënieve ndërmjet popujve në Kosovë.

KRYESUESI: Falemnderit! A ke pyetje shtesë, deputete?

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Atëherë, unë nuk pashë ndonjë rezultat në lidhje me shqyrtimin, pra draftimin e Ligjit për amnistinë, pasi ju vetëm u keni premtuar më 27 maj, për të cilin e kam formularin këtu para vetes.

Atëherë, pse nuk keni bërë amendament të veçantë në lidhje me çështjen për Ligjin për amnisti?

Përveç kësaj, përderisa më 23.5.2011 ju keni premtuar që do të filloni së hartuari Ligjin për amnistinë.

Më datën 7 shkurt, në një dëgjim publik të Komisionit për Legjislacion, ju keni thënë që është kundërkushtetuese, ndërsa atyre nuk u keni thënë që është kundërkushtetuese, e unë them që kjo nuk është kundërkushtetuese, pasi Sllovenia dhe Maqedonia nuk e kanë në Kushtetutë amnistinë, por e kanë të rregulluar me Kodin Penal.

Dhe ju, përveçse nuk e keni hartuar ligjin për amnisti, e keni hequr amnistinë edhe nga Kodi Penal si institut i së drejtës romake. Pra, pse po i mashtroni të burgosurit në Burgun e Dubravës dhe kudo tjetër ku janë?

KRYESUESI: Zoti Kuçi e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, deputete!

Unë mendoj që kësaj radhe e bëre një shkarje në kuptimin profesional, po them. Besoj që ju i njihni çështjet juridike dhe besoj që një institut që nuk njihet me Kushtetutë nuk mund ta hartojë dikush një ligj.

Dhe, unë po e them kështu, unë kam qenë kryetar i Komisionit Kushtetues në atë kohë dhe unë e di pse nuk ka hyrë instituti i amnistisë. Ka edhe tjerë në këtë sallë që e dinë dhe unë po e them edhe sot do të ketë rezistencë që të mos hyjë instituti i amnistisë në Kushtetutën e Kosovës. Unë i kam proceduar, ju thashë më herët, amendamentimet e Kushtetutës duhen të respektohen. Ditën që amendamentohet Kushtetuta, unë po ju premtoj që brenda një muaji ta sjellim ligjin për amnisti në Kuvend.

KRYESUESI: Deputetja Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ke marrë përgjigje, në rregull. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin e Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Është bërë publike që me urdhrin tuaj i është lejuar zëvendësministrit të Financave, Astrit Haraqija, njëherësh edhe i akuzuar për keqpërdorime, që ta vizitojë Ilir Tolajn në Burgun e Dubravës, i cili gjithashtu akuzohet për korrupsion gjatë kohës sa ishte sekretar permanent në Ministrinë e Shëndetësisë.

Pyetja është se me çfarë baze ligjore e keni urdhëruar një vizitë të tillë dhe cili është interesi juaj për lejimin e një vizite të tillë? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zonjusha deputete!

Sinqerisht, pasi u bë një zhurmë në media, është një shans i mirë që ta jap përgjigjen adekuate.

Unë i kam kërkesat e shumta në emër të ministrit të Drejtësisë lidhur me kompetencat që ka Ministria e Drejtësisë. Unë dua të them që kam kërkesa të natyrave të ndryshme, edhe për Shërbimin Korrektues të Kosovës. Duke filluar nga kërkesat për vizita private, për vizita studimore, po zëmë kërkesa e zotit Hasani që ka qenë për vizitën në rastin e përkujtimit të Masakrës së Dubravës, pastaj kërkesën e djeshme nga Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut për ta vizituar gjendjen në burgjet e Kosovës. Pastaj, e kam kërkesën nga ambasadat e ndryshme dhe misionet ndërkombëtare: Amnesty International, Human Rights Watch etj., për t'i vizituar burgjet. Dhe, në cilindo rast, po e them edhe në rastin konkret, unë nuk jap urdhër, unë nuk jap leje, unë nuk jap urdhër as me shkrim, as me gojë, por unë i procedoj te drejtori i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Edhe në rastin konkret, që e përmendni, nuk ka asnjë urdhër, nuk ka asnjë leje, ka vetëm një bartje të kërkesës te drejtori i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe bartja e kërkesës nuk ka ndodhur vetëm. Në praninë e pesë vetave, në mesin e tyre edhe një deputet i Kuvendit të Kosovës. Kjo do të thotë që s'ka urdhër, s'ka leje dhe s'ka asgjë gjë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, Albulena?

ALBULENA HAXHIU: Është absurde se si po merr shembuj tjerë, të cilët nuk kanë fare të bëjnë me shembullin, të cilin unë e përmenda.

Ju keni thënë që e keni ftuar drejtorin e përgjithshëm dhe i kam thënë: “procedo sipas ligjit dhe informatat që i ke vendosi sipas ligjit”. Ku ke të drejtë t'i thuash drejtorit “vendos sipas ligjit”? Ti a e di që kjo është shkelje ligjore dhe nuk lejohet që dy të akuzuar të takohen për t'i koordinuar deklaratat. A mos ndoshta është se edhe ju jeni përfshirë në këtë rast dhe ky është interesi juaj?

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Shiko, deputete, je duke folur nganjëherë si në pazar, nganjëherë si deputete. Në këtë pjesën e fundit si në pazar dhe më vjen keq nëse merresh me çështje ligjore dhe i thua ministrit të Drejtësisë, varësit tënd - nuk ke drejtë t' i thuash “vendos sipas ligjit”, edhe juve ju them vendos sipas ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Haradinaj, pyetje për ministrin Çeku. Deputeti nuk është këtu. Deputeti Burim Ramadani, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Pyetja ime është kjo: A keni plan konkret dhe nëse po, cilat janë saktësisht veprimet që do t'i ndërmerri për t'i fuqizuar kapacitetet e Policisë dhe Njësisë përgjegjëse për

Inteligjencën financiare, në mënyrë që të hetohen rastet komplekse të krimit të organizuar edhe të korrupsionit, duke përfshirë këtu me theks të veçantë shpëlarjen e parave dhe krimin ekonomik. Falemnderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Falemnderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ramadani,

Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit ka ngrehur kapacitete të mjaftueshme për hetimin e krimit ekonomik dhe të korrupsionit.

Me aprovimin e strukturës së re organizative është paraparë të rekrutohet një numër i caktuar i zyrtarëve, me ç'rast është i nevojshëm avancimi edhe ngritja e kapaciteteve. Në vitin 2002 janë organizuar apo janë paraparë të mbahen 8 trajnime për 68 zyrtarë policorë në fushën e krimeve ekonomike dhe të pastrimit të parave. Po ashtu, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit e ka hartuar planin vjetor të veprimit konform vërejtjeve dhe sugjerimeve të Raportit të Progresit, të vitit 2011.

Në fokus në luftimin e pastrimit të parasë dhe në kuadër të Njesisë për Hetime Financiare i ka themeluar tre sektorë të veçantë për hetimin e rasteve të pastrimit të parasë. Nën një, Sektori për Hetime Financiare, i cili ka një personel prej 7 hetuesve. Nën dy, Sektori për Pastrimin e Parasë, i cili ka një personel prej 4 hetuesve dhe nën tre, Sektori për Konfiskimin e Aseteve Kriminale, i cili ka një personel prej 4 hetuesve. Gjithashtu, kjo drejtori këtë çështje e trajton në bashkëpunim me Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe organizmat tjerë të zbatimit të ligjit, si dhe zbaton obligimet që dalin nga programi qeveritar për parandalimin e ekonomisë joformale në Kosovë, plani i veprimit 2010-2012, ku në këtë plan të veprimit trajtohet çështja e pastrimit të parasë.

Ndërsa, në Drejtorinë për Hetimin e Krimit të Organizuar është funksionalizuar Njësia për Hetimin e Krimeve Financiare të Integruara, e cila ka një personel prej 7 zyrtarëve policorë dhe një ekspert financiar. Po ashtu, Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Qendrore, Qendrën e Inteligjencës Financiare dhe agjencitë tjera të zbatimit të ligjit, në vazhdimësi monitoron qarkullimet financiare të dyshimta, të cilat kryhen nga persona dhe biznese të ndryshme, e gjithashtu si rrjedhojë e kësaj monitorohen edhe pasuritë e patundshme, të cilat mund të kenë prejardhje të dyshimtë. Sa për informim, Inteligjenca Financiare është transferuar komplet kompetenca në Ministrinë e Financave që ka qenë e përbashkët me EULEX-in dhe nëse duhet vetëm shkurt statistika, një krahasim i rezultateve në raportet janar-maj 2011 dhe janar-maj 2012.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! A keni pyetje shtesë, zoti Ramadani?

BURIM RAMADANI: Po.

Shkurtimisht, besoj se e dini se arsyeja e pyetjes sime është për shkak se ky është një prej kushteve në udhërrëfyesin e liberalizimit të vizave dhe në të njëjtën kohë besoj se ky kusht nuk mund të përmbushet, duke u adresuar në atë se çka ka ndodhur në vitin 2002, e në periudha tjera.

Pyetja prapë është: Çka saktësisht do të bëhet për t'i ngritur kapacitetet në mënyrë që ky kusht të plotësohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe kur do të plotësohet ky kusht? Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Mendoj që isha goxha i qartë për ngritjen e kapaciteteve dhe rezultatet natyrisht që përcillen edhe me statistika. Dhe, gjatë procesit të liberalizimit të vizave këto statistika duhet të jenë gati ditore dhe javore dhe është grupi i posaçëm teknik që informon. Dhe, ne jemi optimist se sa i përket kësaj, do të plotësohen në kohën e paraparë.

KRYESUESI: Falemnderit! Nuk ka pyetje tjera. Është një pyetje e deputetit Konjufca për zotin Hoxhaj, por deputeti nuk qenka këtu, kështu që mbetet për herën tjetër.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 14 qershor 2012

A ka vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka. Konstatohet që Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 14 qershor 2012. Në sallë janë të pranishëm 63 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës

Komisioni ad hoc për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i autorizuar me Rezolutën e Kuvendit lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, datë 31 janar 2012, e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Falemnderit!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Kosovës të prezantoj para Kuvendit ta Republikës së Kosovës Projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, që është miratuar në Qeverinë e Kosovës, më 21.3.2012.

Mbikëqyrja ndërkombëtare e pavarësisë së Kosovës e ka burimin në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës, i cili ka përcaktuar që komuniteti ndërkombëtar do ta kontrollojë, mbikëqyrë dhe do ta ketë tërë pushtetin e domosdoshëm për të siguruar implementimin efektiv dhe efikas të kësaj zgjidhjeje. Sipas përkufizimeve të ofruara në anekset 9, 10, 11 të këtij propozimi, rrjedh obligimi i Kosovës që ta ftojë bashkësinë ndërkombëtare që t'i ndihmojë në përmbushjen e suksesshme të veprimeve të veta.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në atë që Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 31 janar të këtij viti e ka nxjerrë Rezolutën për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, e cila do t'i mundësojë Kosovës që të vazhdojë në përparimin dhe zhvillimin e institucioneve vendore, duke e krijuar infrastrukturën adekuate ligjore dhe institucionale. Duke iu referuar Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, njëkohësisht duke e mirëpritur vendimin e Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën për të synuar përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës gjatë vitit 2012, si dhe të përkushtuar ndaj përmbushjes së gjitha obligimeve që kontribuojnë në përfundimin e kësaj faze të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë dhe duke pasur parasysh parimet kyçe të Planit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, po ashtu duke qenë të ndërgjegjshëm për respektimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka hartuar këtë projektligj që ka për qëllim t'i bëjë ndryshimet me disa projektligje, që do t'i përmend në vijim:

1. Në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
2. Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës,
3. Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
4. Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale,
5. Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
6. Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores 2001/35 për Fondin Pensional të Republikës së Kosovës,
7. Kodit doganor dhe akcizave të Kosovës,
8. Ligji për Administratën Tatimore dhe procedurat,
9. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
10. Ligji për gjykatat,
11. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
12. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës,

13. Ligji për liritë fetare në Republikën e Kosovës,
14. Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
15. Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
16. Ligji për kufijtë administrativë të komunave,
17. Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës,
18. Ligji për shtetësinë e Kosovës,
19. Ligji për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave,
20. Ligji për Forcën e Sigurisë,
21. Ligji për Shërbimi e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Që të gjitha këto ligje deri më tani kanë pasur mbikëqyrje të drejtpërdrejtë ndërkombëtare, e me këtë do të bëhet bartja e kompetencave nga institucionet ndërkombëtare te ato vendore. Qeveria e Kosovës synon që me përkushtimin e saj të plotë të punojë në drejtim të arritjes sa më të shpejtë dhe të suksesshme të realizimit të këtij synimi, që është nacional, në veçanti me kalimin me kohë të të gjitha amendamenteve kushtetuese dhe legjislacionit tjetër të nevojshëm për t'i dhënë fund mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Ky projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

Në hartimin e këtij projektligji janë konsultuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe po ashtu dua të them që kemi marrë pajtueshmëri paraprake edhe nga aktorët ndërkombëtarë, të cilët veprojnë në Kosovë dhe kanë pasur kompetenca në këto fusha. Po ashtu, më lejoni të ju informoj që veprimet e këtij projektligji, i cili deri më tani ka qenë i shpërndarë në ligjet e ndryshme, posa të hyjë në fuqi me ndryshimet kushtetuese do ta kenë efektin e plotë që parashihet rreth mesit të shtatorit të këtij viti. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Hap diskutimin. Fjalën e ka kryetari i Komisionit ad hoc për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Kosovës, dëshiroj të ju njoftoj se konform Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është duke u punuar intensivisht në ndryshimet e nevojshme të kuadrit kushtetues dhe ligjor të nevojshëm për përmbylljen e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Natyrisht që ky proces i rëndësishëm shtetëror kërkon një koordinim ndërinstitutional, pa të cilin nuk do të ishte e mundur të zhvillohej. Me këtë rast, dëshiroj ta falënderoj Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Zyrën Civile Ndërkombëtare, të cilat kanë treguar

një gatishmëri të pashoqe për bashkëpunim drejt përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë. Në mbledhjen e mbajtur javën e kaluar, komisioni e ka miratuar në parim pakon e ligjeve, të cilat kanë ardhur si propozim i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky miratim në parim njëherësh tregon gatishmërinë e shtetit për përmbylljen e mbikëqyrjes dhe përshtatjen e agjendave koordinuese para takimit vendimtar të Grupit Ndërkombëtar Drejtues, i cili do të mbahet më 2 korrik, në Vjenë.

Dëshiroj edhe njëherë të theksoj se edhe kësaj radhe votimi në komision për pakon e ndryshimeve është bërë me konsensus të plotë dhe me mbështetje të të gjithë anëtarëve që i kanë përfaqësuar partitë politike që kanë qenë të pranishme në mbledhjet e komisionit. Me këtë rast, si kryetar i komisionit, jam i detyruar t'i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për një bashkëpunim të shkëlqyeshëm, në mënyrë të veçantë ata që vijnë nga partitë politike opozitare dhe partitë e komuniteteve në pakicë, për koshiençën e treguar për ta përmbyllur këtë proces të rëndësishëm për shtetin e Kosovës.

Deri më tani komisioni ka mbajtur katër punëtori, në të cilat ka diskutuar kryesisht ndryshimin e ligjeve që ndërlidhen me përmbylljen e pavarësisë dhe në këtë pako është përfshirë pakojë prej 21 ligjeve, të cilat i përmendi zëvendëskryeministri dhe të cilat nuk po i përsëris për ta kursyes kohën. Komisioni e ka analizuar thellësisht dhe detajisht këtë pako të ligjeve dhe ka vërejtur se me këtë pako parashihen tri lloj ndryshimesh. Pjesa e parë e ndryshimeve janë krejtësisht të karakterit teknik edhe në pakon e amendamenteve kushtetuese, por edhe të ligjeve është propozuar se çdo kund ku përmendet prania civile ndërkombëtare, të fshihet edhe në Kushtetutë dhe në ligje dhe të bartet kjo kompetencë tek autoritetet ndërkombëtare.

Ne jemi duke i studiuar edhe ligjet tjera, përpos këtyre 22 ligjeve, mos edhe në ndonjë ligj kemi referenca për përmendjen e pranisë civile dhe si komision jemi të gatshëm të bëjmë spastrimin edhe të ligjeve tjera.

Pjesa e dytë e ndryshimeve janë të karakterit të bartjes së kompetencave. Me shuarjen e misionit ICO-s dhe me përfundimin e paketës së Ahtisarit, shuarjes së paketës së Ahtisarit, shumë kompetenca, të cilat kanë qenë tek autoritet ndërkombëtare, barten te institucionet vendore dhe komisioni me kujdes është duke e shqyrtuar se cilat nga këto kompetenca kalojnë te kryeministri e cilat te Kuvendi, varësisht nga kompetencat kushtetuese të Qeverisë dhe të Kuvendit.

Pjesa e tretë e ndryshimeve ka të bëjë me të drejtat dhe liritë fetare të qytetarëve dhe komisioni është duke i diskutuar këto. Dëshiroj të theksoj se të gjitha këto ndryshime dhe plotësime janë konform pakos së Ahtisarit, janë konform obligimeve që ka Kosova në raport me implementimin e plotë të Planit gjithëpërfshirës, por komisioni gjatë punës i ka bërë amendamentet e veta, të cilat tani nuk i prezanton për shkak se jemi në leximin e parë. Komisioni do t'i presë edhe vërejtjet e deputetëve të partive politike, por ndoshta edhe amendamentet që vijnë edhe nga Qeveria, e në mënyrë të veçantë ne do ta presim rezultatin e mbledhjes së Grupit Ndërkombëtar Drejtues për kërkesa të reja dhe komisioni me kohë do t'i dorëzojë amendamentet e veta në raport me këtë pako të 22 ligjeve. Njëkohësisht, komisioni do t'i japë edhe rekomandimet sa i përket paketës së

amendamenteve kushtetuese, të cilat tanimë janë kthyer nga Gjykata Kushtetuese, me një opinion pozitiv, duke mos përfshirë vetëm një amendament, që ka të bëjë me të drejtën e refugjatëve. Dhe, ne si komision jemi të gatshëm ta respektojmë edhe agjendën kohore, sepse ky proces e ka një agjendë kohore dhe ne do të jemi të gatshëm që për leximin e dytë ta përgatisim komplet pakon e amendamenteve dhe do ta propozojmë njëkohësisht miratimin e plotë të kësaj kornize kushtetuese dhe kornizës ligjore.

Të nderuar kolegë deputetë, e tha edhe zëvendëskryeministri, ky proces nuk është veç një proces legal, por është edhe një proces shumë i rëndësishëm politik. Është një e arritur e madhe për Kosovën, është një e arritur e madhe për bashkësinë ndërkombëtare, që krahës partneritetit të përbashkët që kemi pasur para katër vjetëve, kur e kemi shpallur dhe krijuar shtetin tonë, tani e kemi një partneritet për ta avancuar Kosovën, për t'i dhënë Kosovës sovranitet të plotë, për t'i dhënë Kosovës të drejtën që ta qeverisë plotësisht veten dhe që Kosova si shtet me kompetenca të plota të hyjë në agjenda evropiane në pozitat e barabarta me shtetet tjera.

Kështu që ne si komision i propozojmë Kuvendit që ta miratojë në parim këtë pako të 22 ligjeve dhe natyrisht të gjitha vërejtjet, sugjerimet që ju, të nderuar kolegë deputetë, grupe parlamentare, do t'i jepni, komisioni do t'i shqyrtojë me kujdes dhe do t'i marrë parasysh me rastin e leximit të dytë dhe prezantimit të raportit final për miratim, sigurisht diku në sesionet pas pushimeve verore. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Sipas radhës fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, respektivisht kryetarët.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka kërkuar zoti Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë zakonisht flas ulur, por meqë është fjala për një projektligj shumë të rëndësishëm, sidomos për qëllimet që i ka vetë projektligji, dola që ta nderoj vetë qëllimin e projektligjit.

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përmbarimin e mbikëqyrjes së pavarësisë dhe konsideron se projektligji është i veçantë për dy aspekte. E para për teknikën legjislative, e cila përdoret, që është shumë e veçantë, dhe e dyta për synimin që e ka projektligji që ta heqë mbikëqyrjen e pavarësisë.

Teknika legjislative është e veçantë. Kemi dëgjuar edhe disa mendime ndryshe sa i përket teknikës legjislative nga disa organizata që kujdesen për demokracinë në Kosovë, por mendoj se edhe vetë mbikëqyrja e pavarësisë është e veçantë, është e pazakonshme, sikur që edhe shumë procese në këtë vend që jemi detyruar t'i kryejmë në mënyrë të veçantë, prandaj edhe projektligji është i veçantë në aspektin e teknikës legjislative. Dhe, ne

mendojmë se është mënyrë pragmatike e ndryshimit të 21 ligjeve, që kanë të bëjnë me heqjen e mbikëqyrjes së pavarësisë dhe mendojmë që është legjitim dhe kushtetues.

Sa i përket synimit të projektligjit nuk kam nevojë të flas shumë. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka projektligji në raport me synimin që synon.

Gjithashtu, shpresojmë se do të vazhdojë bashkëpunimi i fuqishëm i të gjithë përfaqësuesve të subjekteve në Parlament, minoritare e opozitare, sa i përket amendamentimit të këtij projektligji. Dhe, dëshiroj t'i falënderoj me këtë rast edhe për punën që e kanë bërë deri këtu të gjithë përfaqësuesit e partive politike në Parlament dhe njëkohësisht inkurajoj, ndonëse është e pazakontë për t'i inkurajuar, ta votojnë Projektligjin për heqjen e mbikëqyrjes të pavarësisë, por sidoqoftë t'i inkurajojmë të gjithë deputetët që ta votojmë në lexim të parë dhe që të jemi bashkë edhe në amendamentimin e këtij projektligji shumë të rëndësishëm për vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Natyrisht që edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu siç është shprehur edhe në fillim të këtij procesi, kur është miratuar pothuajse njëzëri në këtë Parlament vendimi që të hiqet mbikëqyrja ndërkombëtare e pavarësisë, edhe sot fuqishëm do ta përkrahë përfundimin e këtij procesi.

Mendoj që është me rëndësi që përfaqësuesit politikë të Kosovës të tregojnë që të janë të gatshëm ta marrin në duart e tyre të ardhmen e vendit, duke e bërë tranzicionin apo kalimin e kompetencave që kanë qenë deri tani në disa nga institucionet ndërkombëtare, në ato vendore. Natyrisht që ky projektligj, siç u tha edhe nga parafolësi, është i veçantë për nga teknika dhe mënyra si është propozuar, sepse me një projektligj të vetëm propozohet që të ndryshohen 22 të tjera. Kjo nuk ka ndodhur më herët në praktikën parlamentare të Kuvendit, megjithatë ne jemi informuar se Kryesia e Kuvendit e ka miratuar që kjo të shkojë në këtë mënyrë.

Gjithashtu, me siguri e keni parë që edhe titulli i ligjit është i pazakontë. Desha t'i informoj deputetët që shumica prej këtyre çështjeve dhe shqetësimeve që u shtruan edhe më herët, janë përgatitur si amendamente nga Komisioni Kushtetues, mirëpo tani për tani ligji është propozuar si i tillë, siç është sjellë nga Qeveria, mirëpo amendamentet potenciale do të përfshihen ndërmjet dy leximeve.

Është me rëndësi që ato pak dispozita nga pakoja e presidentit Ahtisari që tani kanë mbetur të papërfshira në kornizën kushtetuese ligjore të Kosovës, që tani po përfshihen, të jenë në përputhshmëri edhe me Kushtetutën e Kosovës, sepse do të jetë e rrezikshme për Kosovën në qoftë se kemi ligje që kanë diskrepancë me Kushtetutën, sepse, pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, nuk do të ketë më pako të Ahtisarit. Akti më i lartë juridiko-politik në Kosovë do të jetë Kushtetuta, e jo pakoja e Ahtisarit.

Përndryshe, mua më duhet ta shpreh një çështje që ka të bëjë me këto 22 ligje, sepse ne në seancën e kaluar e miratuam Ligjin për menaxhimin e financave publike. Do të thotë, ai ligj është miratuar, megjithatë është propozuar edhe në këtë pako të 22 ligjeve. Unë propozoj që ky ligj të tërhiqet nga kjo pako, sepse është absurde që ta rimiratojmë një ligj që e miratuam në seancën e kaluar dhe i përfshimë të gjitha amendamentet që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Prandaj, para se të bëhet votimi në parim, i propozoj Qeverisë natyrisht që ta tërheqë këtë ligj, meqenëse ai tashmë u miratua dhe besoj edhe është në tavolinën e Presidentes për ta nënshkruar. Natyrisht, edhe njëherë po e përsëris që ne në parim do ta përkrahim këtë projektligj.

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kur po flitet dhe po thuhet se po përmbyllet mbikëqyrja e pavarësisë, asnjëherë nuk po kujtohen arsyet e kësaj mbikëqyrjeje, por as natyra e saj.

Kur flitej, pra në kohën e negociatave në Vjenë për arsyet e mbikëqyrjes së pavarësisë, në thelb të arsyeve zyrtare për këtë mbikëqyrje, ishin dy më madhoret. Thuhej se për një kohë pavarësia do të jetë e mbikëqyrur për shkak të pakicës serbe, pra për t’i bindur ata se pavarësia e Kosovës nuk do të jetë përndjekëse e shtypëse për ta dhe, në anën tjetër, që kjo do ta lehtësonte pranimin nga shtetet e botës për pavarësinë e Kosovës. Mbikëqyrja në këtë arsye të dytë kuptohej si një lloj garancie se Kosova do të sillte mirë si shtet, me përgjegjësi dhe se do të ketë sukses si e tillë. Prandaj, edhe na shitej si mbikëqyrje me afat të caktuar, duke u thirrur në momentin kur të dyja këto arsye do të binden se Kosova është e pjekur politikisht për të qenë sovranë, e pjekur për të jetuar e mëvetme, i cili moment do të na ishte ai i kurorëzimit të sovranitetit.

Pra, mbikëqyrja ishte në funksion të kushtëzimit që garantonte plotësimin e këtyre kushteve të denjësisë për të qenë shtet. Ne, pra, duhej të tregoheshim. Nuk flitej atëbotë dhe nuk po flitet sot fare për drejtësinë, për të drejtat kolektive që populli i Kosovës do të duhej t’i gëzonte për jetë të lirë në një shtet të vetin, të barabartë me të tjerët dhe të barabartë ndërmjet veti. Këto na suspendoheshin e mohoheshin, thua se ekziston një instancë demokratike globale që e ka monopolin mbi drejtësinë dhe e ndan atë ashtu siç ajo ka denjuar.

Pavarësia e Kosovës u bë me mbikëqyrje, ku në të vërtetë mbikëqyrësi ishte i pavarur nga Kosova dhe meqenëse e mbikëqyrte, nuk e linte Kosovën të bëhej e pavarur dhe sovranë. Kështu, pavarësia e mbikëqyrur u bë pavarësi e mbikëqyrjes, ndërsa sot prapë po thuhet - jemi në një situatë krejt tjetër. Sot jemi mbledhur këtu në Kuvend për ta kurorëzuar pikërisht këtë moment, momentin e kurorëzimit të sovranitetit nëpërmjet amendamentimit të një morie ligjesh prej të cilave formalisht po hiqet mbikëqyrësi. Kështu, të paktën po trumbetohet. Ky moment është trumbetuar gjatë ditëve të kaluara

dhe po trumbetohet edhe sot në këtë sallë të Kuvendit. Mendoj se kjo është një pyetje, të cilën secili deputet duhet t'ia shtrojë vetes sot.

Dhe, pyetja e dytë: Si po përmbillet, po qe se vërtet po u përmbyllka, ky proces i mbikëqyrjes së pavarësisë? Nenet e propozuara nëpërmjet këtij ligji që ndryshon 21 ligje, tregojnë qartë se mbikëqyrja nuk po përmbillet. Krejt çka po ndodh sot është se na janë propozuar për miratim disa nene, nëpërmjet të cilave hiqet roli i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, pra hiqet Piter Fejti nga kjo pozitë, dhe kaq. Ky është një shtrembërim i skajshëm i realitetit politik në Kosovë dhe reduktim i vrazhdë, por edhe i pavërtetë i një strukture të tërë e mjaft të gjerë të mbikëqyrjes.

Prandaj, është e domosdoshme ta kuptojmë drejt dhe qartë mbikëqyrjen në mënyrë që ta heqim atë përnjëmend. Mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës që në fakt është eufemizëm për suspendim të sovranitetit, për mossovranitet, shtrihet në dy rrafshë madhore: mbikëqyrja nga lart, e cila u ishte sipërvendosur institucioneve tona duke i mbikëqyrur, duke i mbajtur ato nën kërbacin e kompetencave ekzekutive për shkarkim ministrash e kryeministrash e anulim ligjesh, si dhe mbikëqyrja përbrenda nëpër institucionet më të rëndësishme të Kosovës, si në: Gjyqësi, Polici, Dogana, Privatizim, Administratë Tatimore, Trashëgimi Kulturor etj., ku ndërkombëtarët mbikëqyrës, qofshin ata të EULEX-it apo të PCN-së, e kanë fjalën e fundit dhe pushtetin ekzekutiv, shpeshherë të pavarur nga instanca vendore sikur në Gjyqësi e Polici, ku EULEX-i, përveç se ka pushtet ekzekutiv, ka të drejtë të merret me çfarëdo rasti që e shohin të nevojshëm, pa pasur kurrfarë nevojë për miratim paraprak nga Policia e Gjyqësia e Kosovës dhe madje kanë të drejtë të suspendojnë dhe të anulojnë çfarëdo vendimi operacional të këtyre dy instancave të sovranitetit shtetëror.

Apo te Agjencia Kosovare e Privatizimit, ku anëtarët ndërkombëtarë të Bordit e kanë të drejtën ekskluzive të vetos, e shumë e shumë raste të tjera.

Por, kjo nuk është e tëra. Mbikëqyrja është edhe nga jashtë, përveçse brenda nesh. Më 2 korrik, Grupi Drejtues Ndërkombëtar do të mblidhet për ta dhënë dritën e gjelbër se një gjë e tillë, pra kjo që jemi duke e bërë sot mund të ndodhë. Ky është grupi i mbikëqyrjes edhe për vetë faktin që mbikëqyrja përfundon kur ata thonë dhe si ata thonë, që nënkupton se mbikëqyrja do të vazhdojë, sepse nuk është një gjë që e kontrollojmë ne. Ky mbase edhe është aspekti më i dëmshëm dhe politikisht më përçudnuesi i një mbikëqyrjeje të tillë, arbitrariteti i interpretimit.

Na janë vendosur kushte të cilat ne nuk kemi të drejtë as t'i interpretojmë, e as ta kemi aftësinë e vlerësimit objektiv të përmbushjes së tyre. Me këtë ligj, këto instanca të ndryshme të mbikëqyrjes nuk preken, prapë po e përsëris, krejt çka ndodh është largimi i Piter Fejtit, mirëpo as ky tërësisht. Të gjitha tentakulat e tij mbeten të shtrira në institucionet e Kosovës. Kosova do të vazhdojë të ketë anëtarë ndërkombëtarë në Bordin e AKP-së, do të vazhdojë të ketë gjykatës ndërkombëtarë. Pra, do të vazhdojë të ketë ndërkombëtarë, të cilët tash, përveç se na bëhen kategori juridike në Kosovë, e fitojnë pavarësinë edhe nga vetë instanca që i emëronte ata, pra Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

E përkohshmja, pra, po na bëhet e përhershme, ndërkohë që e jashtëmja tash po na bëhet e brendshme. Gjykatësit ndërkombëtarë në shkallët përkatëse të sistemit të drejtësisë tanimë nuk janë thjesht momenti transitor i Kosovës, por zyrtarë të rregulluar me ligj vendor. Në këtë ligj apo ligje nuk dallohet më kush i emëron, kush i shkarkon, kush i monitoron etj., sa e kanë mandatin etj. Nga këto ndryshime të krijohet përshtypja se ata janë të vetvetishëm njëjtë për bordet ku edhe më herët anëtarët kanë qenë ndërkombëtarë edhe ata gjenden sipas këtij ligji në gjendjen e të vetvetishmëve.

Janë aty, pa e ditur se kujt t'i përgjigjen, kur dhe sa mbaron afati e mandati i tyre. E ngjashme është situata me citimin e Auditorit të Përgjithshëm për të cilin nuk thuhet asgjë se çka do të ndodhë me të, sepse ligji për këtë nuk është prekur, por me një sjellje injorimi juridik ligji s'e ka vënë re që edhe ky institucion duhet rishikuar. Në ligjin që po e diskutojmë, Auditori gjendet tanimë si anëtar i komisioneve tjera përzgjedhëse që kanë edhe ata vetë të tjerë anëtarë ndërkombëtarë.

Për EULEX-in, as të mos flasim. Edhe pse na ka ardhur me të njëjtin flamur të përkohshmërisë dhe edhe pse mbikëqyrja nga ai dhe pushteti ekzekutiv është po aq i dëmshëm, cenues dhe cunues, ky nuk preket. Ky i sotmi mund të shënohet si rasti i vetëm kur kategoritë kushtetuese që priten të ndryshohen, në mënyrë që t'u hapim rrugë edhe ndryshimeve që rrjedhin prej tyre, lihen në një anë dhe në vend të tyre ne shqyrtojmë një ligj prej 21 ligjesh që e ndryshon veten në kundërshtim me Kushtetutën. Por, jo vetëm kaq, kjo procedurë ndryshimi ligjesh të ndryshme nëpërmjet një ligji është tollovi e padurueshme që ia pamundëson Kuvendit një trajtim të rregullt dhe të duhur të këtyre ndryshimeve. Brenda 21 ligjeve ka ligje që mbulojnë çështje gjyqësie, ekonomie, fiskale, ndarjes së pushtetit, çështje kulturore dhe fetare etj.

Dhe, për fund, për çka po përdoret kjo përmbyllje e mbikëqyrjes? Njëri prej efekteve që shihet nga lart është tendenca për ta përjashtuar Kuvendin nga disa aspekte të vendimmarrjes për t'i përqendruar këto në duart e Qeverisë, përkatësisht kryeministrit. Kështu, përmbyllja e mbikëqyrjes po e shtron rrugën për pavarësim të mbikëqyrësit, i cili me këto ndryshime po bëhet kryeministri. Kështu, ajo që u mëtua të nisë si Republikë parlamentare po shndërrohet gradualisht, nëpërmjet mbikëqyrjes në Republikë qeveritare. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, zoti Ramadani.

BURIM RAMADANI: I nderuar kryesues!

Ne si Aleancë e shohim këtë projektligj si një hap të rëndësishëm në këtë proces të përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës dhe normalisht se ne do të votojmë pro këtij projektligji për shumë arsye edhe pos atyre edhe për një arsye tjetër se mendojmë se mos kalimi i këtij projektligji në këtë pako definitivisht mund ta sjellë Kosovën me një situatë tjetër të komplikuar dhe të panevojshme.

Prandaj, edhe thërrasim që të votohet ky projektligj. Në një moment të tillë, ne definitivisht besojmë në vazhdimin e një qasjeje të përbashkët që duhet të ketë në skenën politike dhe në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht një konsensus parimor për këtë temë

dhe për këtë proces, qoftë në formë të deklaruar, qoftë në formë të padeklaruar, me rëndësi është që qasja të jetë e përbashkët në përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës dua të shpreh bindjen tonë të fuqishme se Kosova do të vazhdojë bashkudhëtimin me partnerët ndërkombëtarë amerikanë dhe evropianë si kusht i domosdoshëm për konsolidimin e shtetit të Kosovës, për demokratizimin e shoqërisë edhe integrimet euroatlantike. Pra, ne në parim e mbështetim këtë projektligj dhe në të njëjtën kohë nëse do të ketë nevojë për elementet e caktuara do ta japim kontributin tonë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh Rezolutën e miratuar në Kuvendin e Kosovës në një kohë të mëhershme, nga shumica e grupeve parlamentare, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe njëkohësisht e përkrah mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe BE-së në përforcimin e shtetit të ri të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! SLS, Sasha Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Poštovani premijeru,

Članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Poslanička Grupa Samostalne Liberalne Stranke je upoznata sa sadržajem Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o prestanku međunarodnog nadgledanja nezavisnosti i aktivno je učestvovala u razmatranju ovog Nacrt zakona.

Kao predstavnici srpske zajednice, ovaj zakon vidimo kao veliku šansu da zaštitimo prava srpske zajednice. Da najmanje 8% srba treba da budu upošljeno u kosovskim institucijama, da zaštitimo prava Srpske Pravoslavne Crkve sa sedištem u Beogradu, da povećamo broj sudija Ustavnog Suda, da povećamo broj sudija Vrhovnog Suda, i da posle stupanja na snagu ovog zakona, tražimo njegovu potpunu implementaciju na terenu.

Dakle, SLS će podržati ovaj predlog zakona u načelu, a konkretne primedbe daćemo u redovnoj proceduri. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Për “6+”, zoti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsjedavajući,

Poštovani premijeru,

Članovi Kabineta Vlade,
Poslanici Parlamenta Republike Kosova,
Parlamentarna Grupa “6+” dala je svoj doprinos u rad ove komisije, i podržava Nacrt zakona o izmenama i dopunama zakona koji se odnose na prestanak međunarodnog nadzora nezavisnosti.

Ovaj Nacrt zakona vidimo kao prenos ovlašćenja funkcionalne institucije, i smatramo kao vrlo značajnim za dalji napredak Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit!

Fjalën e ka kërkuar nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues i seancës,

Zoti kryeministër,

Ministra,

Kolegë të nderuar,

Kjo që kemi sot të diskutojmë për amendamentime ligjesh që na lirojnë nga mbikëqyrja e pavarësisë, absolutisht duhet të konsiderohet ditë e rëndësisë së veçantë.

Dhe, nëse përmbajtja, substanca është baras me emrin, me kërkesën, kjo është një ditë, do të thosha e lumtur për Kosovën. Çështja është që ajo që deklarohet nuk e përbën substancën. Dhe, unë do t'i jap 2-3 vërejtje, 2-3 mendime, është punë e të tjerëve si i interpretojnë edhe secili i ka idetë e veta.

Së pari, me këto ligje nuk hiqet mbikëqyrja e pavarësisë, po tentohet që një pjesë e saj të modifikohet ose të bëhet më e lirshme, do ta quaja unë. Dhe, unë menjëherë, pa i përmendur hiç këto ligje, po e them atë që dihet dhe që pritet. Qysh hiqet mbikëqyrja e pavarësisë nëse ne dihet që do të marrim vendim mbas do ditësh këtu në Kuvend që t'i jepet një mandat i ri EULEX-it në Kosovë? Nuk është mirë ta bëjmë të padijshëm gjithë Kuvendin, se nëse i jepet një mandat i dytë EULEX-it, e që do t'i jepet, atëherë mbikëqyrja e pavarësisë vazhdon funksionalisht.

Po meqë ajo është punë që na vjen, e do të përballohem në këtë Kuvend me të, do të përballohet edhe Kuvendi, edhe Kryeministria, ministritë, po edhe kryetarja e Kosovës, unë po kthehem te materia që kemi sot, të cilën prapë e konsideroj edhe në këtë formë të rëndësishme. U tha këtu më duket nga deputetja Osmani, që Kryesia e ka sjellë këtë ligj në këtë formë. Jo, nuk është e vërtetë. Nuk është e vërtetë. Kryesia ka diskutuar 2-3 herë për këtë problem. Forma e ligjit është diskutuar, edhe bile është thënë që duhet të rindërtohet ndryshe, teknikisht. Unë nuk po hyj në teknikalitete, sepse po të lexohet, që tash shihet se ka probleme në lexim. Qysh tash! Mbasandaj është thënë “jo, nuk ka nevojë që të ndërrohet teknika”, që i bie të shkruhet për secilin ligj, i ndarë kërkesa që ky ligj të amendamentohet.

Në Kryesi dy herë është diskutuar gjer e gjatë për këtë punë, është e vërtetë që në mbledhjen e fundit grupet parlamentare kanë thënë në finale - le t'i jepet Kuvendit dhe është Kuvendi që vendos, siç vendos për çdo gjë. Kjo pra, puna e ndërtimit një ligj mbi

ligje do ta quaja unë, si “Kënga mbi këngët” e Biblës, që është e famshme atje, është njëfarë rezymimi i këngëve të dashurisë, këtu është rezymimi i... po e quajmë të dashurisë, për t’u bërë sovran dhe të pambikëqyrur nga të tjerët. Është pak problematik, sepse ju e shihni, ligji si tërësi, ky ligj mbi ligjet po e quaj unë, i ka 3 nene: një, dy, tre. Dyshi është materia e plotë, ku emërtohen gjithë ligjet që amendamentohen, por pikërisht ky dysh krijon probleme të mëdha se ju e shihni atë njërin prej neneve, janë edhe tjerët, po e zëmë neni që ka të bëjë me Ligjin për amendamentimin e Ligjit për të drejta fetare. Ju shihni, për shembull, faqe 18, neni 14 thotë: “Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 02 / L-31 për lirinë fetare në Kosovë”. Menjëherë ndër të është neni 7, i cili në të vërtetë është nen amendamenti, por në formën e ligjit qysh e kemi ne, ne prej nenit 14 dalim 7, mbasandaj keni edhe ligje tjera që bëhet ky tip konfuzioni në lexim në këtë formë.

Dhe, dikur dhe në këta që merren me jurisprudencë e dinë mirë, në referenca nuk është e thjeshtë nesër në referencat konkrete të thuhet një ligj që është ligji mbi ligjin, ky ligj po në të është neni 14, e në atë nenin 14 të tij, ju e keni një amendament që quhet 7. Domethënë, çfarë po dua të them, nuk ka pasur kurrfarë arsye që kjo është krejt punë teknike të bëhet secili nen këtu një ligj, ligji për amendamentimin e filan ligjit. Kjo dhe për një gjë, sepse është edhe pikëpamjet, të drejtat e deputetëve për votim. Këtu tash bëhet problem votimi edhe unë e kam thënë edhe në Kryesi, kur kemi biseduar. Qysh do të votohet? Nuk mund “an bianco” të kërkossh prej deputetëve “votomëni të gjitha përnjëherë”, se ka deputet që thotë: “me të dyja duart i votoj 18 ligje, por të 19-in s’e votoj”.

Prandaj, këtu shtrohet pyetja fundamentale: Qysh do të punojmë sot?! A do ta votojmë çdo ligj? Unë them që duhet të votohet secili veç e veç, përndryshe është problem. Dhe, unë tash po i shpreh pikëpamjet e mia për një ligj, është puna e ligjit, pikërisht për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë.

Unë e përgëzoj përfaqësuesin e SLS-së që është konkret dhe e thotë esencën, se thotë: “Kemi bashkëpunuar në hartimin e këtij ligji dhe amendamenti për ta mbrojtur”, tha ai, unë besoj që e dëgjova mirë, atë të drejtën e Kishës Ortodokse Serbe në Beograd”. Këtu kemi të bëjmë konkretisht me një nen që quhet ky 7, i cili është nen i ri. Nuk ka të bëjë me mbikëqyrjen e Kosovës, por është nen i ri rregullues që merret me hierarkinë e Kishës Ortodokse Serbe. Unë për vete mendoj që ky nen është i panevojshëm dhe nuk duhet të hyjë në këtë ligj, sepse nuk duhet në mënyrë ligjore të merremi ne me strukturimet e kishave ose strukturimet institucionale të organizimeve fetare që tri janë të mëdha në Kosovë, është feja katolike, është ortodokse dhe myslimane. Pse? Sepse, historitë e organizimeve të tyre janë krejt të ndryshme dhe nuk është mirë me ligj sistemor të preken këto. Sepse, ajo i bie që ne duhet të kodifikojmë, a e ka Kisha Ortodokse Serbe kryet në Beograd, a e ka Kisha Katolike kryet në Romë dhe hajde, po themi, a e ka besimi mysliman kryet në Mekë? Nuk është njësoj, sepse organizimet edhe doktrinarisht janë krejt të ndryshme, edhe historikisht janë krejt të ndryshme.

Dhe, ata që i njohin fetë dhe organizimet e dinë se çfarë jam duke thënë. Unë nuk do ta shpjegoj më tutje, sepse për njërën kisha është element obligativ për të komunikuar me besimin me Zotin, për tjetrën ajo xhamia s’është. Domethënë, ne po hyjmë në definime të

organizimeve fetare që janë të ndryshme dhe kanë pasoja, prandaj unë mendoj që ky nen nuk duhet të jetë hiç. S’kemi ne, me ligj që të përzihemi në organizimet e brendshme fetare dhe në funksionimet doktrinare të feve që janë të lira dhe kulturalisht dhe historikisht janë ndryshe të organizuara në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Zonja, zotërinj deputetë,

Edhe unë përshëndes sjelljen në Kuvend të kësaj pakoje të ligjeve dhe e konsideroj vërtet një kënaqësi që kemi arritur në këtë fazë.

Të flasim për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare, për ne është vërtet ngjarje e veçantë, sado që jemi të vetëdijshëm se jetojmë në kohë kur pavarësia dhe ndërvarësia nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Por, megjithatë të e përmbyllim këtë proces partneriteti me një storie suksesi për Kosovën dhe me storie suksesi për misionin ndërkombëtar paqendërtues në Kosovë, mendoj që është lajm i mirë dhe nuk mund të mos i gëzohemi. Është rast edhe për ta shprehur falënderimin dhe mirënjohjen botës demokratike e paqedashëse dhe misionit të saj për të gjitha ato që kanë bërë, megjithatë edhe unë mendoj se kjo nuk duhet bërë me eufori dhe ekzagjerime.

Përmbyllja e mbikëqyrjes ndërkombëtare për ne është e rëndësishme, por jo e tillë që duhej bërë me çdo kusht dhe me çdo çmim. Prirja nganjëherë për të kuptuar se nëse u themi njerëzve se e keni kusht dhe ju duhet të pranoni gjithçka, ndryshe s’ka përmbyllje të mbikëqyrjes, mendoj që duhet të trajtohet ndryshe, sepse ne kemi nevojë për një mbikëqyrje adekuate dhe më mirë është të kemi një mbikëqyrje adekuate se sa sherre brenda, të cilat do ta bënin të domosdoshme edhe një rikthim pastaj të misioneve ndërkombëtare në rast regjenerimi të tensioneve, animoziteteve.

Megjithatë, ky është rast edhe mbi të gjitha për mobilizim të mëtejshëm për sfida të reja dhe jo të pakta, jo të lehta që na presin. Është rast për ta dëshmuar edhe faktin se Kosova e ka, jo vetëm gatishmërinë, por edhe përgatitjen e duhur për t’u dëshmuar në praktikë me kapacitetet e nevojshme institucionale, profesionale, demokratike të funksionimit vërtet të pavarur demokratik. Dhe, ndoshta edhe ky rast është për të dëshmuar se a jemi vërtet në nivelin e përgjegjësisë për ta ndërtuar një raport të duhur me partnerët tanë ndërkombëtarë? Larg kryeneçësisë tipike ballkanike e frymës grindavece, por larg edhe servilizmit po ashtu tipik ballkanik që po ashtu ka kushtuar shumë dhe ka pasur efekte kundërprodhuese.

Na duhet një qasje e pjekur kooperativiteti e partneriteti, por edhe përkushtimi i interesave të vendit dhe qytetarëve që përfaqësojnë me përgjegjësi dhe përkushtim edhe parimet dhe vlerat demokratike qytetëruese. Mendoj që sot na duhet ajo maksima e moçme: “O Zot, më jep durim që të pranoj gjithçka që duhet pranuar, më jep forcë për të kundërshtuar gjithçka që duhet kundërshtuar dhe më jep mend që t’i dalloj këto dyja”.

Dhe, për të qenë më konkret u konstatua edhe këtu dhe është konstatuar edhe me të drejtë, edhe më përpara, edhe nga ndonjë segment i shoqërisë civile, se është problematike kjo praktika e procedimit në pako, amblllok, të një mori ligjeve. Shkakton rrëmujë ligjvënëse, relativizion procedurat e ligjvënies dhe ne e kemi parë se kështu ka ndodhur me pakon e ligjeve të Ahtisarit. Krijohet një labirint edhe gjatë zbatimit të ligjeve, edhe s'mund të orientohesh dot, edhe ata që kanë punuar me muaj kanë vështirësi të gjenden në situatën e krijuar.

Përvoja e së ashtuquajturës pako e ligjeve të Ahtisarit që është imponuar, dhe është sjellë, është miratuar afërsisht në këtë mënyrë pa e vënë në dyshim edhe vullnetin e mirë dhe zgjidhje të drejta në pjesën e madhe të tyre, do theksuar se është e shoqëruar edhe me dispozita, formula, praktika, të cilat thënë më së buti janë të diskutueshme, problematike, janë kontradiktore, janë shpesh antikushtetuese, dhe zor të zbatueshme.

Për më keq, në këtë fazë të përmbylljes së ligjvënies sonë nuk është krijuar mundësia që ne të përballemi me to dhe t'i hyjmë ndryshimit të tyre. Do të thotë, po e përmbylim këtë fazë të ligjvënies me defektet që po i lëmë brenda dhe këtë e theksoj, sepse duhet ta bëjmë në një të ardhme të afërme.

Janë disa nga këto ligje që amendamentohen edhe tash pothuajse në të njëjtën mënyrë dhe, merreni me mend, në përfundim të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe në fillim të funksionimit të pavarur pa mbikëqyrjen ndërkombëtare, në të vërtetë është krijuar një ngërç në hapësirën e Kuvendit për të bërë vetë ligjvënien në përputhje me traditat e veta dhe me përvojën që është krijuar. Në shikimin tim, janë disa grupe çështjesh që mëtohen të rregullohen me amendamentet e propozuara nga Qeveria dhe Zyra Civile Ndërkombëtare. Janë një grup amendamentesh që janë të një natyre teknike, që janë të një natyre, por edhe të një natyre teknike që lidhen me referencat dhe me kompetencat e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, që tani duhen të bartur institucioneve të Kosovës dhe si të tilla ato, edhe sipas praktikave ndërkombëtare, mund të procedohen edhe si pako. Kur është një çështje që është standarde për të gjitha ligjet, mund edhe të procedohet si pako.

Mendoj se si të tilla ato duhur përkrahur pa hedhur poshtë, pa i përjashtuar edhe vërejtjet që janë bërë. Por, është një grup tjetër amendamentesh që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme funksionale që duhet rregulluar dhe kanë të bëjnë edhe me çështje kompetencash që duan transferuar e që derivohen, qoftë nga Propozimi gjithëpërfshirës, qoftë nga procesi i përmbylljes së misionit të mbikëqyrjes ndërkombëtare. Edhe këto mund të përkrahen për mendimin tim duke i përkrahur, qoftë edhe në bllok, pavarësisht se do të ishte më mirë të shqyrtoheshin e të amendamentoheshin veç e veç.

Janë disa amendamente që synojnë të rirregullojnë me ligje joadekuate çështje nga Propozimi gjithëpërfshirës, të cilat janë marrë parasysh dhe janë rregulluar me ligjet përkatëse që i mbulojnë ato fusha dhe si të tilla mendoj se janë të panevojshme, por është një fjalë thotë: "Nuk ka gjë të keqe të përsëritet diçka që është e mirë" dhe nëse insistohet mendoj që është nga ato që edhe mund të gëlltitet.

Dhe, së fundi, zonja dhe zotërinj, më lejoni që këtu të ndalem pak më shumë, janë disa propozim-ndryshime, të cilat as nuk janë kompetenca që duhen bartur, nuk kanë qenë kompetenca të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, as nuk janë në pajtim me frymën dhe me shkronjën e Propozimit gjithëpërfshirës, janë madje në kundërshtim me të, as nuk e kanë vendin aty ku janë të vendosur dhe as nuk janë në përputhje me kërkesat e procesit të përgjithshëm të demokratizimit, paqësimit, dhe pajtimit dhe normalizimit të përgjithshëm ndëretnik e ndërfetar. Për më tepër, duke qenë të ngarkuara edhe me një dozë politizimi dhe me mundësi evidente keqkuptimi e keqpërdorimi politik, duke qenë në kundërshtim edhe me dokumentet universale dhe të cilave u referohet ky ligj, disa nga ndryshimet e propozuara po të miratohen ashtu siç janë, mund të kenë efekte kundërpordhuese dhe si të tilla të kthehen në precedentë të rrezikshëm, jo vetëm për Kosovën dhe të ardhmen e saj, por edhe më gjerë.

Thonë mënyra më e mirë e më e lehtë për të deskredituar diçka të drejtë është ta çosh atë deri në absurd dhe, për fat të keq, kjo po ndodh në këtë rast. Përvoja ka dëshmuar më se njëherë se favorizimi absurd i një komuniteti dhe raporti diskriminues i tij me komunitetet tjera, pakicë ose ndonjëherë edhe me komunitetin shumicë, edhe kur bëhet me qëllimet më të mira, nuk e ndihmon këtë komunitet, përkundrazi e dëmton dhe kthehet bumerang. Kosova ka një përvojë të gjatë... dhe nuk do të ishte mirë ta injorojmë, aq më shumë dëmton kur në rrogzin e favorizimit të një komuniteti në të vërtetë nuk favorizohet komuniteti, por favorizohen struktura shtetërore e joshtetërore jashtë Kosovës, të cilat kanë dëshmuar në të kaluarën e tyre një përkushtim dhe konsistencë obstruktive e diversive ndaj Kosovës dhe ndaj procesit të pajtimit, të paqësimit, normalizimit dhe ndërtimit të atmosferës së bashkëjetesës së vërtetë në Kosovë.

Si të tilla, këto propozime duhen rishikuar dhe korrigjuar gjithnjë në funksion të realizimit të synimit themelor të theksuar në preambulën e nismës ligjvënëse dhe në përputhje me standardet më të avancuara evropiane dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Kosova dhe gjithë hapësira përreth ka predispozitat e nevojshme për t'u dëshmuar sërish si model i mirë i tolerancës, i bashkëjetesës dhe respektit ndëretnik dhe ndërfetar. E shfrytëzoj rastin për ta kundërshtuar me forcë çfarëdo akti dhune e presioni të drejtuar kundër cilitdo komunitet dhe pjesëtarëve të tyre të prezantuar këtu kohëve të fundit edhe nga deputeti Bogdanoviq dhe të tjerë dhe dua ta theksoj me...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Skënder Hyseni e ka fjalën.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Gjithsesi, vendimi që pritet ta marrë Grupi Drejtues Ndërkombëtar, më 2 korrik, është një ngjarje e shënuar dhe mund të them historike, sepse do të jetë ditë, e cila shënon, e cila shënon përmbylljen e mbikëqyrjes të pavarësisë së Kosovës dhe ditë e cila po ashtu

shënon fillimin e një faze të re të shtetndërtimit të Kosovës, të konsolidimit të shtetësisë së Kosovës në të gjitha rrafshet dhe segmentet.

Është ditë e cila shënon përfundimisht përmbylljen vartësisë në fusha të caktuara nga mbikëqyrja ndërkombëtare dhe ditë e cila shënon fillimin e marrjes së përgjegjësisë të plota nga institucionet e Republikës së Kosovës për të zbatuar ingerencat kushtetuese në të gjitha fushat ku ekzistonte mbikëqyrja ndërkombëtare. Çka do të thotë kjo në terma praktikë dhe konkretë? Kjo do të thotë që ato fuqi të rezervuara për mbikëqyrjen ndërkombëtare përfundimisht do të kalojnë te institucionet e Kosovës dhe ky është lajm shumë i mirë për Kosovën. Është lajm, i cili në të njëjtën kohë do ta vërë në sprovë gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për t'u përballur me detyrat kushtetuese që dalin nga kjo.

Unë shpresoj shumë që kjo do të jetë dita, e cila do të shënojë fillimin e një partneriteti. Po e theksoj, të një partneriteti edhe në rrafshin dypalësh, edhe në rrafshin shumëpalësh me bashkësinë ndërkombëtare. Dhe, daljen nga kjo që rrezikonte të shndërrohej në kronikën e një farë vartësie nga segmente të caktuara ndërkombëtare.

Kosova më shumë se kur do të ketë nevojë këtu e tutje që të bashkëpunojë ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare në të gjitha rrafshet dhe në të gjitha formatet.

Natyrisht, kjo nuk e liron Kuvendin e Kosovës si organ kryesor ligjvënës dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës që të përkujdesen në fazën e mëtejshme të trajtimit të projektligjit, i cili absolutisht duhet të aprovohet, sepse është lajm i mirë dhe është moment i rëndësishëm për Kosovën, por nuk e amnistion nga përgjegjësia dhe detyra që t'i shohë me kujdes të gjitha dispozitat dhe të evitojë, nëse ka raste të tilla, nene të cilat bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet pozitive të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Unë sërish ndiej nevojë të theksoj që përmbyllja, përfundimi, përmbarimi i mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës është një moment shumë i rëndësishëm për shtetndërtimin dhe të ardhmen e Kosovës si shtet, i cili përfundimisht duhet të vazhdojë dhe duhet të fillojë, nëse në fusha të caktuara nuk është sjellë si shtet, duhet të fillojë dhe të vazhdojë të sillet si shtet. Ju falemnderit shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Falemnderit, kryesues!

Unë fillimisht do të ndalem vetëm në dy ligje të kësaj pakoje, në Ligjin për menaxhimin e financave publike edhe në Ligjin për kodin doganor dhe të akcizave.

Sa i përket Ligjit për menaxhimin e financave publike, në pikën 4.6 të ligjit ekzistues, ku parashihet që ministri të ketë paraprakisht pëlqimin e kryeministrit në rast të shkarkimit të drejtorit të Thesarit, kjo është e papranueshme, sepse tani i jep kompetenca shumë të mëdha kryeministrit në caktimin dhe shkarkimin e drejtorit të Thesarit.

Sigurisht mund ta kemi të qartë që ministri mund ta pyesë kryeministrin për caktimin e drejtorit të Thesarit, domethënë në këtë rast, dhe jo vetëm në këtë rast, mirëpo kjo nuk ishte dashur të jetë e përcaktuar në ligj për shkak se në ligj është dashur të jetë e përcaktuar që shkarkimin e drejtorit të Thesarit ta bëjë Kuvendi i Kosovës, e jo pëlqimin për këtë ta japë kryeministri, sepse për këtë është Kuvendi dhe duhet të pyetet Kuvendi. Nëse nuk pyetet Kuvendi, atëherë as nuk ka kuptim që ai të ekzistojë.

Kur jemi tek aneksi i Ligjit për kodin doganor dhe të akcizave, ky aneks parasheh lirimin nga taksa doganore, përfshirë çfarëdo takse të akcizës që përkufizohet në këtë ligj për Kishën Ortodokse Serbe dhe për bashkësitë tjera fetare që përcaktohen me këtë ligj.

Në radhë të parë, bashkësitë fetare në Kosovë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, dhe është e papranueshme që Kisha Ortodokse të quhet Serbe, dhe më tutje kjo kishë të ketë lirime nga taksa doganore, si dhe çfarëdo takse e akcizës që përkufizohet me këtë ligj.

Ndërkohë që në nenin 1 të këtij aneksi thuhet që bashkësive fetare do t'u jepen përjashtime të posaçme, pa e përcaktuar se për çfarë përjashtimesh bëhet fjalë. Pra, bëhet një ndarje ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe, siç po quhet, dhe bashkësive tjera fetare, duke e veçuar këtë kishë nga bashkësitë tjera fetare, duke i dhënë kompetenca dhe trajtim të veçantë, gjë që është e papranueshme, pra është e papranueshme që Kisha Ortodokse, e cila në këtë rast po quhet Serbe, të ketë kompetenca dhe trajtim të veçantë dhe të jetë e veçantë, e të veçohet nga bashkësitë tjera fetare në Kosovë. Pra, kjo është e papranueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka zoti Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Më lejoni që edhe unë ta mbështes nxjerrjen e këtyre ligjeve dhe të tërheq vërejtjen lidhur me, pos atyre që u theksuan, propozimet për ndryshimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Sa di unë, Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit, anëtarët e Bordit të kësaj agjencie i emëron Kuvendi me propozim të Qeverisë, apo të kryeministrit, dhe tash mbeten tre ndërkombëtarë anëtarë të Bordit. Nuk di sa është kjo në frymën e këtij ligji, por nëse i kontribuojnë ekspertizës edhe për një kohë mund të jenë aty, por sinqerisht mendoj që nuk ka nevojë të theksohet, ne mund të emërojmë edhe anëtarë që janë ndërkombëtarë, po jo me çdo kusht të kemi ndërkombëtarë, edhe anëtarë ndërkombëtarë, edhe të Kosovës.

E dyta është asimetria në zgjedhjen e këtyre. Në qoftë se Kuvendi i zgjedh anëtarët tjerë, atëherë duhet t'i zgjedhë edhe anëtarët ndërkombëtarë. Pra, kryeministri e Qeveria mund t'i propozojnë Kuvendit, por Kuvendi duhet t'i zgjedhë ata, e jo kryeministri, sipas logjikës.

Nën dy, zgjedhja e drejtorit të kësaj agjencie, që është shumë e rëndësishme, po ashtu do të duhej të bëhej ose nga Bordi i kësaj agjencie, të cilin e ka emëruar Kuvendi, se Kuvendi mund t'ia delegojë Bordit ta zgjedhë drejtorin ekzekutiv apo drejtorin e

përgjithshëm të agjencisë, e jo të emërohet nga kryeministri. Pra, ose të zgjidhet nga Kuvendi, ose nga Bordi, të cilin e ka zgjedhur Kuvendi.

Përndryshe, i përkrah propozimet, sidomos ato që i dha profesor Hamiti dhe zoti Hyseni, që ishin shumë domethënëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Nacrtom zakona o prestanku nadgledanjem nezavisnosti adamendovaće se određenih članovi zakona, imati za cilj poboljšanje, da se zakoni poboljšaju.

Ja bih samo hteo da se osnovni član 14, strana 18, amandman koji se menja u stavu 1. i tačka 1. i glasi “Srpska pravoslavna crkva na Kosovu smatra delom srpske pravoslavne crkve sa sedištem u Beogradu”. Hteo bih samo da obrazložim ovaj amandman. Vidim da je nekim našim kolegama to neprihvatljivo, ovo je odredba preuzeti izdela sve obuhvatnog plana za rešenje statusa Kosova, aneksa 5. član 1. tačka 2. Potrebno je da bi se sprečila eventualna zloupotrebe imena srpske pravoslavne crkve, ili registracije druge verske zajednice po tim nazivom.

Moram da napomenem da je takvih primera bilo u regionu, i upravo taj član treba da zaštiti ime srpske pravoslavne crkve. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Falemnderit, zoti kryesues!

Në fakt, kemi ardhur në një situatë që është mirë t'i themi gjërat ashtu siç janë, e jo nganjëherë me vetëdije ose pa vetëdije të kthehemi në një lojë apo në një aktor që simulon gjoja heqjen e mbikëqyrjes së pavarësisë të këtij vendi.

Unë mendoj që me planin e Ahtisarit, me EULEX-in dhe në mesin e tyre edhe me një varësi informale ndaj ambasadorëve, as që bëhet fjalë për heqje të mbikëqyrjes së pavarësisë dhe ne me këtë projektligj tashmë ose jemi kthyer, ose dikush tenton të na kthejë në simulues dhe lojtar të një loje, në të cilën nuk do të doja të isha i radhitur.

Pra, kjo nuk është heqje e mbikëqyrjes së pavarësisë. Normalisht që ne e mbështetim pavarësinë, pa kësaj lloj mbikëqyrjeje, pavarësinë e vërtetë dhe pavarësinë pa këtë varësi të tejskajshme, të pakufishme që kanë sot sidomos institucionet tona që udhëheqin, por opinionit nuk do të duhej që në këto momente jo pak të rëndësishme t'i shitej kalimi i këtij projektligji, respektivisht ligji se ne e tejkaluam fazën e mbikëqyrjes së pavarësisë, dhe ashtu, siç po thuhet këtu, ne po e përfundojmë mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës. Përkundrazi, unë mendoj që mbikëqyrja e pavarësisë veç sa po ligjërohet, apo mbikëqyrja në një farë forme edhe po përjetësohet.

Ndoshta, pa dashur të paragjykoj, por në bazë të përvojës që kemi, në qasjen që ka Qeveria në këto momente, ndoshta edhe mund të thotë që kush nuk e voton këtë ligj është

kundër heqjes së mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, por kjo normalisht nuk do të duhej të ishte e pranueshme, për shkak se ne jemi vërtet për pavarësinë e këtij vendi, por jo për një pavarësi, ose jo për një lojë, e cila më tepër mbetet në kufijtë e deklarimeve formale apo në kufijtë e formalitetit, e jo të asaj që është efikase.

Më lejoni, sikur edhe shumë kolegë tjerë, të përqendrohemi vetëm në njërin nga nenet e këtij projektligji, në nenin 21, që ka të bëjë me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në këtë nen parashihet, në vend që Forca e Sigurisë së Kosovës ta avancojë të drejtën e ushtrisë, si heqje e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, numërohet më tepër ndalesa që ka FSK-ja, se sa që e avancoi FSK-në drejt ushtrisë së Kosovës.

Pra, më lejoni ta parafrazoj vetëm një paragraf, në të cilin thuhet se, “Forca e Sigurisë së Kosovës është armatosur lehtë dhe, po e theksoj, nuk do të ketë armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë apo kapacitetet sulmuese ajrore”. Pra, akoma vazhdon që në Ligjin për FSK-në të mbetet diçka që i ndalohej më e rëndësishme sesa ajo që i lejohet.

Një nga kolegët e mi këtu tha se nuk ka gjë të keqe nëse përsëritet diçka e mirë, e unë pajtohem, por gjithsesi do të thosha që nuk ka diçka të mirë në këtë mes nëse vazhdon të përsëritet diçka e keqe. E unë mendoj që kjo më tepër është një simulim i heqjes së mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, sesa vërtet një tejkalim i kësaj faze, e cila i ka sjellë shumë hendikep vërtet zhvillimit të shoqërisë, siç është kjo pavarësi me EULEX-in, me Ahtisarin dhe me varësinë e tejskajshme të institucioneve tona, sidomos të Qeverisë ndaj ambasadorëve. Kështu që nuk do të doja të jem pjesë e kësaj loje dhe kjo lojë t’u shitet qytetarëve si tejkalim i fazës së mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Në pakon e këtyre ligjeve për përfundimin e kësaj mbikëqyrjeje ndërkombëtare të kësaj pavarësie, njëra ndër pjesët më të mbrapshta të saj është pa dyshim neni 14, që e ndryshon Ligjin për liritë fetare dhe flet për statusin e Kishës Ortodokse.

Neni 14 së pari është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me nenin 8, në të cilin thuhet se Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare. Kjo do të thotë se Republika e Kosovës në ligjet e saj nuk merret me rregullimet e brendshme dhe funksionimin e bashkësive fetare. Se a janë ndërtesat fetare për kryerjen e ceremonive fetare, se a duhet gjithsesi Kisha Ortodokse në Kosovë të jetë pjesë e Kishës Ortodokse Serbe, kjo nuk ka të bëjë me neutralitetin, por me politizimin e institucionit fetar.

Paragrafi 1 i këtij neni thotë: “Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë konsiderohet pjesë e Kishës Ortodokse Serbe”, pra edhe po të dojë të pavarësohet Kisha Ortodokse në Kosovë nga ajo në Serbi, ligji ia ndalon këtë. Ky është ndikim politik dhe cenim i së drejtës që një subjekt të mund të pavarësohet.

Tjetra thotë: “Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë është kuptimi tjetër i së njëjtës fjali, konsiderohet pra pjesë e Kishës Ortodokse Serbe”, dhe është paragjykim që ndoshta serbët e Kosovës, edhe po të duan të ndahen nga ata të Serbisë në kishë, ky ligj pra ua ndalon.

Dhe tjetra, më e rëndësishmja, është se kisha trajtohet dhe natyrisht edhe ajo e trajton veten si instrument nacionalist. Pra, në Kosovë, nëse dikush do të konvertohet në ortodoks, i bie të heqë dorë nga identiteti i tij kombëtar, sidomos kur e dimë që në origjinë popullata shqiptare e Kosovës ishte e krishtere katolike dhe ortodokse, e cila u konvertua pastaj në besimin islam.

Normalisht, me sa e di unë, feja synon t’i edukojë njerëzit dhe ata që i shërbejnë synojnë ta përhapin besimin dhe edukimin fetar. Ndërsa këtu te ne kjo bëhet në funksion të një nacionalizmi, e këtë po e ndihmon edhe ligji, pra ky ligj.

Pika 2 e këtij neni e ndalon hyrjen e autoriteteve qeveritare në objektet fetare pa pëlqimin e institucionit përkatës, përveç kur ka urdhër gjyqësor për shkak të ndonjë aktiviteti legal. Pra, në këto objekte, nëse institucioni përkatës shkencor do ta bëjë ndonjë hulumtim shkencor, historik apo arkeologjik, apo lidhur me trashëgiminë, ai nuk do të mund ta bëjë këtë nëse ia ndalon institucioni fetar.

Meqë së pari institucioni fetar po shndërrohet me ligj në instrument të nacionalizmit, është shumë e thjeshtë se edhe veprimtaria hulumtuese shkencore, edhe e vërteta historike u nënshtrohen nacionalizmit. Pra, kjo është pikë e dytë e rëndë e këtij neni.

Pra, së pari e vulos institucionin fetar si nacionalist, ia nënshton kësaj vulosjeje edhe historinë mesjetare dhe në fund e konservon me ligj një gjë të tillë.

E dini shumë mirë, të gjithë e dimë, që pikëmbështetja e vetme e Serbisë për ta pushtuar dhe për ta mbajtur Kosovën të pushtuar gjatë një shekulli ka qenë arsyeimi, të themi i ashtuquajtur historik. Pra, në emër të historisë, i tërë një popull është dhunuar gjatë një shekulli dhe atë, të mos harrojmë, në emër të historisë, e cila është bazuar çdo herë në mite, e jo në trajtimin e drejtë shkencor, pra e motivuar nga ambiciet territoriale dhe shoviniste të Serbisë.

Tani ne na takon e drejta që ta shikojmë drejt këtë histori. Ta lirojmë atë nga nacionalizmi e shovinizmi dhe ta trajtojmë shumë thjesht e lehtë në mënyrë shkencore.

Çështje tjetër, të nderuar deputetë, është pika 3 e nenit 7, apo të themi pika 1 e nenit 14, që me të drejtë nënkryetari Sabri Hamiti e la si mjaft të komplikuar. Pra, sipas kësaj pike, thuhet se nuk do të ketë ndalim arbitrar për hyrjen në Kosovë dhe për qëndrim brenda Kosovës të priftërinjve të tjerë dhe të pelegrinëve.

Kur me ligj e bën kishën si instrument nacionalist, pra si instrument të nacionalizmit, edhe pelegrinazhi shumë thjesht do të bëhet me aso motive. Pelegrinazhi lidhet me

besimin fetar dhe dikush që bën pelegrinazh e arsyeton atë se po e bën për avancimin shpirtëror dhe lidhet me besimin në Zot dhe në forcimin e këtij besimi. Kjo s'ka lidhje me racionalizmin, sepse kombet janë krijuar shumë më vonë se sa besimi në një Zot. Dhe, me këtë logjikë përfundon edhe ky pelegrinazh pastaj në fushata nacionaliste politike dhe kërcënuese për qytetarët e Kosovës. Kur në emër të pelegrinazhit vjen dikush dhe i thotë vetes gardë e Car Lazarit dhe kërcënon se do të kthehet në Kosovë sërish dhe ne e dimë shumë mirë se ata ishin njëherë në Kosovë dhe pas vetes lanë fëmijë të masakruar e gra të dhunuara, këtë gjë nuk mund ta shohim si diçka të Zotit, apo si diçka që mund të konsiderohet si pelegrinazh fetar. Pra, ky nen e vulos Kishën Ortodokse si instrument në dorë të nacionalizmit dhe shovinizmit serb, e vulos edhe historinë si serbe, e pastaj e konservon atë si të tillë me ligj dhe e mbron dhe, në fund, tërë kësaj ia mundëson edhe ekspeditat e nxitjes së urrejtjes në emër të pelegrinazhit fetar.

Ne si Grup i Lëvizjes “Vetëvendosje” natyrisht se do të jemi kundër, sepse kjo është parimore. Me këso ligjesh, pavarësia nuk bëhet e qytetarëve, por e konjunkturave që qytetarin e shohin si instrument.

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Falemnderit kryesues dhe të nderuar deputetë, Është mirë që më në fund po bisedojmë për idenë e përfundimit të një rendi dhe procesi politik e juridik, i cili edhe ashtu në vetvete, si i tillë, ishte jodemokratik, por e vërteta është se përfundimi i këtij procesi, në bazë të dispozitave të tanishme ligjore, ka rrezik që po ashtu të jetë vazhdimësi e kësaj logjike jodemokratike.

Fillimisht, është e ditur se një shoqëri normale demokratike thuhet tërë normativitetin e saj juridik e shter ekskluzivisht nga vetvetja. Ndërkaq, misioni i Zyrës Civile Ndërkombëtare, me kompetencat dhe mandatin që ishte atribuuar si një fuqi mbi sovranë, mbi vendosëse dhe kontrolluese, është e ditur se ishte konsoliduar pikërisht në antinomi me këtë postulat bazik. Rrjedhimisht, edhe abrogimi i kësaj strukture impotente institucionale është dashur të kuptohej edhe si rritje e kapaciteteve sovranë dhe vendimmarrëse të shtetit të Kosovës, por formalisht me këto ndryshime që po serviren, edhe pse duket se do të mbyllet Zyra Qendrore e ICO-s, realisht përfaqësuesit e saj, të emëruar nga kjo zyrë, do të vazhdojnë ta kenë një rol qenësor në segmentet kryesore vitale të jetës ekonomike, politike dhe juridike.

Për më tepër, tash ata do të shndërrohen në një kategori të re ligjore, apo do të shndërrohen në pjesë të brendshme të kësaj jete dhe pa një datë të qartë të përfundimit të mandatit të tyre.

Kështu, po të analizohen me vëmendje të gjitha dispozitat përmbajtjesore të projektligjit për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, ato e ofrojnë një ambivalencë të çuditshme, duke ofruar vazhdimësi në fuqinë mbivendosëse të përfaqësuesve ndërkombëtarë, qoftë në Gjykatën Kushtetuese, në Agjencinë Ndërkombëtare të Privatizimit, te Auditori Gjeneral, në Këshillin Gjyqësor e tjera. Dhe, ky proces e arrin kulmin sidomos me propozimet e fundit që kanë ardhur në komision

lidhur me imunitetet dhe privilegjet e misionëve diplomatike, ku decidivisht thuhet se ministri i Punëve të Jashtme nuk mund ta shpallë PSBE-në ose një anëtar të personelit të tij, anëtarët e personelit të ICO-s, përfshirë individët e përcaktuar në nenin 3.3 të këtij ligji, ose anëtarët e misionit të EULEX-it si persona non grata. Atëherë shtrohet pyetja: Po në qoftë se ndonjëri nga përfaqësuesit e këtyre mekanizmave ndërkombëtarë konstatohet se gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij është duke operuar në kundërshtim me interesat vitale të shtetit të Kosovës, çfarë duhet të bëjë Ministria e Punëve të Jashtme sipas kësaj dispozite? Atëherë, ajo vetëm duhet ta përshëndesë një akt të tillë, sepse suma summarum nuk ka fuqi ligjore për të intervenuar. Pra, shihet se me këto formulime, ekziston tendenca e çimentimit të këtij pushteti edhe në këto konjunktura të reja që po krijohen.

Kështu, seria e paradokseve që ofron ky projektligj është e gjatë, por si më e dalluara veçohet ajo në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi lirinë fetare për të cilin u fol. Këto ndryshime mund të jenë gjithçka tjetër, po që janë ndryshime që derivojnë nga logjika e parimit të lajcitetit.

Ndërkaq, pa hyrë në zhvillimet e mëtutjeshme, problem konsiderohet edhe Ligji mbi shtetësinë, i cili edhe me këto ndryshime e ruan trashëgiminë e UNMIK-ut në substancën e tij, duke i konsideruar shtetas të Kosovës vetëm ata që kanë qenë të pranishëm në territorin e Kosovës më 1998. Me këtë formulim, realisht privohen nga mundësia e fitimit të shtetësisë një pjesë e madhe e qytetarëve shqiptarë të Kosovës, të cilët, siç dihet, atëbotë ishin detyruar të largohen nga Kosova për shkak të dhunës totale e institucionale, që dominonte nga regjimi serb.

Gjykuar mbi këto premisa dhe me këto zgjidhje paradoksale që ofron ky projektligj, pa dyshim se ne jemi kundër kësaj shpërndarjeje dhe pranisë në çdo qelisë shoqërore dhe institucionale të kësaj trashëgimie politike dhe sistemeve ndërkombëtare, ashtu siç jemi kundër dhe e kundërshtojmë fuqishëm praninë, misionin dhe mandatin që ka EULEX-i dhe që mund të ketë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Sot në këtë seancë jemi duke e shqyrtuar një projektligj me të cilin ndryshohen 21 ligje, shumë pak nene të tyre, me të cilat thuhet se po përfundon mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës, por që realisht po rirregullohet prania ndërkombëtare nëpër institucionet e Kosovës.

Në këtë projektligj shihet qartë se përmbyllja e mbikëqyrjes nuk do të jetë realisht e tillë dhe do të nënkuptojë vetëm mbylljen e Zyrës së PCN-së në Kosovë. Saktësisht, siç ka thënë Lëvizja “Vetëvendosje”, kur e kemi refuzuar rezolutën e kaluar në Kuvend për përmbylljen e kësaj mbikëqyrjeje.

Të nderuar deputetë,

Kuvendi duhet ta trajtojë secilin ligj me procedurën e vet normale të votimit në Kuvend dhe në komisionet përkatëse. Nuk ka procedurë tjetër të votimit, që është e pranueshme për ne, dhe Kuvendi e asnjë dokument në Republikën e Kosovës nuk e njeh asnjë mekanizëm të para-votimit, apo të procedurës së përshpejtuar të miratimit të ligjeve, siç po ndodh tani me pakon e 21 ligjeve.

Ne do të duhej të ballafaqoheshim me një proces të përgjegjshëm, transparent e të analizuar mirë në secilin detaj, në mënyrë që ky proces të ketë sa më pak kosto apo obligime, e sa më shumë përfitime, pra liri e të drejta për qytetarët e Kosovës dhe për institucionet e saj.

Kjo procedurë e miratimit të ligjeve kështu është një precedent shumë i rrezikshëm. A mund të më tregoni, të nderuar deputetë, se pas procedimit të kësaj pakoje ligjore, kush do të mund t'i ndalte në të ardhmen deputetët e pozitës dhe Qeverinë që ta formonin një komision ad hoc për shitjen e gjysmës së vendit, duke i proceduar 40 ligje në një të vetëm. Kështu po ndodh me këtë pako ligjore. Pra, nuk do të mund t'i ndalte askush nëse ne sot nuk do t'i ndalim deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Procedura e miratimit të këtij ligji në këtë mënyrë fillimisht është shkelje e Kushtetutës, konkretisht e nenit 16, paragrafi 1, i cili tregon për epërsinë e Kushtetutës. Është neni 16 i Kushtetutës, të cilin e keni votuar vetë, është shkelje e këtij neni të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sepse, Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, prandaj ligjet dhe aktet tjera kushtetuese duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën. Në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshohen me ligje nenet, të cilat janë pjesë të Kushtetutës. Pra, ajo çfarë po ndodh, realisht është se po ndryshohen ligjet për të ndryshuar Kushtetuta. Pra, në vend që të procedohen në Kuvend amendamentet e procedura nga Qeveria, neve na procedohet në Kuvend një pako me 21 ligje.

Pas shkeljes së nenit 16 të Kushtetutës po shkelet edhe Rregullorja e Kuvendit, nenet 53, 54, 56 dhe 57, në të cilat shpjegohet shumë qartë procedura ligjvënese nëpër komisionet përkatëse funksionale.

Në nenin 1 të këtij projektligji flitet për qëllimin e projektligjit. A mund të na tregoni, ju përfaqësues të Qeverisë, se sipas cilës praktikë legislative është riformuluar qëllimi i këtij ligji? Ku e keni marrë këtë praktikë?

Në nenin 2 të këtij ligji flitet për Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Neni 2, paragrafi 1, thotë: “Në nenin 15 të shtohet një paragraf 15.2, në të cilin përcaktohet: gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdojnë ta marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre. Qeveria e Kosovës siguron fonde për gjykatësit ndërkombëtarë me vlerë të barabartë me

pagën e gjykatësve vendorë”. Por, shtrohet pyetja: Pse vazhdon të ketë gjykatës ndërkombëtarë, pasi po përfundon pavarësia e mbikëqyrur?

Paragrafi 2 i nenit 2 thotë: “Mandati i gjykatësve ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën, do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim”. E, nëse thuhet se do të duhej të përfundojë pavarësia e mbikëqyrur, pse duhet të ekzistojnë nenet e tilla. Edhe kjo është në kundërshtim me nenin 152 të Kushtetutës, të cilin gjithashtu e kam shtypur për të jua treguar se ju po e shkelni këtë Kushtetutë, të cilën vetë e keni votuar.

Pra, edhe paragrafi 1, edhe paragrafi 2 i nenit 2 janë në kundërshtim me qëllimin e ligjit për ta përmbyllur mbikëqyrjen e pavarësisë.

Për më tepër, ky paragraf nuk shpjegon se kush i emëron këta gjykatës ndërkombëtarë pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë.

Neni 3, paragrafi 1, thotë: “Neni 8 i ligjit fshihet dhe riformulohet si vijon: Auditori i Përgjithshëm, i emëruar në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj vazhdon të qëndrojë në post deri në përfundimin e mandatit dhe me kompensimin e cekur në kushtet specifike të emërimit të tij. Qeveria e Kosovës siguron fonde në vlerë të barabartë me pagën e një qytetari të Kosovës që e mban pozitën e njëjtë”. Mirëpo, ne mendojmë që me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të duhej të përfundonte edhe mandati i tij, pra edhe ky nen është në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji.

Neni 4, paragrafi 2, thotë: “Neni 12.3 i ligjit fshihet dhe riformulohet si vijon: Kryeministri emëron 3 ndërkombëtarë anëtarë Bordit”. Fillimisht, ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e që është neni 142, pra agjencitë e pavarura. Nëse AKP-ja është agjenci e pavarur, atëherë pse kryeministri, e jo Kuvendi. Edhe ky nen është në kundërshtim me qëllimin e ligjit, pasi po vazhdon mandati i tre ndërkombëtarëve në Bord, e gjithashtu me çfarë baze kushtetuese jepet kompetenca që kryeministri ta emërojë drejtorin e tij.

Në paragrafin 2 të nenit 6 thuhet: “Gjykatës ndërkombëtar do të thotë çdo gjykatës i misionit evropian për politika të sigurisë dhe mbrojtjes, i cili është emëruar në pajtim me këtë ligj”. Cili na qenka ky mision evropian për politika të sigurisë, të cilin nuk e njeh Kushtetuta e Republikës së Kosovës? Pra, nuk është kategori kushtetuese. Çfarë bën ky gjykatës ndërkombëtar, pjesë e kujt është? Nëse fillimisht është hequr përkufizimi i propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, atëherë bie edhe termi gjykatës ndërkombëtarë, apo jo?

Neni 7, paragrafi 1, thotë: “Neni 12 i ligjit (i cili ndryshon nenin 5.6), të rregullohet, fshihet dhe riformulohet si vijon”. Fillimisht pyetja është se 5.6 i cilës rregullore, se nuk po tregohet i cilës rregullore. Më pastaj, komplet neni është i riformuluar gabimisht. Edhe përderisa po thuhet se përfundon mbikëqyrja e pavarësisë, çfarë kërkon në këtë komision Auditori i Përgjithshëm Ndërkombëtar? Ai e përfundon mandatin në momentin e përmbylljes së pavarësisë, prandaj nuk duhet të jetë.

Më pastaj, në paragrafin 6 të nenit 12 thuhet: “Nenit 17 i shtohet një paragraf i ri 17.5 si vijon: Këshilli Gjyqësor i Kosovës do ta hartojë një rregullore të ndarë për ta përshkruar procesin e emërimit dhe riemërimit të gjykatësve nga komunitetet kosovare që tash për tash janë të nënpërfaqësuar në mesin e gjykatësve që shërbejnë në Kosovë”. Kush na qenka ky komunitet kosovarë i nënpërfaqësuar? Çfarë do të thotë kjo fjali, komunitet kosovar i nënpërfaqësuar? Kategori e cilit ligj është ky term? I njëjti term përdoret edhe te Këshilli Prokurorial. Andaj, ju lutem, na jepni përgjigje se për çka e keni pasur fjalën. A jemi ne të nënpërfaqësuar?

Paragrafi 2 i nenit 15 thotë: “Paragrafi 3 i nenit 3 të ligjit fshihet dhe riformulohet si vijon: Objekt i shpronësimit sipas këtij ligji mund të jenë të drejtat private, pronësore dhe të drejtat tjera private për ose ndaj një prone të paluajtshme, me përjashtim të asaj prone të paluajtshme që bën pjesë në atë kategori të pronës, për të cilën Kushtetuta në mënyrë specifike thotë se nuk do të jetë objekt i shpronësimit”. Ky nen ngre shumë pyetje. Po pronat e xhamisë, a do të jenë të shpronësueshme? Po pronat e Kishës Katolike, po të Sinagogës? Lejohet shpronësimi i tyre? Po të Kishës Protestante, të Teqesë së Bektashinjve, pasi sipas këtij neni po lejohet shpronësimi i të tjerave. Pra, edhe ky nen, përveç tjerash, është në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji.

Andaj, me këtë procedim, me këtë mashtrim që po u bëhet qytetarëve të Republikës së Kosovës, është dashur që të paktën deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që vijnë nga opozita të mos e votojnë këtë pako ligjore si të tillë. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Falemnderit, kryesues!

Unë dua ta trajtoj Ligjin për të drejtat e komuniteteve, meqë në nenin 16, paragrafi 1, thuhet: “Pas nenit 3, të shtohet një nen i ri”. Nëse pas nenit 3 shtohet edhe një nen i ri, është dashur të lëvizet neni 4. Kjo nënkupton mediokritetin e juristëve sa i përket teknikës legislative.

Tani në Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre do të ketë dy nene 4, pra do të jetë neni 4 dhe neni 4.

Gjithashtu, edhe me këtë nen, me këtë përmbajtje, kemi problem, pasi neni 4.1 thotë: “Të gjithë refugjatët nga Kosova dhe personat e zhvendosur brenda vendit do ta kenë të drejtën e kthimit dhe kërimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të marrë vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet”. Sa për kuriozitet, çfarë keni dashur të thoni me këtë? Çfarë është menduar me refugjatët e Kosovës në këtë rast?

Gjithashtu, pse duhet të jetë i shkruar ky nen kështu, përderisa shteti e ka për detyrë ta kthejë pronën. Prona është e patjetërsueshme dhe kjo është në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji.

Më pastaj është pika 4.2 e po këtij neni. Kosova do të ndërmarrë t'i gjitha masat e nevojshme për të mundësuar dhe krijuar një atmosferë të favorshme për kthimin e sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe bazuar në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi. Kjo i ngjan një teksti të Kuvendit, vendimit të Qeverisë, ose një fjalimit të kryeministrit, e nuk ka lidhje me qëllimin e këtij ligji dhe për më tepër në të as nuk ka gjuhë të qartë juridike, as nuk garanton diçka ligjërisht dhe as nuk vendos aksione, as palë përgjegjëse.

Neni 4.3. thotë: “Kosova do të bashkëpunojë plotësisht me komisarin e lartë për të drejtat e refugjatëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili do t'i ndihmojë autoritetet kompetente në ofrimin e mbrojtjes dhe të ndihmës për të kthyerit dhe i cili, ndërmjet tjerash, do të kryejë vlerësime periodike dhe do të ofrojë raporte publike mbi kushtet e kthimit dhe gjendjen e personave të zhvendosur brenda Kosovës, si dhe gjithashtu do të ofrojë bashkëpunim me organizata të tjera, të përfshira në procesin e kthimit”. Thuhet Kosova, ama cili institucion? Është Kuvendi, Qeveria, gjykatat, pushteti vendor, komisioni i Kuvendit, apo kush, në këtë rast?

Përveç kësaj, nëse vërtet po përmbillet mbikëqyrja e pavarësisë, kjo nuk do të thotë se e kemi për detyrë ta rregullojmë me ligj bashkëpunimin me komisarin e lartë për të drejtat e refugjatëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuar, siç është cekur në nenin 4.3 dhe konsiderojmë se kjo duhet të ndërrohet me termin “mund”, e jo të “obligohet”, pra me vullnetin e lirë.

Gjithashtu, nuk mund që në një ligj të Kosovës të vendosim afat dhe mënyrë se si raporton komisari për të drejtat e refugjatëve.

OKB-ja është organizatë ndërkombëtare. Asnjë ligj vendor a lokal nuk mund t'i përcaktojë detyrat apo veprimtarinë e komisarit për të drejtat e refugjatëve, sepse të drejtës ndërkombëtare që prodhohet nga OKB-ja minimalisht i nënshtrohen të gjitha shtetet që janë në të dhe që pretendojnë të jenë. Gjithashtu, edhe ky mund të jetë një tekst i Kuvendit, gjithçka tjetër, përveç se një nen i një ligji.

Ligjet bëhen për ta normuar jetën shoqërore brenda një vendi, e jo jetën shoqërore të OKB-së.

KRYESUESI: Falemnderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti Arsim, meqenëse është kryetar i Komisionit për Kushtetutë, në qoftë se ka sqarime shtesë.

ARSIM BAJRAMI: Atëherë falemnderit zoti nënkryetar për korrektësi, Në fakt, Komisioni Kushtetues është Komision Funkcional në këtë rast në bazë të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës dhe ka të drejtë në bazë të Rregullores për diskutim me rastin e përmbylljes.

Dëshiroj që të ndalem në tri momente më tepër sqaruese, sepse atë që kam pasur ta them e kam thanë në fjalën hyrëse.

Momenti i parë është që të përkujtoj se ne jemi në leximin e parë dhe në leximin e parë Parlamenti i diskuton projektligjet ashtu siç vijnë nga Qeveria. Dhe i lus të gjithë deputetë që patën vërejtje apo që do të kenë vërejtje që t'i procedojnë me shkrim në formë të amendamenteve Komisionit ad hoc, që t'i marrë në shqyrtim.

Në këtë debat, Komisioni Kushtetues është i gatshëm ta procedojë ashtu siç vendos Kuvendi i Kosovës këtë ligj, ose si ligj në pako, ose si ligje të veçanta, dhe ne do t'i bindemi çfarëdo vendimi të Kuvendit të Kosovës.

Çështja e dytë ka të bëjë me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Kolegia Osmani me të drejtë theksoi se ky ligj duhet të largohet nga skema, sepse kohë më parë ne e kemi miratuar Projektligjin për menaxhimin e financave dhe tani kjo pjesë e ligjit bëhet krejtësisht pa objekt.

Dhe çështja e tretë, vetëm të ju informoj, shumica nga vërejtjet, sidomos vërejtjet terminologjike dhe vërejtjet e shkrimit ligjor, që u theksuan nga deputetët, tanimë janë amendamentuar nga Komisioni, prandaj ne nuk mund t'i prezantojmë në këtë fazë këto amendamente dhe raportin final, edhe me amendamente, që do të vijë nga deputetët, që sot patën vërejtje, sidomos të Ligji për liritë fetare, ne e mirëpresim dhe do ta prezantojmë në raportin tonë final. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti zëvendëskryeministër Kuçi, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Falemnderit, zoti nënkryetar, Falemnderit të nderuar deputetë për debatin që e bëtë dhe natyrisht që Qeveria e Republikës së Kosovës ka ardhur në këtë propozim pas një procesi, do të thosha që fillimisht është menduar të jetë për tre vjet, dhe besoj se kanë kaluar aq vite. Të gjithë ne që në kohën e miratimit të pakos të presidentit Ahtisari kemi menduar që do ta ketë vazhdimin e vet, frymën e vet, mbikëqyrjen për tre vjet. Por, megjithatë ne kemi ardhur në këtë moment që unë do ta quaja një pjesë të përfundimit të procesit që e kemi arritur bashkërisht, do të thosha të gjithë, edhe si politikë e Kosovës, por edhe me mirëkuptimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët shpeshherë i kanë pranuar vendimet tona, që ne i kemi propozuar, që i kemi marrë, që nuk kanë qenë shumë populiste, por kanë qenë në funksion të një procesi, që ne e kemi pasur në shtetformim.

Natyrisht, unë vëreja dy lloj vërejtjesh, e besoj se të parat kanë të bëjnë, do të thosha, me hapërim përtej asaj që ne e kemi propozuar. Dhe, Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme se ne kemi ardhur deri në një proces dhe ky proces që sot po e propozojmë, që do të miratohet deri në shtator, është përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës në kuptimin juridik formal, por jo në kuptimin e pranisë së misionëve ndërkombëtare.

Ne jemi duke punuar për një trajtim ndryshe, në një format tjetër, edhe legal do të thosha, edhe të pranisë së EULEX-it në Kosovë, që lidhet edhe me këtë çështje dhe natyrisht edhe me praninë e NATO-s, të cilat do të jenë më ndryshe prej kësaj.

Dhe, u panë vërejtjet tjera, në veçanti të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që ndoshta kanë të bëjnë me një veprim të përnjëhershëm, nëse më lejohet ta them kështu.

Mendoj që në frymën e pakos së Ahtisarit, në frymën e Kushtetutës sonë ka qenë: Misioni civil ndërkombëtar do të përfundojë në bashkëpunim edhe të misionit ndërkombëtar, edhe të atij ndërkombëtar. Dhe, ne kemi arritur këtu në bashkëpunim. Me siguri, kërkesa jonë është më e madhe, me siguri ka pasur shtete që kanë kërkuar të jemi edhe më të ngadalshëm, por mendoj që kjo është një arritur e mirë për vendin.

Pak si në shaka do të them për zonjën Haxhiu, që ka filluar sot ta përmendë Kushtetutën. Është mirë nëse Lëvizja “Vetëvendosje” fillon ta respektojë Kushtetutën e Kosovës, edhe ligjin, edhe flamujt, edhe të gjitha. Por, ajo çka dua të them unë, jo ky Kuvend, por as Qeveria, as dikush tjetër nuk ka të drejtë dhe nuk do ta bëjë asnjë veprim kundër Kushtetutës së Kosovës. Përkundrazi, vendimet tona do të jenë brenda Kushtetutës. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit!

Në vazhdim kërkoj që të përgatitemi lidhur me deklarinimin me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Në seancë janë të pranishëm 89 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Konstatohet se me 78 vota për, 10 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Ndërkohë, ngarkohet Komisioni ad hoc për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i autorizuar që ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Unë desha të ju pyes: I kemi edhe dy pika, të vazhdojmë apo ta përfundojmë? Në rregull, vazhdojmë.

Pika e pestë e rendit të ditës është:

5. Shqyrtimi i parë i Projektkodit të procedurës penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektkodin e procedurës penale dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministër i Drejtësisë, zotin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë Projektkodin. Zoti Kuçi, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar, Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, Të nderuar anëtarë të Qeverisë, Më lejoni që para jush ta paraqes Draftkodin e ri të procedurës penale të Republikës së Kosovës, i cili është i hartuar nga Ministria e Drejtësisë bashkërisht me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me Gjykatën Supreme, Këshillin Prokurorial, me Policinë e Kosovës, me EULEX-in dhe me ekspertë...

Natyrish se ky Projektkod ka për qëllim që t'i respektojë në plotëni të drejtat dhe liritë e njeriut, por edhe ta rrisë efikasitetin në kuptimin e drejtësisë.

Më lejoni që t'i theksoj disa prej ndryshimeve dhe specifikave të këtij Projektkodi.

Kodi i procedurës penale përmban standarde më të larta të të drejtave të njeriut, i cili përshtatet me praktikën e gjykatave evropiane për të drejtat e njeriut. Dhe, më lejoni të përmend se gjatë gjithë kohës së hartimit të këtij Projektkodi i kemi shikuar vazhdimisht vendimet e Gjykatës Evropiane për të parë nëse ndryshimet që duhet t'i bëjmë janë në përputhje me praktikën, rrjedhimisht them me Konventën Evropiane për Liri dhe të Drejtat e Njeriut.

Kodi i procedurës penale e reformon procedurën penale, duke mundësuar që të përdorë më pak gjyqtarë në procedurë, duke e hequr nevojën për panelin me tre gjyqtarë në shumë raste, por edhe duke u dhënë gjyqtarëve dhe të pandehurve të drejta edhe më të mëdha. Kjo do të ndikojë ndjeshëm në zvogëlimin e lëndëve të mbetura në gjykatat tona.

Më duhet të përmend këtu se pas një diskutimi të gjatë dhe me partnerët tanë në proces, është vendosur që të hiqen gjyqtarët porotë, ashtu siç është bërë edhe në shumë vende të rajonit për shkak se praktika e ka dëshmuar këtë. Ndonëse qëllimi i angazhimit të tyre ka qenë i mirë, është treguar joefikas në procedurë dhe shpeshherë i panevojshëm për shkak të influencës së tyre nga gjyqtari profesional.

Ky kod ka krijuar më shumë fuqi për prokurorët dhe Policinë e Kosovës që t'i hetojnë aktivitetet komplekse kriminale, duke qartësuar shumë faza të ndryshme të hetimit, duke qartësuar mundësitë për hetim të fshehtë dhe duke qartësuar bashkëpunimin dhe gërshetimin e punës së plotë të Policisë së Kosovës dhe të Prokurorisë, ndërkohë që gjithsesi të respektohen liritë dhe të drejtat e të dyshuarit, apo të pandehurit.

Viktimat e krimit tani e kanë një rol shumë më të definuar, më aktiv në procedurë dhe në mënyrë që mund të mundësohet që në mbrojtjen e tyre t'i kenë të drejtat që ata i përcaktojnë vetë.

Ky kod tashmë përmban procedura shumë më të qarta të konfiskimit të pasurisë, duke i përmirësuar kështu mangësitë e kodit të kaluar. Kemi mundësuar një proces për t'i identifikuar, bllokuar dhe konfiskuar të mirat materiale, dobite pasurore për vepra penale. Kur kjo kombinohet me draftin e ri të Ligjit mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar nëpërmjet veprës penale, prokurorët dhe gjyqtarët tanë do ta kenë

më lehtë ta vërtetojnë prejardhjen e pasurisë nga veprat penale edhe atë ta konfiskojnë me kohë.

Duke i referuar këtij kodi, do të mundësohet që kompetencat e zgjeruara që të konfiskohet pasuria kur i pandehuri ikën nga Kosova, vdes apo kur është duke e drejtuar një vepër kriminale të ngjashme për të cilën akuzohet, do të veprohet shumë më shpejt dhe do të jetë në përputhje të plotë me ligjet dhe Kushtetutën tonë.

Ky kod garanton që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme ta kenë një rol të qartë, procedura të qarta për ankimim, ta minimizojnë ndarjen e drejtësisë. Jo në çdo rast do të ketë mundësi që të shkojë në Gjykatën Supreme, do të shkojë në rastet kur të dyja gjykatat e niveleve më të ulëta kanë dhënë aktgjykime të ndryshme njëra me tjetrën, apo në rastet ku shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm.

Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se, për dallim nga kodi i kaluar, Gjykata e Apelit tani ka kompetenca që vetë ta ndryshojë aktgjykimin, pa pasur nevojë që rastin ta rikthejë në gjykatën paraprake për përsëritje të procedurës. Kjo do ta përshpejtojë dukshëm procedurën dhe do t'i lirojë gjykatat nga rastet e shumta dhe përsëritjet e panevojshme të procedurave.

Zonja dhe zotërinj,

Me këtë kod e kemi përmirësuar mundësinë e hetimit të krimeve të komplikuar. Kjo përfshin rregullimin akoma më të mirëfilltë të masave të fshehta të hetimit, të përgjimeve, të simulimeve dhe marrjen e të dhënave financiare shumë më parë në procedurë.

E kemi përmirësuar mundësinë dhe ligjshmërinë e marrjes së dëshmive të dëshmitarëve, veçanërisht të atyre që mund të pritët ose mund të mungojnë gjatë gjyqimit kryesor, për shembull nëse ata kanë sëmundje të rëndë dhe mund të pritët se mund të vdesin.

E kemi përmirësuar mundësinë e marrjes së dëshmive financiare dhe prezantimit të tyre para gjykatës. Në këtë mënyrë, do të jetë shumë më lehtë të vërtetohet dobia pasurore, marrja e mitos apo shpëllarja e parave.

Ky kod sjell disa ndryshime në procedurën e pranimit të fajësisë, e cila i shtyn, i inkurajon dëshmitarët bashkëpunues, e cila do t'u mundësojë prokurorëve dhe gjyqtarëve arritje më të lehtë të provave kundër keqbërësve, sidomos në rastet e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Në përgjithësi, efikasiteti i sistemit do të përmirësohet dukshëm, që do të thotë se kemi procedura më të shpejta penale dhe me prova më të mira kundër keqbërësve.

Më lejoni të kujtoj se është hequr procedura e konfirmimit të aktakuzës, e cila në praktikë është parë si joefikase.

Natyrisht, është lënë një mundësi që padia të kundërshtohet nga gjyqtari, apo nga pala, nëse shihet se është krejtësisht e pabazë, por e rëndësishme është heqja e nevojës që në

çdo rast të shkojë nëpërmjet një procedure të konfirmimit dhe të heqë disa muaj nga procedura dhe do të lirojë shumë gjyqtarë dhe procedura të panevojshme.

Qytetarët tanë janë gjithashtu të brengosur për mundësinë e korrupsionit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve tanë.

Ky kod i ri i procedurës penale e ka përmirësuar gjithashtu kontrollin dhe bilancin e palëve të involvuara në procedurë, në mënyrë që të sigurohet që asnjë pjesë e sistemit të mos jetë shumë e fuqishme, apo shumë më e dobët se tjetra, dhe kështu të eliminohet mundësia e korrupsionit të ndonjërit.

Ky është njëri ndër kodet më moderne në nivelin e lartë të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut me përdorim shumë efikas të mundësive dhe autoritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky kod do ta ndihmojë Policinë dhe prokurorët e Kosovës që t'i ndjekin krimin dhe kriminelët, të kenë prova më të mira, më të qëndrueshme, gjykime më të mira, më efikase, dhe procedura më të mira të apelit, më të shpejta dhe më të drejta.

Dhe gjithë kjo është bërë duke u përkujdesur që të pandehurit të mos i cenohet asnjë e drejtë.

Ministria e Drejtësisë tashmë ka marrë një sërë komentesh në kuptimin më pozitiv nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare në lidhje me përputhshmërinë e këtij kodi me “aci comunitar” dhe me ide të reja, të cilat do të vijnë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Jemi të bindur që do të përmirësohet dhe do ta kemi një kod efikas.

Ju ftoj që ta miratoni në parim dhe pastaj t'i jepni mendimet tuaja që kodi të jetë efikas, t'u japë të drejta gjyqtarëve dhe prokurorëve tanë, por edhe t'i mbrojë liritë dhe të drejtat e çdo qytetari tonë. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kuçi! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi, kryetar i Komisionit Funkcional për Legjislacion.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar Projektkodin penal dhe duke marrë parasysh se e kemi edhe Kodin e ri Penal, i cili pritet të hyjë në fuqi më 1 janar, po ashtu edhe sistemin e ri - Ligjin për gjykatat, i cili bën riorganizimin dhe funksionalizimin e gjykatave, mendojmë që është me rëndësi që Kosova ta ketë po ashtu edhe Kodin e procedurës penale, i cili parasheh hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave penale. Prandaj, mendoj se është shumë me rëndësi që ky të kalojë dhe vendimi i komisionit është që Kodi i procedurës penale të kalojë në leximin e parë dhe pastaj brenda afatit kohor në t'i japim edhe amendamentet e nevojshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti Gashi! Deklaratë për Ligjin, nga PDK-ja, Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta votojë në parim Projektkodin e procedurës penale. Vlerësojmë se e ka një gjuhë të qartë, sidomos e vlerësojmë qartësinë e normës sa i përket raportit ndërmjet Policisë dhe Prokurorisë, i cili në të kaluarën është gjykuar edhe nga raportet ndërkombëtare për sundimin e ligjit në Kosovë. Prandaj, konsiderojmë se posaçërisht do ta ndihmojë sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin e detyrueshëm ndërmjet Policisë dhe Prokurorisë.

Njëkohësisht, ju njoftoj se në kuadër të Komisionit për Legjislacion është krijuar edhe grupi punues, përkatësisht grupi i njëjtë që ka punuar në Kodin Penal dhe në komision jemi dakorduar për hir të vazhdimësisë dhe të ekspertizës që e ka komisioni, duke pasur parasysh angazhimin e profesorëve, si zoti Demolli, pastaj edhe juristët tjerë që ka komisioni, do të punojë në amendamentim.

Prandaj, u inkurajojmë të gjithëve që të bashkëpunoni me Komisionin për Legjislacion, përkatësisht me grupin punues, në mënyrë që të ndihmojmë sa më shumë në plotësim-ndryshim, nëse ka nevojë.

Ju inkurajojmë edhe të tjerëve që ta miratojmë në parim Projektkodin e procedurës penale. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti deputet! Për LDK-në, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Falemnderit, i nderuar nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah Projektkodin e procedurës penale dhe mendon që duhet të vazhdojë tutje. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zotëri Gashi! Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektkodin për procedurën penale. Gjatë shqyrtimit kemi hasur në shumë vërejtje teknike, por edhe përmbajtjesore, të cilat sigurisht që do t’i analizojmë në grupin punues me përfaqësuesit e institucioneve që preken direkt apo në mënyrë indirekte nga ky Projektkod.

Unë uroj që nenet për përgjegjësinë e medieve dhe burimin e informacionit, të cilat i kemi në pikën tjetër të rendit të ditës, të hiqen nga Kodi Penal, dhe nëse ndodh ashtu, atëherë do të bien poshtë edhe nenet 31 dhe 32 të këtij Projektkodi.

Pra, si të tillë ne do ta votojmë dhe do ta shqyrtojmë në grupin punues. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zonja deputete! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta mbështesë në parim dhe normalisht se i kemi disa elemente, për të cilat do të flasim gjatë procedurës tjetër. Por, në përgjithësi, e shohim si një mundësi të mirë të disa ndryshimeve, ose të themi qartësime në procedura, në afate kohore, të qartësimit dhe të përafrimit të punës së mundshme të përbashkët ndërmjet dy shtyllave të rëndësishme në këtë temë, që ka të bëjë me Policinë dhe Prokurorinë. Besojmë se ky kod i procedurës penale do të mundësojë definitivisht, nëse ka vullnet për zbatimin e tij, një punë më të fuqishme në zbatimin e ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zotëri Ramadani! Për SLS-në, Sasha Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

I Poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke je razmatrala Nacrt zakona o krivičnom postupku, i mi čemo ovaj nacrt podržati u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit, zotëri deputet! Për Grupin “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE:

Zavhaljujem!

Parlamentarna Grupa “6+” podržace Nacrt zakona o krivičnom postupku, jer smatra da uvodi velike novine koje će olakšati i poboljšati posao u oblasti krivičnog prava. Novi kod će biti od velike koristi sudovima i tužiocima u izricanju kazni i čitave efikasnosti kompletnog sistema. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk kemi deputetë të tjerë që dëshirojnë të flasin për këtë ligj.

Unë i thërras deputetët dhe regjinë të bëhen gati për ta votuar miratimin në parim të Projektligjit të procedurës penale.

Në sallë i kemi të pranishëm 66 deputetë. Votojmë tani!

Votohet dhe miratohet në parim Projektkodi i procedurës penale me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë:

6. Shqyrtimi i vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës për rishqyrtim

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar vendimin e Presidentes së Kosovës për kthimin në Kuvend të neneve 37 dhe 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëro, deputet!

ARBEN GASHI: Falemnderit, i nderuar nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar me seriozitet vendimin e Presidentes për kthimin e neneve 37 dhe 38 në rishqyrtim dhe në trajtimin e të këtij vendimi, faktikisht të këtyre vendimeve, në shumës, sepse Presidentja në aspektin juridik dhe procedural e ka bërë një shkelje dhe gabim, që është një precedent i panevojshëm, sepse i ka nxjerrë dy vendime brenda një vendimi.

Kjo është diskutuar gjatë në komision, mirëpo komisioni e ka pasur vullnetin që ta anashkalojë këtë problem dhe, në fund të fundit, Presidentja e ka pasur edhe një problem tjetër, se përveç që i ka nxjerrë dy vendime, duke thënë: Vendimi i parë, kthehen nenet 37 dhe 38 për shqyrtim, dhe po ashtu: Vendim, kthehet Kodi Penal për rishqyrtim.

Dhe, kur arsyetimi i cili është bërë për kthimin e këtyre neneve dhe kthimin e Kodit Penal, po ashtu ekziston një problem tjetër, sepse nuk është një arsyetim i logjikshëm se çfarë ka kërkuar Presidentja.

Pas kërkesës që e ka bërë Presidentja, e ka dhënë edhe një referencë që i referohet Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut. Kjo konventë parasheh më shumë masa bllokuese se sa parashohin nenet 37 dhe 38. Dhe këto masa bllokuese, që i ka rekomanduar Presidentja që të merren në konsideratë, kanë hasur në rezistencë nga komuniteti i gazetarëve dhe përfaqësuesit e tyre.

Ne kemi pasur diskutime me përfaqësuesit e komunitetit të gazetarëve - përfaqësuesit ndërkombëtarë, të cilët merren me zbatimin e ligjit në Kosovë, e po ashtu me Prokurorin e Shtetit, Prokurorin Special, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, përfaqësues të avokatit dhe po ashtu kemi pasur edhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, me të cilët kemi diskutuar dhe e kemi bërë një analizë të thellë se çfarë do të ndodhë e çfarë duhet të bëhet me këto dy nene.

Dhe, duke marrë në analizë dhe në konsideratë rekomandimet që Presidentja i ka dhënë - të rishqyrtohet, po e theksoj “të rishqyrtohet”, sepse Presidentja ka rekomanduar që të rishqyrtohen nenet 37 dhe 38, dhe të rishqyrtohet Kodi Penal.

Prandaj, mendoj se si komision kemi vendosur që rekomandimet e Presidentes nuk kanë bazë juridike dhe nuk kanë logjikë juridike, mirëpo në të njëjtën kohë komisioni e ka marrë në konsideratë vullnetin që ta japë një zgjidhje për këtë situatë, në të cilën ka hyrë vendi lidhur me Kodin Penal.

Po ashtu, ka pasur edhe shumë deklarime publike, edhe nga institucionet ndërkombëtare, që merren me lirinë e medias dhe me lirinë e shprehjes.

Dhe, së fundi, ju mund të jeni edhe dëshmitarë se ka dalë edhe një deklaratë nga Freedom House, që thotë se neni 38 nuk duhet të hiqet nga Kodi Penal, sepse është në kundërshtim me interesin e gazetarëve.

Mirëpo, diskutimi që ka mbizotëruar në komision dhe vullneti që ka mbizotëruar në komision është se, meqë media dëshiron t'i heqë nenet 37 e 38, atëherë ne e kemi vullnetin që të hiqen nenet 37 e 38. Dhe, sa për dijeni të informimit publik, nenet 37 dhe 38 parashohin përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera nëpërmjet medieeve.

Nëse sot hiqet neni 37, atëherë mbetet në fuqi Ligji për përgjegjësinë penale të personave juridikë, që është pak a shumë e njëjta gjë.

Neni 38 parasheh marrjen e burimit të informatës dhe thotë: “Nuk mund të kërkohet burimi i informatës”. Kjo është pak a shumë logjika e nenit, “nuk mund të kërkohet burimi i informatës, përveç nëse me vendim gjykate vërtetohet”, me vendim gjykate, po e përsëris, vërtetohet “se është në rrezik jeta dhe integriteti fizik i dikujt”.

Mediet nuk kanë kërkuar, bile në qoftë se e shohim Konventën Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, aty përveç shumë elementeve tjera, që janë siguria nacionale, që është integriteti fizik dhe moral, që ka edhe shumë elemente tjera, sigurimi i jetës, rrezikimi i interesit publik dhe shumë elemente tjera, që rekomandohen nga Presidentja, komisioni i ka shqyrtuar të gjitha këto dhe në konsultim edhe me përfaqësuesit e medieeve ka ardhur në konkluzion që t'i rekomandojë Kuvendit që nenet 37, 38 dhe 39 të hiqen nga Kodi Penal, mirëpo të njëjtën kohë i informon edhe gazetarët, edhe të gjithë deputetët, në momentin që neni 38 hiqet nga Kodi Penal, vlen parimi i përgjithshëm i përgjegjësisë: Kushdo që ka informacion për kryerjen e veprës penale dhe nuk e denoncon kryerjen e saj, kryen vetë vepër penale.

Ky është parimi i përgjithshëm. Po flas “kushdo”, e kushdo këtu është edhe deputeti, edhe gazetari dhe i gjithsecili qytetar i Kosovës. Bile edhe qytetarët e Kosovës, që kanë informacion për kryerjen e veprës penale brenda territorit të Kosovës janë përgjegjës për ta denoncuar veprën penale, përndryshe realizojnë vetë vepër penale.

Prandaj, si konkluzion, komisioni i ka rekomanduar seancës që t'i heqë nenet 37, 38 dhe 39 dhe të vlejnjë parimet e përgjithshme sa i përket nenit 38 dhe normalisht se vlen Ligji për përgjegjësinë penale të personave juridikë sa i përket nenit 37. Faleminderit!

KRYESUESI: Para se t'ia jap fjalën deputetit të radhës, unë i ftoj deputetët që të jenë të pranishëm në sallë, sepse për votimin e këtij propozimi të Komisionit duhen 61 vota për. Kështu që, kush është diku afër sallës, le të hyjë brenda, edhe regjia le t'i thërrasë, ndërsa fjalën e ka kërkuar deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryesues,
Zëvendëskryeministër, ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha dashur ta marr një shembull hipotetik para jush. Ta them se nesër një biznesmen që e kontrollon një gazetë e humb një tender shumëmilionësh për arsye të ndryshme, ndërsa dikush që ishte përgjegjës për tenderin ishte korruptuar, apo ndoshta vetë biznesmeni që dëshironte ta fitonte tenderin, ishte i tillë.

Fjalë shumë dhe para pak! Pas humbjes së atij tenderi, biznesmeni që e ka gazetën si armë të tij nukleare, vendos që përgjegjësin kryesor për mosmarrjen e tenderit ta linçojë në gazetën e tij. Ta akuzojë se i kishte kërkuar miliona euro dhe se ky nuk ishte i gatshëm që t'i paguante ato, sepse dëshironte fitoren e pastër.

Ne nuk e dimë, e as që do ta dimë ndonjëherë sigurisht të vërtetën e plotë. Por, një gjë tash e dimë se një pjesë e medieve është shndërruar thjesht në armë plotë helm në duart e biznesmenëve.

Pjesën tjetër të rrëfimit, besoj se të gjithë e dini. Dhe, nuk është këtu vetëm aspekti i biznesit dhe i biznesmenëve, që sapo i kanë zbuluar mediet për t'i përdorur si argumente në favorin e tyre, për të fituar gjithçka çka mund të fitohet dhe atë me çdo kusht, e me çdo çmim.

Janë këtu edhe mediet e ish-politikanëve dhe politikanëve që duhet të bëhen. Pra, janë disa dëme që nuk kompensohen as me padi civile, e as me të mira materiale.

Njerëz të pandershëm, të korruptuar dhe hipokritë, që e meritojnë dënimin dhe burgun, të nderuar kolegë deputetë, ka edhe në mesin tonë. Definitivisht, gjenden edhe në Qeveri, por patjetër që ndodhen edhe në botën e biznesit, sepse ndryshe korrupsioni dhe pandershmëria nuk do të piknin as në Kuvend, e as në Qeveri, nga qielli i kthjellët. Dhe, nëse paska biznese të pandershme, të korruptuara, e pse jo edhe me pretendime politike, të jeni të bindur se të tilla do t'i kemi edhe një pjesë të medieve. Nuk dëshiroj të them se shumica është e tillë.

Dhe, nëse puna ka ardhur deri këtu dhe nëse jemi duke jetuar në një shoqëri kaq të polarizuar, herë-herë me instinkte të paraardhësve tanë të lashtë, pse Kuvendi duhet të pranojë që ta heqë komplet frerin prej cilësdo kategori shoqërore, qofshin këto edhe mediet. Pse një komision, e tash një Kuvend, duhet të dobësohet kaq shumë përpara një asociacioni të gazetarëve, apo më mirë të them përpara një përfaqësuesi të një asociacioni të gazetarëve, që e lëshon mbledhjen dhe hyn në mbledhje sa herë që atij t'i teket, duke vënë kushte. Si është e mundur që një individ ta shantazhojë një Kuvend, apo një komision?

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës nuk është dakord me nenet aktuale të Kodit Penal, që flasin për lirinë e shprehjes. Mirëpo, Grupi Parlamentar i PDK-së nuk është aspak dakord që ato nene të hiqen në mënyrë të plotë.

Kemi propozime konkrete se si ato do të duhej të dukeshin. Ne këmbëngulim dhe propozojmë që të bëhet një riformulim adekuat, duke marrë praktikën më të mira evropiane dhe ato të shteteve fqinje, në mënyrë që edhe veprimtaria e medieve, në

mënyrë që edhe shpifja, në mënyrë që edhe fushat e egra me motive korruptuese ta kenë një adresë adekuate.

Nëse dikush më thotë mua këtu se këtë çështje duhet ta rregullojë vetëm Kodi Civil, atëherë unë do të thosha se disa krime nuk paguhen me euro.

Si ish-gazetar dhe tash si deputet, ju kisha lutur që të mos ngutemi t'i shkurtojmë të gjitha ato nene, pse dikujt i është tekur. Kuvendi i Kosovës nuk do të duhej të ishte adresa e duhur ku duhet të plotësoheshin teket e individëve, qofshin këta gazetarë, qeveritarë, apo çka do tjetër.

Pra, ne do të votojmë kundër heqjes së këtyre neneve, si Grup Parlamentar. Definitivisht, jemi të hapur për një riformulim, bazuar në praktikat më të mira.

Krejt në fund, jam i bindur që më së shumti dëmtohen mediet, siç e përmendi edhe Arbeni - Freedom House, që e ka përmendur nenin 38. Pra, nëse ne i heqim komplet, mediet do të jenë ato që do ta paguajnë çmimin. Edhe ashtu, është shndërruar krijuar një xhungël mediale, meqë i keni parë portalet, keni parë mediet elektronike, të gjithë jemi viktimë të tyre, e më së shumti vetë mediet janë viktimë, sepse u ka humbur kredibiliteti. Po të kishin mediet kredibilitet, do ta kishim një ambient tjetër të tyre.

Pra, çmimin do ta paguajmë të gjithë së bashku. Për këtë të jeni të sigurt! Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të LDK-së, fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Falemnderit, i nderuar nënkryetar!

Po bëhet ndoshta shumë që po flas, por kështu kemi rënë dakord edhe në Grupin Parlamentar që sa i përket Kodit Penal dhe Kodit të procedurës penale të flas unë.

Sa u përket neneve 37, 38 dhe 39, Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah vendimin e Komisionit dhe është e vetëdijshme për pasojat që prodhohen, dhe pasojat janë barazia përpara ligjit e të gjithëve. Ky është parim mbi të cilin ne po fillojmë ta ndërtojmë dhe parimi mbi të cilin ne duhet të funksionojmë.

Parimisht, ne kemi menduar paraprakisht se do të duhej të kishte masa mbrojtëse sa i përket lirisë së medie dhe lirisë së shprehjes, mirëpo kemi ardhur në një situatë, kur si rezultat i sjelljes së papërgjegjshme, po e them tash, të institucionit të Presidentit, e ka sjellë një rekomandim, i cili nuk e ka pasur bazën e vet juridike të plotë, arsyetimin logjik dhe arsyetimin juridik të theksuar.

Prandaj, mendoj se jemi në një situatë kur ne si Kuvend duhet të marrim vendim, dhe vendimi që është propozuar nga komisioni, Lidhja Demokratike e përkrah.

Sa u përket fjalëve, që i tha parafolësi, lidhur me mundësinë e presionit apo shantazhimit që i është bërë komisionit, nuk besoj se është ai rast. Rasti ka qenë pak më flagrant në lidhje me sjelljet e Ministrisë së Drejtësisë, konkretisht ministrit të Drejtësisë, i cili në një

moment të caktuar ka thënë se “do të jap dorëheqje nëse nenet 37 dhe 38 nuk hiqen” dhe ka krijuar një situatë konfliktuale në kuptimin e perceptimit të masës se çfarë po ndodh, mirëpo realisht ne jemi në një situatë kur duhet të marrim vendim mbi procedurën juridike, e jo mbi deklaratimet politike që i ka bërë ministri ose kushdo tjetër, sepse është e drejtë e tij të bëjë deklarime publike politike. Mirëpo, ne e kemi vendimin e Presidentes, të cilin e kemi trajtuar.

Sa u përket përfaqësuesve të medieve, meqë parafolësi po ashtu iu referua se kanë ardhur në komision dhe kanë hyrë e kanë dalë kur kanë dashur, ata as nuk mund të hyjnë e as të dalin kurdo, dhe u është dhënë fjala si palë e interesuar, jo në mbledhjen e komisionit, por në një tryezë të rrumbullakët, mbi bazën e së cilës janë ftuar të gjitha ato institucione, të cilat i përmenda. Dhe, askush s’mund të sillet si kauboj me institucionet e Republikës së Kosovës, e as me Kuvendin, dhe jam shumë dakord këtu me parafolësin, sepse gjuha e cila është përdorur në momente të caktuara nga këta përfaqësues të medieve, ose shpesh edhe pseudo-përfaqësues, sepse ka pasur edhe përfaqësues tjerë që kanë thënë - nuk na përfaqësojnë këta përfaqësues të medieve. Mirëpo, ne jemi në një situatë të tillë kur duhet të vendosim si Kuvend. Dhe, vendimi më i arsyeshëm ka qenë ky, sepse e kemi pasur edhe një deklaram, po ashtu të pamenduar dhe veprim të pamenduar edhe të përfaqësuesit të Bashkimit Evropian në tryezën, së cilës po i referohem. Në tryezë, përfaqësuesi i Bashkimit Evropian ka thënë se ne e patëm vullnetin që ta marrim komplet materien e Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe ta bëjmë materie të nenit 38, meqë po i referohet Presidentja, meqë është një Konventë Evropiane, meqë është një standard. Dhe, aty nga përfaqësuesi i Bashkimit Evropian u tha që duhet të merren edhe të gjitha protokollet e rekomandimet që i kanë dhënë gjykatat e ndryshme të nivelit të Bashkimit Evropian për këtë interpretim të kësaj konvente. Atëherë, ne nuk mund ta bëjmë atë punë, sepse për t’i bërë materie të ligjit tonë të gjitha këto konventa dhe protokolle që janë vendosur më vonë, duhet të hyjë një sistem tjetër në fuqi, që është sistemi i ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe elementeve tjera, që nuk kemi mundur t’i bëjmë si Kuvend.

Gjithsesi, duke marrë parasysh se Kosova e pranon edhe Konventën Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, i bie që neni 38, që tashmë nuk do të ekzistojë, nëse kalon propozimi i komisionit, dhe nuk do të ekzistojnë as nenet 37, as 38, e as 39, por materia e cila rregullohet është parimi i përgjithshëm që e rregullon dhe pastaj në praktikën e zbatimit të sistemit juridik do të jetë materia e Konventës Evropiane, sepse sistemi juridik në Kosovë e pranon Konventën Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe prandaj, si logjikë e kësaj, Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah vendimin e Komisionit dhe është që nenet 37, 38 dhe 39 të hiqen nga Kodi Penal. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Fillimisht dua të ju informoj pak për rrjedhën e këtij Projektkodi. Ju e dini shumë mirë se qysh më 20 tetor, kur është shqyrtuar Projektkodi penal, ne kemi pasur qëndrime shumë të qarta për nenet 37 dhe 38 të Kodit Penal. Pra, Lëvizja “Vetëvendosje” ka pasur qëndrim që të hiqen në tërësi nenet 37 dhe 38 nga Kodi Penal.

Por, ajo çfarë ka ndodhur, fatkeqësisht, është se janë miratuar nenet 37 dhe 38, e që është bërë një shkelje e rëndë e lirisë së medieeve.

Pra, miratimi i atyre neneve do të thotë një instalim i shtetit diktatorial, i cili shantazhon lirinë e medieeve, gazetarëve, redaktorëve, kryeredaktorëve e botuesve. Pra, është bërë mirë që Presidentja e ka kthyer Kodin Penal me nenet 37 dhe 38, edhe pse me plot defekte juridike dhe formulime të përgjithshme, të cilat akoma nuk e di se cili ka qenë qëndrimi i Presidentes në lidhje me nenet 37 dhe 38.

Unë do të doja të ndalem vetëm pak në nenet 37 dhe 38. Sa i përket nenit 37, si mund autori i informacionit të shkaktojë vepër penale me nxjerrjen e informacionit? Ju e dini shumë mirë se çfarë do të thotë vepër penale. S'ka asnjë mundësi të shkaktohet vepër penale me publikimin e një informacioni.

Pra, edhe kalimi i fajit te personi tjetër është kundërshtim juridik dhe është i papranueshëm.

Sa përket nenit 38, nëse dikush është në dijeni të një kërcënimi apo kanosjeje të jetës së tjetrit, qoftë edhe gazetar, ka për detyrë ta denoncojë sa më parë në organet e rendit.

Pra, ky është parim i përgjithshëm. Këtu nuk luan rol profesioni. Është një fushë që nuk parashikohet gjatë kryerjes së profesionit.

Nuk duhet të jetë në Kodin Penal, sepse gazetari në detyrë dhe për shkak të detyrës është mirë të mos e takojë prokurorin. Dhe, çdo takim i gazetarisë me Penalen hap rrugë për censurë.

Pra, gazetari dhe prokurori është mirë të takohen veç në rastet kur, pas hulumtimit gazetaresk, Prokuroria e inicion një çështje dhe nis hetimet për çështjen, por jo për gazetarin.

Pra, qëndrimi i Lëvizjes “Vetëvendosje” mbetet i njëjtë dhe Lëvizja “Vetëvendosje” e përkrah propozimin e Komisionit për heqjen e neneve 37 dhe 38 nga Kodi Penal. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete. Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës definitivisht do të votojë për heqjen e këtyre tri neneve nga Kodi Penal dhe për këtë janë dy arsye, dhe realisht arsyeja kryesore është fakti se komisioni përkatës e ka dhënë këtë rekomandim dhe sikur që tha edhe kryetari i Komisionit, këta e kanë shqyrtuar me seriozitet këtë vendim të Presidentes dhe ne do ta përkrahim këtë seriozitet. Pra, do ta votojmë heqjen e këtyre tri neneve.

Arsyeja e dytë është edhe një lloj ankthi publik, dhe po e them pak me shaka, çështja e dorëheqjes së zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë. Pra, do të shohim nëse do të japë dorëheqje ose jo, varësisht prej kalimit ose heqjes së këtyre neneve. Ne mendojmë se duhet të hiqen.

Dhe, edhe një arsye shtesë që na doli edhe gjatë këtij debati është fakti se Berati gati se na e mbushi mendjen se vërtet media ka interesa të caktuara, qoftë të ndryshme, e qoftë edhe financiare, dhe ne jemi të bindur se sigurisht Berati e di mirë e mirë se këso interesash ka pasur dhe ka në mediet e përgjithshme, por nuk po i përmend me emra.

Sidoqoftë, ajo që vazhdon pas heqjes së këtyre neneve, do të vazhdojë me parimet e përgjithshme dhe Grupi Parlamentar i Aleancës e voton heqjen e këtyre neneve, përkatësisht rekomandimin e Komisionit, pas vendimit të Presidentes. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit zoti Ramadani. Për Aleancën Kosova e Re, fjalën e ka shefja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Kodit Penal edhe një herë në Komisionin Parlamentar, do të thotë edhe një herë në Kuvendin e Kosovës, Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah rekomandimet e Komisionit Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Selmani! Për Grupin 6+, deputeti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Ceza Kanununun yeniden görüşülmesi teklifi Cumhurbaşkanı tarafından Meclise sevk edilmesi doğru olduğunu, basın ve yayın özgürlüğü, düşüncenin özgürce ifade edilmesi bizce demokratik bir Kosovada olması gerektir.

İster Anayasamızda, ister de uluslararası insan hakları yasalarında bu haklar çok net bir şekilde ifade edilmiştir.

“6+” Parlamenter Gurubu adına bu ceza kanunundaki medyalarla ilgili 37, 38 ve 39. maddelerin çekilmesinden yanayız.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Tash vazhdojmë me diskutime. Fjalën e ka kërkuar deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministër Mujota,

Para se ta jap një opinion timin, dëshiroj të theksoj se nuk ka pasur një bashkëpunim institucional dhe korrekt ndërmjet Komisionit të Ligjeve dhe Zyrës së Presidentit, sepse Komisioni i Ligjeve me të drejtë ka kërkuar sqarime shtesë nga Zyra e Presidentit rreth qëllimeve të saj rreth këtij ligji për shkak se nuk kontestohet e drejta e saj kushtetuese që t'i rikthejë ligjet, edhe pa arsyetim. Kushtetuta e garanton, por Komisioni ka pasur

problem t'i kuptojë qëllimet. A është presidentja që të hiqen ato krejt, të riformulohen, citimet s'kanë qenë në rregull, ka pasur disa defekte juridike dhe ne kemi kërkuar disa sqarime shtesë, të cilat fatkeqësisht nuk i kemi marrë dhe në vend të një bashkëpunimi institucional, këshilltarët e saj e kanë filluar një luftë mediale me Komisionin, gjë që nuk është një praktikë e rregullt, sepse pa marrë parasysh kompetencat kushtetuese, institucionet duhet të bashkëpunojnë. Dhe, uroj që përdorimi i së drejtës së vetos në të ardhmen të jetë shumë më konkret dhe është e sigurt se Presidentja do të na ndihmonte shumë po të ishte krejt decitive se çfarë do në të vërtetë: Do që këto të fshihen, do që këto të riformulohen, dhe sidomos referencat të jenë më të sakta, sa u përket konventave evropiane.

Momenti i dytë, që dëshiroj ta diskutoj, është fryma e lirive të qytetarit, sidomos jashtë sfondit të lirive personale, jashtë të drejtës për jetë, që është absolute, vetëm e drejta për jetë është absolute. Sfondi i lirive dhe të drejtave tjera janë të rregulluara, janë të kufizuara dhe nuk ka përdorim absolut dhe, edhe në shtetet më demokratike, liria e medieve është e institucionalizuar dhe e rregulluar.

Dhe, momenti i tretë, nëse tani ka kërkesa për riformulim, çfarë edhe dëgjuam, atëherë ato nuk mund të riformulohen ad hoc. Ato kërkesa duhet të zëvendësohen me kërkesë për shtyrjen e kësaj çështjeje. Dhe, në qoftë se një grup parlamentar, dhe rasti konkret, Partia Demokratike, do që të propozojë tekste alternative dhe të propozojë riformulime, ato nuk besoj se do të mund të bëhen në këtë seancë dhe kërkesa duhet të riformulohet që seanca të shtyhet dhe eventualisht të futemi në një debat për riformulim dhe debat, i cili edhe mund të zgjasë.

Sa i përket vetes sime, unë i përkrah rekomandimet dhe do të votoj për rekomandimet e Komisionit. Dhe ne, duke dhënë rekomandime, kemi dashur në fakt t'i japim fund këtij debati, që e ka humbur nganjëherë arsyen dhe jo rrallë është shndërruar edhe në një çështje thjesht mediale dhe mendoj se ne duhet ta përmbylлим këtë debat, sepse me rastin e rikthimit të ligjit zakonisht ka vetëm votim, ka rekomandim e votim, por jo edhe rinegociim të ligjit, i cili, siç dihet, është propozuar nga Qeveria dhe është votuar në Kuvend.

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Falemnderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Po flas në cilësinë e kryetarit të Grupit punues për shqyrtimin e Projektkodit penal dhe në emrin tim personal, meqenëse në emër të Grupit Parlamentar u shpreh një mendim.

Ka pasur një debat të madh rreth këtyre neneve, një debat publik. Ka pasur, për më tepër, edhe shumë keqkuptime rreth këtyre neneve. Disa përfaqësues të medieve kohë pas kohe janë munduar edhe t'i keqpërdorin për t'u promovuar në betejën gjoja për t'u rezistuar përpjekjeve institucionale për kufizimin e lirisë së medieve.

Dhe, ndoshta i gjithë ky debat dhe i gjithë ky muhabet që është bërë është i shëndetshëm për demokracinë, por gjithsesi na ka bërë dëm, sepse përkthimi i këtij debati në anglisht në tetor do të formulohet me pak fjalë - përpjekje institucionale për kufizimin e lirisë së medieve, ndërkohë kjo s'ka qenë e vërtetë.

Të ju përkujtoj se nenet 37, 38 dhe 39 kanë ekzistuar në Kodin aktual Penal për 8 vjet me radhë dhe bash asnjëherë, asnjë procedurë në bazë të atyre tri neneve nuk është nisur në këtë vend.

Të ju përkujtoj po ashtu se nenet 37, 38 dhe 39 janë futur në Kodin Penal në prill të vitit 2004, që i bie një muaj pas ngjarjeve të marsit të atij viti. Dhe, kjo kronologji thotë diçka. Kjo kronologji na tregon se ato nene kryesisht i janë adresuar marsit të vitit 2004, dhe drojës se mediet mund të ndikojnë në urrejtjen ndëretnike, në përhapjen e konflikteve ndëretnike, e kështu me radhë.

Neni 37, as si formulim juridik, nuk ka kuptim. Është një nen, i cili flet për shumë përgjegjësi, që i ikën përgjegjësisë subjektive, që është parim i drejtësisë në demokraci. Është krejtësisht i pakuptimtë.

Neni 38, i riformuluar, siç e patëm bërë herën e parë si Grup punues dhe komision, e ka mbrojtur burimin e informacionit nga gazetarët dhe, megjithatë, gazetarët - përfaqësuesit e medieve, kanë insistuar që të hiqet.

E vërteta është se edhe nenet 37, 38 dhe 39 janë të marra nga Kodi Penal i Republikës së Serbisë. Bile, Kodi i Republikës së Serbisë është më i avancuar sa i përket burimit të informacionit, sepse e kërkon burimin e informacionit me vendim gjykate vetëm për vepra penale, të cilat dënohen me mbi 5 vjet burg. Kurse Kodi ynë Penal e ka mbi 3 vjet burg.

Pra, qoftë edhe për këtë arsye, ato tri nene nuk kanë kuptim. Keqkuptimi i madh që është krijuar këtu dhe në media, sikur këto nene na mbrojnë nga shpifja dhe fyerja, nuk qëndron, sepse është keqkuptim. Këto nene nuk na mbrojnë nga shpifja dhe fyerja.

Projektkodi penal, që na ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë, ka ardhur pa këto vepra penale. Domethënë, këto nene janë hequr akoma pa ardhur te ne. Pra, “shpifja dhe fyerja” nuk na ka ardhur në Kuvend për t’u trajtuar si vepra penale. Kurse këto nene nuk kanë të bëjnë me vepra penale të shpifjes e fyerjes, të cilat kanë mbetur të procedohen me procedurë civile.

Pra, edhe këtu ua heq dilemën, në përgjegjësinë time, nëse dikush mendon se nëse mbeten këto nene, na mbrojnë nga shpifja dhe fyerja. Këto nene nuk na mbrojnë nga shpifja dhe fyerja.

Kanë qenë vepra tjera penale në Kodin e vjetër Penal që na kanë mbrojtur nga shpifja dhe fyerja.

Ndërkohë që personalisht angazhohem për ta sanksionuar shpifjen dhe fyerjen, për t'i mbajtur përgjegjëse mediet, por mund ta rregullojmë me ligj tjetër. Mund ta rregullojmë edhe burimin e informacionit, nëse duam, me ligj tjetër, si ta mbrojmë burimin e informacionit, përkatësisht se si t'i mbrojmë gazetarët.

Pra, unë personalisht dhe në emrin e Grupit punues, që e ka bërë një punë shumë të mirë, sugjeroj që të aprovohet raporti i Komisionit për Legjislacion me rekomandimet e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti deputet! Fjalën e ka kërkuar deputeti dhe shefi i Grupit të PDK-së, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryesues!

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar këtë çështje me një kujdes të veçantë dhe ne kemi ardhur në përfundim, si Grup, që të kërkojmë nga seanca riformulimin e këtyre dy neneve, mirëpo Grupi Parlamentar i PDK-së, nëse kolegët tjerë e shohin të nevojshme që duhet të hiqen, ne nuk do të dalim në mënyrë absolute kundër heqjes së këtyre dy neneve, por kemi vlerësuar dhe vlerësojmë edhe sot se është në të mirën e të gjithëve, në të mirën edhe të vetë gazetarëve për mbrojtjen e tyre, në të mirën edhe të medieve, që të kemi medie të lira, ta kemi një riformulim të këtyre dy neneve, prandaj ne ia lëmë seancës që të vendosë për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar deputeti i AAK-së, Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Me të drejtë është duke u diskutuar për këto dy nene dhe personalisht, për çka si Aleancë u shpreh më parë edhe Burimi, mendoj se këto dy nene duhet të kthehen, të votohen në Kuvend dhe deputetët të konstatojnë nëse ato janë drejt apo jo.

Mendoj që është shumë e pandershme në rast se i sanksionojmë mediet me këto dy nene, dhe ka pasur të drejtë Presidentja që i ka kthyer. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Unë, në fakt, e pata kërkuar fjalën më herët, por erdhi radha kështu si erdhi dhe situata, pas paraqitjes së kryetarit - shefit të Grupit tonë Parlamentar, pak a shumë është më e sqaruar.

Unë u paraqita menjëherë pas fjalës së deputetit Berat Buzhala, sepse ishte një frymë dhe qëndrim që ne në Grupin punues nuk e kishim të njohur dhe nuk e kishim pas absolutisht për orientim, madje as në komision kur kemi votuar dhe kjo ne - përfaqësuesve të Partisë Demokratike në Grupin punues dhe në Komisionin e Legjislacionit, na sfidonte dhe na nxirrte pak në siklet, kështu që unë dëshiroj ta sqaroj një situatë.

Në Grupin punues kam propozuar që të modifikohen në debat disa çështje me mediet, madje kemi arritur që të marrim edhe miratimin e tyre. Nga të parët kam qenë që kam kërkuar që të hiqet kjo pjesë dhe të debatohet me ta një pjesë që ishte e debatueshme, e madje e kemi marrë edhe pëlqimin e tyre. Por, rrjedhat në komision ndryshuan dhe ne pastaj u përcaktuam, siç u përcaktuam.

Tani, në mbledhjen e fundit, edhe në takimin e Grupit punues, por edhe të komisionit, përfaqësuesit e Partisë Demokratike janë deklaruar që nenet 37, 38 dhe 39 të hiqen. Dhe, ky ka qenë qëndrim zyrtar deri atëherë kur ne i kemi marrë këto qëndrime.

Dhe, me këtë frymë që tani u diskutua këtu tregon se edhe në Partinë Demokratike vazhdon një frymë e debatit demokratik. Nuk jemi parti e ngurtë, por secili e ka personalitetin e vet, e ka mendimin e vet. Kurse, tash, qëndrimi i shefit të Grupit Parlamentar tash na i lehtëson pak qëndrimet tona dhe na sensibilizon që të mendojmë pozitivisht.

Prandaj, kjo ishte situata, këto ishin qëndrimet. Ndërsa, qëndrimi im personal është që t'i mbështetim qëndrimet e komisionit, në të cilin kam marrë pjesë dhe kam votuar edhe unë.

KRYESUESI: Falemnderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, përkatësisht ministri Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Unë e di se është pjesë e debatit që ka të bëjë edhe me atë që quhet raport i medieve dhe me politikën, apo i politikës me media. Dhe, po ashtu, e di që këto dy nene, edhe nëse mbahen, edhe nëse hiqen, nuk i rregullojnë këto raporte. Është diçka tjetër që duhet ta rregullojmë.

Por, unë kam thënë dhe besoj qëndrimi është shumë i qartë, në emër të Qeverisë së Kosovës dhe pastaj edhe kryeministri i Kosovës, që ka qenë të hiqen këto dy nene. Për këtë janë dy arsye:

Arsyeja e parë: Neni 37, me Ligjin për përgjegjësinë penale të personave juridikë, të njëjtën përgjegjësi e parasheh. Kështu që s'ka nevojë të jetë fare.

Arsyeja e dytë: Në nenin 38, Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut është dokument, që është paraparë në Kushtetutën e Kosovës dhe implementohet në vendin tonë. Do të thotë, bile këtu e ka edhe një përparësi, e që thuhet në Kushtetutë: Kur ndeshet e drejta e vendit me të drejtën ndërkombëtare, e para vlen e drejta ndërkombëtare. Dhe, cilëndo zgjidhje që e bëni, prapë do të vlejë konventa.

Kurse unë po them po ashtu se Grupi Parlamentar i PDK-së, që unë dua të besoj që PDK-ja nuk mendon ashtu, e unë si nënkryetar i PDK-së po e them kështu, do të jetë racional

për mendimet dhe vendimet që i bën sot, e jo në kuptimin as t'i luftojë mediet, e as t'i marrë me të mirë.

Zgjidhjet që i bën ligji, i bën prej sot e tutje. Ligji nuk bën zgjidhje, duke i parë fotografitë aktuale të njerëzve.

Nëse i shohim disa gazetarë, disa biznesmenë, disa politikanë - duhet futur edhe nja 20 nene tjera. Por, nëse i shohim nenet që i ka Evropa, që i ka bota, duhet t'i bëjmë ashtu. Unë mendoj se Komisioni ka bërë punë të mirë. Presidentja ka bërë mirë që i ka kthyer, dhe unë ju ftoj që edhe PDK-ja, edhe të tjerët, ta mbështetni propozimin e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit zoti zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, sponsorues direkt i këtij ligji. Nuk ka të tjerë që duan ta marrin fjalën.

Por, të ju them të drejtën, po të mos isha këtu i vetëm në udhëheqje, do të flisja diçka, por nuk do të flas, sepse kjo është temë, për të cilën do t'ia vlente të flitet, por jemi në momentin e votimit.

Ju lutem, të na e jepni numrin e të pranishmëve, sepse nuk e kemi, meqë ka lëvizje.

Pra, në sallë i kemi të pranishëm 71 deputetë. Ne i dëgjuam diskutimet. E dëgjuam edhe mendimin e Komisionit dhe e dëgjuam mendimin e Qeverisë, që thonë se pajtohen që këto nene të hiqen.

(Ndërhyrje)

Urdhëro! Për ta qartësuar?

Atëherë, Komisioni Funkcional për Legjislacion i propozon Kuvendit miratimin e amendamentit, i cili kërkon të hiqen nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal, i cili është votuar këtu. Më qartë, s'di si ta them.

Ju lus juve deputetë dhe regjinë të votojmë për propozimin e komisionit, të cilin e mbështeti edhe zëvendëskryeministri këtu. Votojmë tash:

Votimi tregon kështu: 59 vota janë për, 4 janë kundër dhe 5 abstenojnë.

Në bazë të Rregullores, del se nuk janë bërë 61 vota dhe se nuk është krijuar shumica që të kalojë kërkesa e Presidentes, e cila ka kaluar nëpërmjet komisioneve.

Dhe, në bazë të kësaj, ky ligj konsiderohet i shpallur. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën shtatë:

7. Shqyrtimi i raportit të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011

Raportin vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale e Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

Tash është radha e diskutuesve. Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale e Media, deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale e Media, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11.06.2012 e ka shqyrtuar raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011 dhe ka vendosur që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim:

- Të miratohet raporti i punës i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011.

Më lejoni të them se ky këshill nuk është në përbërje të plotë tanimë dhe nuk është plotësuar, edhe pse ne si komision kemi rekomanduar që ai të plotësohet. Pengesë për mosplotësimin e tij del se është ligji, në bazë të të cilit është themeluar ky këshill, prandaj në emër të komisionit kërkoj që ky ligj të vijë në plotësim-ndryshim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe ky këshill të plotësohet me anëtarë dhe të jetë funksional.

Ne si komision kemi rekomanduar që ky raport i punës për vitin 2011 të miratohet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti deputet! Kryetarja e Komisionit për Buxhet e Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 4.8 të Ligjit për trashëgiminë kulturore, Kuvendi i Kosovës e miraton buxhetin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe si rezultat këshilli duhet t'i raportojë Kuvendit.

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin financiar, i cili duhet të jetë pjesë e raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe ka ardhur në përfundim që në shqyrtimin, kur e kemi bërë në komision, se raporti nuk është i plotësuar

dhe me detajet e nevojshme, ashtu siç e kërkon Ligji për menaxhimin e financave publike, për çka edhe kemi kërkuar nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë që ta sjellë një raport më të detajuar, ku do të ketë mundësi të bëhet analiza e buxhetit të miratuar dhe të shpenzuar të këtij këshilli.

Këshilli i Kosovës e ka sjellë raportin e detajuar, i cili i është bashkëngjitur rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa. Pas shqyrtimit të raportit të detajuar, i sjellë nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, komisioni njëzëri e ka miratuar raportin me pjesën plotësuese, të cilën e ka kërkuar komisioni. Kështu që nga raporti vërehet se Këshilli për Trashëgimi Kulturorë ka shpenzuar 126 473 euro, që do të thotë se ka shpenzuar diku 89% të buxhetit, nga të cilat për paga e mëditje ka shpenzuar 81% të buxhetit, për mallra dhe shërbime 98%, kurse për shpenzimet komunale 87%.

Kur jemi te diskutimi i këtyre raporteve financiare, të cilat vijnë nga institucionet e pavarura, ndiej për obligim t'i theksoj dy çështje, të cilat janë problematike dhe vërehen në secilin raport të sjellë nga institucionet e pavarura.

Çështja e parë, apo problemi i parë, ka të bëjë me pagat e këtyre bordeve, apo të këshillave të zgjedhura nga Kuvendi. Mungesa e ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publikë ka lënë hapësirë që të krijohet një konfuzion i madh sa u përket pagave të këtyre institucioneve. Nuk është e përcaktuar në mënyrë definitive me ligj se çfarë do të jenë pagat e institucioneve rregullative, çfarë do të jenë pagat e institucioneve që janë kategori kushtetuese, çfarë pagash do të kenë bordet ekzekutive dhe joekzekutive, kurse çfarë pagash do të kenë këshillat mbikëqyrës dhe këshillat e formuara si këshillëdhënës, apo ata profesionalë.

Për këtë arsye, është më se e domosdoshme që Qeveria, e cila e ka paraparë në strategjinë legislative Ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publikë ta sjellë sa më shpejt në Kuvend, në mënyrë që ai të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Sepse, në këtë rast, mungesa e këtij ligji ka bërë që kërkesat, por edhe ankesat e këtyre këshillave, të komisioneve dhe institucioneve tjera të pavarura, nganjëherë të bëhen edhe të tepërta.

Dhe, çështja e dytë, të cilën dua ta ngre këtu, është çështja e pagesës së qirasë. Këto institucione kanë numër shumë të kufizuar të të punësuarve, disa më shumë e disa më pak, mirëpo nëse i marrim dhe analizojmë shpenzimet e qirasë, ato janë tepër të larta, të cilat nuk ia vlen të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Për shembull, ky institucion, do të thotë Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë, i ka shpenzuar për qira diku 30 000 euro. Nëse e analizojmë, i bie se për çdo muaj ka paguar nga 2 500 euro. Nëse e analizojmë tash në raport me numrin e të punësuarve, që i ka vetëm 11 sish, atëherë i bie që për një të punësuar janë shpenzuar diku 227 euro, që do të thotë se është një shpenzim i tepërt, i cili nuk ka ndodhur vetëm në këtë këshill, por ka ndodhur pothuajse në të gjitha institucionet e pavarura.

Prandaj, ne do të kishim kërkuar që vërtet të bëhet një zgjidhje dhe të analizohen të gjitha këto institucione, të cilat kanë numër të vogël të punësuarve, të gjendet një mundësi që

ato të sistemohen diku ku nuk paguajnë qira dhe të mos bëhen këso pagesash të shpenzimeve të qirasë në këtë shumë çfarë ka ndodhur, jo vetëm në këtë institucion, por në të gjitha institucionet tjera.

Në fund, dua të them se komisioni njëzëri e ka përkrahur raportin financiar, me plotësime të cilat kanë arritur dhe rekomandojmë që ai të miratohet.

KRYESUESI: Falemnderit! Tash paraqitet në emër të grupeve. Në emër të PDK-së, zonja Xhevahire Izmaaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Falemnderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe po ashtu, si në grup, edhe në komision i kemi dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona, të cilat do t'i paraqes në vazhdim.

Duke pasur në konsideratë se ky këshill është një organ i themeluar nga Kuvendi, si një autoritet profesional për fushën e trashëgimisë kulturore në vend, me themelimin dhe funksionalizimin e tij vendi ynë ka dëshmuar se është në rrugë të mirë për vendosjen e njëres prej shtyllave të rëndësishme të shtetit, andaj edhe u pa si hap pozitiv në Raportin e Progresit të viteve 2010 dhe 2011.

Mirëpo, nga performansa e deritanishme e Këshillit për Trashëgimi Kulturor, në bazë të dy raporteve brenda këtij mandati, nuk arritëm të fitojmë së paku një perceptim si një tentim për realizimin e misionit për të cilin është krijuar ky këshill.

Edhe në këtë raport i shohim përpjekjet e atyre pak anëtarëve të mbetur, me një mandat të paqartë, që me paraqitjet e aktiviteteve realisht të ndodhura brenda krejt viteve të funksionimit të tij, të mbulojë punë tjera, të cilat nuk janë kryer.

Raporti flet për problemet, nëpërmjet të cilave më shumë kuptojmë se këshilli i ka fillimisht të qartësia e kompetencave, që ngjajnë në një organ ekzekutiv, se sa në një organ këshillëdhënës, i themeluar nga Kuvendi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Me gjithë respektin për punën dhe kontributin që e ka dhënë, e them individualisht, në këtë sferë, së paku udhëheqësja e tij, puna e ekipore aty thuaja se nuk ka ekzistuar fare. Kështu, ky institucion rrallë, për të mos thënë asnjëherë, nuk e ka dhënë asnjë analizë apo vlerësim, apo rekomandim për Kuvendin dhe institucionet tjera në funksion të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore.

Idetë pozitive për t'u zhvilluar si një organ aq i rëndësishëm më shumë i kemi dëgjuar në debatet e rralla se sa si projekte shtetërore, që do të ishin në bashkëpunim me institucionet e afërta në këtë fushë - projektet që do të vinin në lëvizje dhe aktorët tjerë për ta përkrahur më shumë punën e tij.

Duke qenë të informuar se Ligji për trashëgiminë kulturore është në procedurë të plotësimit-ndryshimit, po flas si anëtare e Komisionit për Arsim, Kulturë dhe Shkencë, duke pasur parasysh të gjitha problemet që janë shkaktuar deri më tani, kërkoj edhe nga Ministria e Kulturës dhe Rinisë e Sportit që ta japë kontributin e vet edhe rreth këtyre paqartësive.

Sa herë kemi dëgjuar, përpos në këtë raport, nga anëtarët e këtij këshilli të mbetur, të zgjedhur vite më parë, nevojën për një plan nacional për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike. E pakuptimtë më duket vetëm kjo dëshirë, kur në bazë të ligjit ekzistues dhe vetë kushtetues, ky këshill është dashur së paku të tentojë ta bëjë një draft të tillë. Andaj, sot do ta kishim të drejtën të kërkojmë llogari edhe më shumë për mosmbështetjen e tij, por as këtë s'e bëri, as nuk provoi ta bëjë.

Raporti i punuar teknikisht bukur shpreh shqetësimin për urgjencë në hartimin e planit nacional të arkeologjisë.

Trashëgimia kulturore ka qenë pjesë e përditshme, të themi edhe e angazhimeve të vetë ministrit të Kulturës, me të mirat dhe mangësitë. Në këtë drejtim do ta përsëhendes punën e ministrit për bashkëpunim dhe komunikim në koordinim ndërmjet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, që e mbulojnë këtë fushë, duke i mbajtur takimet e rregullta dhe kontaktet e vazhdueshme, por assesi të mjaftueshme.

Edhe pse Raporti i Progresit i vitit të kaluar ka paraqitur edhe mungesën e listës gjithëpërfshirëse të monumenteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje, së paku tani Ministria e ka bërë një listë të përkohshme.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga ky këshill ne nuk është dashur as të presim më shumë, pasi edhe si Kuvend është dashur pak më shumë ta përkrahim, duke e plotësuar me anëtarët që kanë munguar deri më tani, andaj them që duhet thjesht një ligj i ri, një përbërje e re, më profesionale. Ne kemi nevojë për më shumë bashkëpunim në këtë drejtim dhe pa u përpjekur t'i fajësoj individët, si anëtarë, me atë angazhim simbolik dhe punimin e këtij raporti, ne si Grup Parlamentar do ta votojmë dhe do të angazhohemi të gjithë që shteti ynë ta ketë një organ të fuqishëm në lëmin e trashëgimisë kulturore, pasi na ka përcjellë një gjendje aspak e favorshme, e trajtuar si kulturore, e më shumë si politike.

Andaj, duke votuar për këtë raport, votoj për ndryshimet që do të bëhen me ligjin e ri, që e presim të na vijë shpejt dhe në këtë drejtim të punojë shumë më shumë profesionalisht edhe vetë ministria përkatëse. Pra, Grupi ynë do të votojë për. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për LDK-në, deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Lidhja Demokratike e Kosovës edhe kësaj here e ka shikuar me kujdes raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, duke e çmuar fushën që e ndihmon dhe trajton ky këshill, atë të trashëgimisë, si dhe politizimin e tepërt të kësaj fushe, që është

bërë për kohën. E ka bërë vlerësimin e raportit, duke dhënë disa propozime për ta ndihmuar punën e tij në vazhdim.

Në raportin e vet, edhe në këtë vit, siç shprehet, pengesë të punës këshilli e shih mungesën e njohjes ligjore të rolit të këtij këshilli dhe si rrjedhojë e kësaj, në vend të renditjes së punëve, kemi përzierje të punëve, shpesh nga vetë këshilli, por edhe nga institucionet tjera që merren me fushën e trashëgimisë.

Në lidhje me këtë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon se kjo duhet të evitohet gjatë amendamentimit të Ligjit për trashëgimi kulturore, që do të bëhet gjatë këtij viti, kur edhe do ta japim kontributin konkret.

Shqetësuese për ne është edhe përbërja jo e plotë e këshillit, që u cek edhe nga kryetari i Grupit Parlamentar, që sipas shumë arsyetimeve pret amendamentimin e Ligjit, gjë që për mendimin tonë nuk ka qenë e nevojshme të pritët, sepse në ligj thuhet përbërja, ndërsa për çështjet tjera mbetet të precizohet edhe në aktet tjera ligjore.

Pastaj, mungesa e këshillit zbatues dhe mbikëqyrës, i cili do t'u mundësonte institucioneve shtrirje të autoritetit të vet në krejt hartën e trashëgimisë kulturore, gjë të cilën nuk mund ta bëjë dhe realisht është e pafuqishme në këtë drejtim, duke i pasur për bazë edhe ato diskutime më herët që u përmendën, edhe te Ligji për fetë, edhe te kompetencat e Kishës Ortodokse në këtë drejtim.

Për këtë, përveç pengesave nga Kisha Ortodokse Serbe, mendoj se edhe ndërkombëtarët e kanë neglizhuar me të madhe daljen e këtij këshilli, i cili do ta bënte pak a shumë radhitjen e punëve në këtë drejtim.

Nuk është bërë fare punë edhe në insistimin për kthimin e artefakteve. Nuk do të përmend numra, meqë shpeshherë kemi përmendur numra të asaj pasurie, ngase ka pasur marrje legale dhe ilegale, prandaj nuk do të ishte e nevojshme të përmendim numra në këtë drejtim.

Po ashtu, Grupi Parlamentar i LDK-së përsërit kërkesat e bëra edhe vitin e kaluar, kur e kemi shqyrtuar raportin, që të ketë më shumë investime në trashëgiminë kulturore, definimin ligjor pa politizim të kësaj fushe, krijimin e programeve nacionale të studimeve dhe mundësia më e mirë, siç kemi propozuar edhe më herët, do të ishte që në Universitetin e Prizrenit të jetë një drejtim, i cili do ta aftësonte kuadrin në këtë drejtim, do t'i ulte edhe shpenzimet e shtetit tonë, që ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve të stafit. Por, një kontribut i theksuar mendojmë se duhet të vijë edhe nga Akademia e Shkencës dhe Arteve të Kosovës në punën e botimeve shkencore, normalisht duke pasur kujdes dy ministritë që të bëjnë financimin e tyre - ajo e Arsimit dhe e Kulturës.

E pafalshme është mungesa e listës së trashëgimisë kulturore. U tha, është një listë e përhershme, por obligim është që të bëhet lista e përhershme e trashëgimisë kulturore. Për këtë duhet të ketë një afat të prerë Ministria dhe vetë ky këshill me obligimet që i ka në këtë drejtim.

Ne, për aq sa është punuar dhe sa është përbërja dhe defektet që i cekëm në ligj, mund ta votojmë këtë raport, duke pasur gjithherë për bazë edhe respektimin e atyre rekomandimeve, për ta avancuar më tutje punën në fushën e trashëgimisë kulturore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar me vëmendje raportin vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2011 dhe si të tillë e përkrah për miratim.

Dihet se ky institucion, si organ kushtetues, ka autoritet ligjor për vlerësimin dhe nominimin e trashëgimisë kulturore të shtetit. Por, sfidat që i identifikon ky raport janë tejet brengosëse, si nga mungesa e kapaciteteve financiare, moskompletimi i stafit të këshillit, që do të mundësonte ushtrimin efikas të veprimtarisë së tij e deri tek injorimi që shpeshherë u është bërë rekomandimeve profesionale të këshillit nga autoritetet tjera ekzekutive dhe politike.

Në këtë kontekst, ne e përshëndetim veçanërisht vlerësimin tejet profesional që ky këshill ka bërë për Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe për Hoçën e Madhe, por që nga ky Kuvend, për arsye politike, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë anashkaluar këto vlerësime profesionale.

Po ashtu, janë shqetësuese dhe nuk është fer veçanërisht injorimi që i është bërë këtij këshilli lidhur me një marrëveshje që ka bërë Presidenca me Ministrinë e Kulturës dhe të Rinisë e Sportit, ku marrëveshjet, ndonëse ka të bëjë me financimin, nuk janë bërë në konsultim me këshillin dhe madje nuk janë përcjellë as zyrtarisht. Pra, këto dy institucione nuk kanë marrë as mundin që ta informojnë as zyrtarisht këshillin lidhur me këto marrëveshje, e lëre më që t’i marrin në konsideratë rekomandimet tjera të tij.

Prandaj, nuk qëndron argumenti se këshilli nuk ka punuar fare. Këshilli ka punuar, por fatkeqësia është se autoritetet ekzekutive dhe politike i kanë injoruar vlerësimet profesionale të tij, e këtui prin Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve.

Rrjedhimisht, Lëvizja “Vetëvendosje” pajtohet po ashtu me shqetësimet dhe sfidat që i adreson ky raport në sferën e trashëgimisë kulturore e shpirtërore. Është nevojë imediate që të krijohet lista e trashëgimisë kulturore e Republikës së Kosovës në mbrojtje të përhershme, e cila, siç thotë raporti, mungon, apo edhe potenciali i trashëgimisë kulturore, që duhet mbrojtur, e nuk është përfshirë ende në planet zhvillimore dhe hapësinore, duke u bërë kështu burim i kaosit të gjithëmbarshtëm shoqëror, urbanistik dhe kulturor.

Prandaj, si Lëvizje, jemi të shqetësuar me të gjitha këto deficite dhe kërkojmë një intervenim urgjent në kompletimin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2011 dhe si të tillë votën e ka për.

Por, për të dashur dhe duke ditur misionin dhe objektivat e këtij këshilli, që ka qenë ruajtja dhe rehabilitimi i trashëgimisë kulturore, pastaj mbrojtja statusore e pronave të trashëgimisë kulturore, ne si Aleancë bëjmë apel që urgjentisht të vihet në plotësim-ndryshim Ligji për trashëgimi, i cili duhet t'i rregullojë shumë çështje.

Një ndër çështjet është edhe vetë përzgjedhja e anëtarëve të këshillit, duke e ditur që ky këshill ka funksionuar sa kohë me vetëm 2 anëtarë, që do të thotë më pak se 50% të vetë këshillit, prandaj edhe funksionimi i drejtë nuk ka mundur të ndodhë.

Pra, ashtu edhe sikur që janë cekur në këtë raport, gjatë përpjekjeve që nuk kanë munguar nga ky këshill, trashëgimia kulturore është ende larg përkujdesjeve të nevojshme në planin ligjor dhe administrativ, në atë shkencor e profesional të planifikimit, të edukimit dhe financimit.

Gjithashtu, në mungesë të zbatimit të detyrave sipas normave ligjore, veprimtaria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore u zhvillua kryesisht pa strategji, me prioritetë të përcaktuara qartë dhe pa programe e plane të mirëfillta konservimi. Pra, e gjithë kjo ndodh, sepse vetë përbërja me 2 anëtarë nuk do të thotë se ka mundur të ndodhë diçka më shumë.

Prandaj, si të tillë ne e përkrahim dhe bëjmë apel që sa më parë të vihet në plotësim-ndryshim Ligji për trashëgiminë kulturore. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për Koalicionin Kosova e Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Falemnderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2011.

Ne i përkrahim rekomandimet e dy komisioneve, përkatësisht kërkesat e Komisionit për Arsim e Financa gjatë diskutimet për këtë raport dhe ne do ta miratojmë raportin, por po e përsëritim nevojën që ligji të vijë sa më shpejt, kur do të sqarohen detyrat dhe përgjegjësitë, konkretisht kompetencat e këtij këshilli.

Dëgjuam nga diskutuesit e mëhershëm se këshilli nuk ka përbërje të plotë, andaj ftoj që t'i fillojmë procedurat në Kuvend që të plotësohen vendet e zbrazëta dhe këshilli të jetë funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti deputet! Për Grupin 6+, deputetja Mufera Shiniq e ka fjalën.

MUFERA SHINIK: Falemnderit, kryesues!

Kosova Kultürel Miras Kurulunun 2011 yılı çalışma raporunu incelediğimizde desteklenmesi gerektiğini gördük. Ancak Prizrendeki Namazgah, Kültürel Miras olarak ciddi bir şekilde korunma gereğine karşın, Kültürel Miras Enstitüsünce ordaki koruma görevlisinin maaşının dışında herhangi bir desteği görülmemektedir. Özellikle çevre düzenlenmesi, aydınlatılması konusunda ivedilikle ciddi adımların atılması gerektiğine inanmaktayız.

Onun dışında kurulun ilerideki çalışmalarında Prizrenin merkezinin sembolü olan Şadırvan Camisi, Şadırvan Çeşmesi ve çok yakınındaki Binbaşı Çeşmesinin de acilen onarımı ve bakımı için çalışmaların planlanması gerekmektedir..

Aynı zamanda Priştine merkezinde yapılan kazı çalışmaları sırasında rastlanan tarihi çeşme ve bu Kültürel Miras Kurulunun önümüzdeki çalışma programına alınacağını düşünerek bu raporu 6+ Parlamento Gurubu olarak desteklemekteyiz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar, kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të flas për pjesën e raportit, sepse në parim e mbështes atë që kryetari i Komisionit Funksional e paraqiti, por do të flas për problemet që ky bord i ka tash e tre vjet.

Gati prej fillimit të mandatit është ballafaquar me mungesën e anëtarëve të rregullt. Dorëheqjet nga ky bord, i emëruar nga Kuvendi si organ më i lartë për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore, dhe i pavarur nga organet tjera ekzekutive, kanë qenë të motivuara edhe me kërkesa politike të kohëpaskohshme dhe e vetmja që ka punuar në këtë organ është e zgjedhura e Kuvendit, profesoresha e njohur e arkeologjisë, Edi Shukriu. Ajo është munduar të ndërtojë marrëdhënie me Kuvendin, me Qeverinë dhe në veçanti me Ministrinë e Kulturës dhe Sporteve, por shpeshherë nuk ka hasur në mirëkuptim dhe problemet që e kanë përcjellë e kanë koston e rrezikimit të trashëgimisë kulturore, sidomos të asaj trashëgimie që është pjesë urbane, që ka qenë nën atak të vazhdueshëm të rrënuesve dhe objekte që janë në listën e objekteve të mbrojtura dhe të trashëgimisë kulturore, së paku në listën initiale të trashëgimisë kulturore, janë rrezikuar seriozisht nga moslidhja e këtyre hallkave që do të duhej të jenë funksionale ndërmjet organeve që merren me trashëgiminë kulturore.

Po ashtu, rekomandimet që i jep ky organ ndihmojnë që Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në Ministri, Qeveria dhe komunat ta shtojnë kujdesin, por ka munguar një mbështetje e arsyeshme që është dashur t'i jepet komisionit në kuptimin buxhetor, në kuptimin ligjor dhe në kuptime tjera të domosdoshme, në mënyrë që të jetë funksional.

Edhe më tutje vazhdon të jetë në një objekt privat, që nuk është i denjë, përderisa objektet e trashëgimisë kulturore i shfrytëzojnë shoqatat joqeveritare.

Mendoj se zgjidhja e parë që është dashur të bëhet për një objekt të mbrojtur do të duhej të jenë për këtë organ, sepse është organi më i lartë që e ka emëruar Kuvendi.

Më lejoni t'i përmend edhe dy raste, rrënimet e xhamive të vjetra sidomos, dhe ndërhyrjet e të tjerëve në pengim dhe rindërtim, duke e ndërruar shpeshherë edhe historinë e këtyre objekteve fetare, të karakterit të trashëgimisë kulturore, po e rrezikojnë humbjen e identitetit të shumë objekteve që janë të shumicës, që janë të popullatës së Kosovës dhe i përkasin kulturës sonë, si dhe objektet tjera, pavarësisht se cilës kulturë dhe cilës periudhë i takojnë. Duke e njohur diversitetin e kësaj trashëgimie kulturore, tregohet qartë se ky Kuvend duhet ta ketë një rekomandim final ngjitur me këtë raport. Pra, t'i japë mbështetje plotësimi të këtij bordi, t'i japë mbështetje kryetares së këtij bordi, edhe në kuptimin buxhetor, sepse nuk ka mundësi tjetër që ta ushtrojë detyrën ligjore.

Unë besoj se profesoresha Shukriu e ka kryer detyrën mirë, por ajo duhet të jetë më e mbështetur politikisht edhe në kuptim buxhetor nga Kuvendi, në mënyrë që ta kryejë detyrën që e ka si mision, në përputhje me ligjin në Kosovë.

KRYESUESI: Falemnderit, zoti Lutfi Haziri. Jemi kah fundi, janë edhe dy, një për së dyti. Safete, nëse ke diçka të veçantë, por tash fjalën ia kisha dhënë deputetit Salih Morina.

Por, edhe regjisë, i them - thirrini deputetët të hyjnë në sallë, sepse do të votojmë pas pak.

SALIH MORINA: Ju falemnderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë, po ashtu në parim, do ta mbështes këtë raport. Mirëpo, do të paraqes edhe unë disa shqetësime që edhe parafolësit i cekën, kur është në pyetje mosfunksionimi i Këshillit për Trashëgiminë Kulturore dhe u tha se pritet që Ligji për trashëgiminë kulturore shumë shpejt të amendamentohet dhe pastaj të emërohen edhe anëtarët e këtij këshilli, me ç'gjë unë nuk pajtohem, sepse edhe në këshillin aktual parashihet që Këshilli për Trashëgimi Kulturore t'i ketë 7 anëtarë dhe aktualisht ky këshill, siç u tha edhe nga parafolësit tjerë, krejt këtë aktivitet e këtë punë e ka bërë vetëm me 3 anëtarë, të cilët janë aktualisht.

Prandaj, do të ishte shumë urgjente që edhe me këtë ligj, i cili është në fuqi, të plotësohen këta anëtarë, sepse jam shumë i bindur se deri kah shtatori nuk do ta kemi Ligjin për trashëgiminë kulturore, kështu që edhe një vit pothuaj se i plotë do të jetë pa funksionalizimin e këtij këshilli, e dihet roli dhe rëndësia e tij, që është shumë i

nevojshëm, duke u marrë për bazë edhe hartimi i listës për trashëgimi kulturore dhe po ashtu duke u marrë për bazë edhe projektet për investime kapitale, do të thotë kur është në pyetje korniza afatmesme buxhetore që parashihet nga Ministria, ose linja përkatëse që në objektet e trashëgimisë kulturore të investohen dhe njëkohësisht të ruhen ato. Prandaj, pa funksionalizimin e këtij këshilli do të jetë e pamundur që të aprovohet kjo listë, për këtë arsye është urgjencë që sa më shpejt të formohet Këshilli për Trashëgimi Kulturore, sepse do ta lehtësojë punën në fushën e trashëgimisë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Safete, nëse ke diçka të veçantë, mund ta marrësh fjalën. Urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: U përmend çështja e buxhetit dhe ndjeva për obligim që t'i them vetëm dy fjalë, shkurt.

Me këtë ligj, çfarë është dhe që e rregullon problemin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, është shumë problem të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për ta kryer aktivitetin dhe veprimtarinë e vet. Prandaj, unë e përkrah propozimin që u dha këtu që të bëhen plotësim-ndryshimet me ligj. T'i jepet fuqia ligjore Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, sepse nëse nuk e ka mbështetjen ligjore është shumë problem dhe vështirë për t'ia dhënë edhe mbështetjen buxhetore. Prandaj, unë mendoj që sa më shpejt të shkohet në plotësim-ndryshimin e Ligjit, që vërtet me ligj të përcaktohet edhe mundësia e përkrahjes buxhetore.

Përndryshe, mbetet si këshill kështu çfarë është dhe është problem për ta gjetur edhe bazën ligjore për t'ia dhënë ndonjë mbështetje të fuqishme buxhetore.

KRYESUESI: Kryetar i Komisionit, pasi i dëgjove këto vërejtje dhe të tjerat, a ke diçka për rezyme? Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Nuk kam kurrgjë. Ne si komision kemi rekomanduar që ky raport të përkrahet dhe ligji të vijë sa më shpejt në plotësim-ndryshim dhe të plotësohet ky këshill.

KRYESUESI: Falemnderit! Të nderuar deputetë, në sallë i kemi 59 deputetë. Nuk janë 61, prandaj nuk votohet sot. Votohet në një seancë tjetër. Faleminderit dhe shihemi në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkript dhe Lekturë